

URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam
Rabbani
RAHMETULLAHI ALEJH

Osman Nuri Topbash





Shkodër, 2020

URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam
Rabbani
RAHMETULLAHI ALEJH

Osman Nuri TOPBASH



PARATHËNIE

Falënderime të pafundme qofshin për Allahun, i Cili na ka nderuar me dhuntinë e Islamit dhe besimit, që na ka privilegjuar duke na bërë bashkëbisedues të Kuranit Famëlartë dhe që na ka mundësuar fatin që të jemi pjesë e umetit të Muhamedit ﷺ i cili është komentuesi kontret i Kuranit dhe udhërrëfyesi ynë.

Në këtë botë kemi si drejtim istikametin, kurse në ahiret kemi shpresë në ndërmjetësimin e Krenarisë së Gjithësisë, Muhamed Mustafasë ﷺ. Salate dhe selame të pafundme për familjen e tij të pastër dhe shokët e tij besnikë!..

Personalitete të rëndësishme që duhen marrë shembull pas Pejgamberit ﷺ janë dijetarët miq të Zotit të Madhëruar dhe personalitetet arif, pasi ata mbajnë statusin e “trashëgimtarëve të profetit” me dijen, gnosën dhe me edukatën shëmbullore të tyre.

Miqtë e Allahut:

✓ Janë besimtarë, që e ndiejnë veten të përgjegjshëm për umetin, të ditur, arifë dhe të besueshëm, që kanë të ngulitur në personalitetin e



tyre një raport në normën e duhur të së dukshmes dhe së brendshmes së fesë;

✓ Kanë mbërritur në sjellje të përsosur duke bërë bashkë nivelet e zemrës në rrugën e asketizmit dhe të devotshmërisë;

✓ Kanë mbërritur në shijen e besimit dhe thellësinë e ndjenjave, duke zgjeruar të dy horizontet e përceptimit;

✓ Kanë të drejtuara të gjitha përpjekjet e tyre drejt qëllimit të shpëtimit të njerëzve nga veset e këqija dhe nga shqetësimet e nefsit, duke i orientuar drejt edukatës së mirë dhe pjekurisë shpirtërore.

Zoti i Madhëruar në ajetin 119 të sures Teube, thotë:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!”

Ubejdullah Ahrari thotë:

“Urdhri **«Jini me njëri-tjetrin!»**, që gjendet në këtë ajet kuranor, kërkon të qenit bashkë në mënyrë të vazhdueshme. “Të qenit bashkë” që kalon në ajet, kur përmendet në formë të prerë, ka dispozitë edhe veprimtarie edhe njëfarë bashkimi ligjor. Bashkimi në veprimtari kupton të qenit bashkë me shpirt në mexhlise me sadikët. Kurse bashkimi ligjor nënkupton të imagjinuarit e gjendjeve të tyre shembullore edhe kur ata nuk janë të pranishëm, reflektimin mbi urtësitë e tyre.”¹



Kësisoj, hapi i parë që duhet hedhur në rrugën e të qenit sadik, është qëndrimi bashkë me sadikët, pra të pasurit dashuri ndaj tyre në nivelin më sublim. Të qenit sadik është rezultati më i natyrshëm i kësaj situatë.

Dhe ne, inshallah, në saje të këtij punimi, do të përpiqemi të jemi bashkë, ndonëse jo në prezencë, me Imam Rabbanin.

Zoti i Madhëruar, në ajetin 96 të sures Merjem, thotë:

Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri.”

Zoti i Madhëruar, njerëzve që i do, zemrave fatmire që kanë brenda një xhevher, u dhuron një sekret dashurie që i tërheq drejt Vetes si një magnet.

Në të vërtetë, çdo njeri vjen e ikën nga kjo mysafirhane e botës, pas një kohe të caktuar edhe emri i harrohet. Mirëpo, Zoti i Madhëruar miqtë nuk i harron kurrë.

Miqtë e Zotit nuk treten as pas vdekjes së trupave të tyre. Pasi ka sa e sa miq të Allahut, shërbimet e të cilëve vazhdojnë të bëhen edhe në botën berzah, e të cilët ende jetojnë në mesin tonë dhe na udhëzojnë drejt së vërtetës. Edhe pasi të vdesim ne, ata do të vazhdojnë të të jetojnë ndër zemra. Jeta e tyre e udhëzimit kapërcen kohën dhe hapësirën në varësi të afrimitetit me Zotin.

Sikur ta mendonim, mjafton sasia e vizitorëve



të tyrbeve të evlijave të mëdhenj, si argument i mjaftueshëm për këtë.

Ja një ngjarje e bukur e cila tregon dashurinë në zemra që ka krijuar Allahu për njerëzit që do:

Sipas transmetimeve, një ditë i nderuari Abdullah ibn Mubarek, nderon me prezencën e tij qytetin Rakka, në të cilin Kalifi abasit, Harun Reshidi, banonte mes madhështisë dhe pasurisë së bujshme. I gjithë populli i qytetit dalin që ta prisnin në hyrje. Kalifi thuajse kishte mbetur i vetëm në gjithë atë qytet të madh. Harun Reshidit, i cili po shikonte këtë ngjarje nga ballkoni, i afrohet shërbëtorja dhe e pyet:

- Ç'është kjo gjendje? Ç'ka ndodhur?

Të pranishmit iu përgjigjën:

- Ka ardhur një dijetar nga Horasani. Quhet Abdullah ibn Mubarek. Populli ka dalur që ta nderojë.

Pas kësaj, shërbëtorja tha:

- Ja, kjo është mbretëri e vërtetë dhe jo mbretëria e Harunit! Pasi në mbretërinë e Harunit, pa ndërhyrjen e ushtarëve as punëtorët nuk mblidhen dot!..

Vërtet, mbretëria e vërtetë kjo është... Pasi fuqia e pasurisë një ditë përfundon medoemos. Mirëpo, pushteti i zemrave, deri edhe pas vdekjes vazhdon të jetojë në zemra me të njëjtën madhësi. Njerëzimi gjithnjë ka nevojë për këta mbretër të zem-



rave, i kërkon dhe ecën në gjurmët e ndritura të tyre. Megjithëse kanë kaluar shekuj pasi kanë ikur miqtë e Zotit, si Bahauddin Nakshibendiu, Abdulkadir Gejlani, Junus Emreja, Mevlana, Hudaji etj., ende sot njerëzit janë të lidhur me ta. Zoti i Madhëruar mundëson që të mos harrohen muhaddithët, mufessirët, imamët e medhhebeve dhe njerëzit e ndritur të tasavvufit.

Njëri nga mjeshtrat e mëdhenj të botës së brendshme, i cili vazhdon ende sot të jetojë në zemrat e besimtarëve, padyshim që është i nderuari Imam Rabbani. Ky mik i Zotit ka lindur para katër shekujve e gjysmë në zonën Sahrind të Indisë, dhe si rezultat i jetës së tij shembullore me kauzë Teuhidin, Allahu i ka mundësuar dashurinë e të gjithë myslimanëve dhe për një kohë të shkurtër dashuria ndaj tij kapërceu kufijtë e Indisë dhe sot e kësaj ditë është përhapur në të gjithë botën.

Ashtu siç thuhet edhe në hadithin:

“Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96)

Nëse ne vërtet ndiejmë dashuri ndaj miqve të dashur të Allahut, evlijave; nëse dëshirojmë të ringjallemi bashkë me ta në botën tjetër, atëherë duhet të përpiqemi të marrim nga besimi, edukata dhe istikameti i tyre. Pasi treguesi i dashurisë së vërtetë është njësimi me të dashurin.

Kësisoj, duke mpleksur gjendjen tonë me gjendjen e miqve të Allahut, i kthejmë kështu veprat e tyre në etalon për jetën tonë, dhe frymojmë nga

klima shpirtërore e tyre.

Zoti i Madhëruar bëftë që të jemi në këtë botë në istikamet, të mund të bëjmë vepra të cilat i pëlqen Ai dhe të na ringjallë në botën tjetër bashkë me njerëzit që Ai do.

Amin!..²

Osman Nuri TOPBASH

Nëntor 2015

Yskydar

2. Dua të falënderoj dhe t'i lutem Zotit të Madhëruar që t'ia njohë si një sadaka xharije mundin M. Akif Gynaj-in që ka dhënë për të përgatitur këtë libërth.





*Imam Rabbani
Ahmed Faruki*

(1564-1624)

RAHMETULLAHI ALEJH





IMAM RABBANI AHMED FARUKI رحمته الله

[1564 - 1624]

Imam Rabbani رحمته الله erdhi në jetë në muajin Sheval të vitit 971 hixhri, në qytezën Sirhind të Indisë. Për shkak se ishte me prejardhje prej Omerit رضي الله عنه, ai është njohur edhe me emrin “Faruki”.

Babai i tij ishte Abdulehad Efendia, një shejh me virtyte të larta që kishte marrë ixhazet prej tarikateve Çishtije dhe Kadirije dhe ishte përsosur në dije e kulturë.

Ahmed Sirhindi رحمته الله e filloi edukimin duke mësuar përmendësh Kuranin Fisnik dhe u bë hafiz brenda një kohe të shkurtër. Pjesën më të madhe të dijeve i mori prej babait të tij dhe dijetarëve më të mëdhenj të kohës. Më vonë shkoi në Sijalkut, që ishte një qendër e madhe diturie. Aty mori shumë dije në fushat e fesë, të natyrës, letërsisë, etj. Por një rëndësi më të veçantë i dha dijeve në lëndët e tefsirit, hadithit dhe fikhut.

Kur mbushi shtatëmbëdhjetë vjeç dhe kishte



përparuar shumë në dituritë natyrore, u kthye në vendlindje, ku edhe filloi të jepte mësim. Ndërkohë, ai mori ixhazet për mësimdhënie tefsiri dhe hadithi nga Kadiu Behlul Bedahshani.³

Kur mbushi tetëmbëdhjetë apo njëzetë vjeç, filloi të shkruante veprën e tij “*Isbatu’n-Nubuvve*”, me anë të të cilit kritikonte pseudodijetarët e mbretit që ushqenin admirim të madh ndaj filozofëve, aq sa i konsideronin ata pothuajse mbi profetët. Në këtë vepër, ai argumentoi me anë të diturive natyrore dhe fetare rëndësinë dhe nevojën e profetësisë.


Më vonë, ai u lidh pas babait të vet dhe filloi të frekuentonte rregullisht bisedat e tij fetare, duke ia kushtuar të gjitha përpjekjet edukimit mistik. Me qëllim që t’i shërbente babait të tij në mënyrë të përsosur, ai qëndroi vazhdimisht pranë tij dhe nuk shkoi në asnjë vend tjetër. Abdulهاد Efendia ndërroi jetë në vitin 1007 hixhri (1599). Por, pak kohë para se të ndërronte jetë, ai emëroi si zëvendës të vetin djalin e tij Ahmed Farukin, pra Imam Rabbani.

Pas vdekjes së babait, në muajin Rebiulahir të vitit 1008 hixhri, Imam Rabbani رحمته الله doli prej Sirhindit për të shkuar në Haxh, ndërkohë që ishte 37 vjeç. Kur mbërriti në Delhi, ndoqi këshillën e një miku të vet dhe shkoi të vizitonte Shejh Baki

3. Kişmi, *Berekat-ı Ahmediyye*, s. 128; Bedreddin Sirhindi, *Hazaratu’l-Kuds*, II, 31-32.



Billahin. Pasi frekuentoi për njëfarë kohe bisedat e tij fetare, ai u lidh pas tij.⁴

Imam Rabbani , qëndroi afro dy muaj e gjysmë pranë Shejhut Baki Billah dhe, për shkak se sezoni i haxhit kishte kaluar tashmë, u kthye në vendlindje. Ai i shkruante shpesh shejhut të tij dhe i tregonte për gjendjet shpirtërore që përjetonte. Pas njëfarë kohe ai shkoi përsëri tek shejhu, ku edhe iu dha e drejta për të qenë përfaqësues i shejhut. Pasi qëndroi edhe dy muaj të tjerë pranë shejhut, ai u kthye përsëri në vendlindje, ku filloi të udhëzonte popullin me metodën Nakshibendije. Megjithëse në këtë periudhë e ndiente veten të mangët në aspektin shpirtëror dhe mendoi të tërhiqej për të shtuar adhurimet, si rrjedhojë e kërkesave këmbëngulëse të nxënësve të tij, ai vazhdoi punën për udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë.⁵

Më vonë, Imam Rabbani e vizitoi për herë të tretë shejhun e tij, i cili doli dhe e priti vet në rrugë. Më pas, duke e lëvdur dhe përgëzuar Imam Rabbani, shejhu i dorëzoi edukimin e shumë prej nxënësve të tij.⁶

Megjithëse Imam Rabbani kishte arritur gradë dhe virtyte të larta shpirtërore, ai ishte aq shumë i

4. Kişmi, *Berekat-ı Ahmediyye*, s. 138-140; Bedreddin Sirhindi, *Hazaratu'l-Kuds*, II, 34.

5. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 726, no: 234; II, 319, no: 290.

6. Bedreddin Sirhindi, *Hazaratu'l-Kuds*, II, 37-38.



sjellshëm ndaj mësuesit të vet, saqë më tepër s'mund të bëhej. Njëherë, shejhu i tij kishte dërguar një nxënës për ta thirrur. Sapo dëgjoji se e kishte thirrur shejhu i vet, Imam Rabbani u emocionua aq shumë, saqë filloi të dridhej i tëri. Po ashtu, edhe shejhu kishte një respekt dhe dashuri shumë të madhe ndaj tij.⁷

Pas vdekjes së shejhut Baki Billah, Imam Rabbani رحمته الله, e vazhdoi punën e tij në Sirhind dhe prej atje u dërgonte letra nxënësve të tij dhe njerëzve të shtetit. Në letrat që u dërgonte nxënësve të vet, fliste për çështjet e imta të tasavufit. Ndërsa në ato që u dërgonte njerëzve të shtetit, fliste më tepër për çështje të përgjithshme, si rregullat Islame dhe kapja pas medhhebit të Ehl-i Sunnetit.

Imam Rabbani, çdo vit në muajin Xhemazijelahir, kur edhe kishte ndërruar jetë shejhu i tij, shkonte për të vizituar varrin e tij dhe më pas kthehej përsëri në Sirhind.⁸

Marrëdhëniet e tij me sultanët

Sulltani i Baburit, Ekber Shah, në fillim ishte një mysliman me besim të pastër. Ai nuk dinte shkrim e këndim. Si pasojë e gjendjes politike dhe të emigrimeve që bëheshin për këtë arsye, ai kishte mbetur pa dije dhe shkollim. Prandaj ai ishte zhytur në mendime besëtyte në sajë të ndikimit edhe të

7. Kişmi, *Berekat-ı Ahmediyye*, s. 144, 148-152.

8. Kişmi, *Berekat-ı Ahmediyye*, s. 144.



dijetarëve servilë, të cilët përpiqeshin t'u rrinin afër sulltanëve dhe pushtetarëve. Këta lloj dijetarësh u lëshonin pe pushtetarëve për çdo çështje me qëllim që t'u hynin në sy atyre dhe, për pasojë, bëheshin shkak i lindjes së shumë dyshimeve dhe hezitimeve në mendjen e njerëzve në lidhje me Islamin. Po ashtu, duke u marrë me çështje të debatueshme, ata nxirrnin nga rruga e drejtë edhe njerëzit e pasur.⁹

Si përfundim, Ekber Shah, i cili e humbi

9. Imam Rabbani, Mektubat, III, 30, no: 67. Lidhur me këta dijetarë, Imam Rabbani thoshte:

“Njerëzit e ditur e kanë për detyrë të ndihmojnë sulltanin e tyre mysliman dhe ta orientojnë atë në çështjen e lartësimit të shariatit dhe forcimit të fesë. Mbështetja e tyre ndaj sulltanëve mund të jetë edhe me fjalë, edhe me vepra. Mbështetja më urgjente duhet të jetë ajo me fjalë. Dhe më e përshtatshme prej këtyre, është shpjegimi i çështjeve të shariatit dhe parimeve të besimit në përputhje me Kuranin, Sunnetin dhe Konsensusin e dijetarëve Islamë. Në këtë mënyrë, ata do të pengojnë daljen e disa të devijuarve dhe bid'atçijve të cilët shkaktojnë trazira në fe. Kjo lloj i takon dijetarëve të Ehl-i Sunnetit, të cilët dëshirojnë lumturinë e botës tjetër. Përndryshe, të bëhesh bashkë me dijetarët, përpjekjet e të cilëve janë vetëm për këtë botë dhe interesat vetjake, është një helm vrasës, sepse korruptimi i këtyre ndikon edhe tek të tjerët.

E në fakt, çfarëdo fatkeqësie që ka ndodhur shekullin e shkuar, ka qenë për shkak të së keqes së këtyre dijetarëve të prishur. Këta ishin ata që e kanë larguar nga rruga e vërtetë edhe sulltanin e mëparshëm. Madje, ata nuk u mjaftuan vetëm me devijimin që i shkaktuan sulltanit, por padyshim u bënë edhe prijësit e shtatëdhjetedy fraksioneve të devijuara. Pothuajse nuk ka askush tjetër, devijimi i të cilit të ndikojë tek të tjerët aq sa ndikon devijimi i dijetarëve të këqij. Edhe në ditët tona, shumë të paditur që përpiqen t'u ngjajnë sufive, konsiderohen si dijetarët e këqij, sepse mendimet e tyre të prishura ndikojnë edhe të tjerët.” (Imam Rabbani, Mektubat, I, 243, no: 47.)



orientimin e duhur fetar, u dha jomyslimanëve detyra të rëndësishme në qeverisjen e shtetit. Po ashtu, ai mori në haremin e vet edhe disa gra hinduiste. Përveç këtyre, i nxitur nga njerëzit e afërt, ai shpiku një fe të re të quajtur, “Feja Hyjnore”, duke u përpjekur të bashkojë Islamit me Hinduizmin. Madje, në disa vende u rrënuan xhamitë dhe në vend të tyre u ndërtuan tempuj hindu.

Më pas, Ekber Shah filloi t’i urdhëronte njerëzit që t’i përuleshin në sexhde respekti. Për hinduistët kjo nuk ishte aspak problem, por për myslimanët e sinqertë ishte shumë e rëndë. Kështu, dijetarët interesaxhinj që doni t’i hynin në sy sulltanit, jepnin fetva se sulltanit mund t’i bëhej sexhde me qëllim përshëndetjeje, jo adhurimi.

Imam Rabbani ﷺ shkoi në kryeqytetin Agra, ku u takua me disa të afërm të sulltanit dhe u tha:

“Sulltani ka kundërshtuar Allahun e Madhëruar dhe të Dërguarin e Tij (a.s.)! Kujtojini atij se sundimi dhe pushteti i tij do të shkatërrohet. Të pendohet dhe të futet në rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij!”


Disa njerëz të shtetit me pozita të larta, tregonin shumë respekt ndaj Imam Rabbanit. Mirëpo, sado që këta u munduan ta sjellin sulltanin në rrugë të drejtë, Ekber Shah ishte në ekstazën e fesë së re që kishte shpikur dhe nuk dëgjonte asnjë këshillë. Ndërkohë që ishte në këtë gjendje, astrologët e tij e




njoftuan se së shpejti pushteti dhe sundimi i tij do të shkatërroheshin. I mërzhitur jashtë mase për këtë, ai pa edhe një ëndërr të tmerrshme. Prandaj, ai nxori një urdhër kur thuhej:

“Kush të dojë, mund të kapet pas Islamit, e kush të dojë, pas fesë hyjnore. Lidhur me këtë nuk do të ushtrohet as detyrim, as forcë!”

Më vonë, u organizua një festival ku u ngritën shumë çadra. Çadrat e besimtarëve të fesë hyjnore, i mbushi me copa të bukura dhe ushqime të shijshme. Ndërsa në çadrat e myslimanëve dukeshin qartë shenjat e varfërisë.

Imam Rabbani , bashkë me ndjekësit e vet shkuan dhe u vendosën në çadrat e myslimanëve. Aty, mori pak dhé nga toka dhe e hodhi drejt çadrave të pjesëtarëve të fesë së re, me ç’rast filloi një erë shumë e fortë. Ndërkohë që Ekber Shahu dhe ndjekësit e tij po përjetonin çaste të vështira, myslimanët nuk u ndikuan aspak. Pas këtij paralajmërimi hyjnor shumë të qartë, disa pjesëtarë të shtetit dhe komandantë u bënë ndjekësit e Imam Rabbanit.¹⁰

Në vitin 1605 Ekber Shahu vdiq dhe në fron u ul djali i tij, Xhihangiri. Imam Rabbani  u gëzua

10. Muceddidi, *Ravzatu'l-Kayyumiyye*, I, 221-227; Muhammed Halim Şarkpuri, *Imam Rabbani* (trc. Ali Genceli), Konya 1978, s. 29-33.

shumë për këtë, sepse mendonte që Xhihangiri ishte një njeri i lidhur me Islamin.

Imam Rabbani رحمته الله dërgoi përfaqësuesit e vet në zona të ndryshme për të kumtuar fenë e vërtetë. Për shembull, Mir Muhammed Numanit i dha ixhazetin dhe të drejtën që për të qenë përfaqësues i tij dhe e dërgoi në Dekken. Në teqenë e tij u mblodhën me qindra njerëz, të cilët adhuronin Allahun dhe merrnin dije fetare. Shejh Bediuddin Seharenpurit i dha të drejtën që për të qenë përfaqësues i tij dhe, në fillim e dërgoi në vendlindjen e vet, e më pas në kryeqytet, në Agra. Në këtë mënyrë, shumë njerëz të shtetit u bën pjesë e rrethit të udhëzimit dhe mijëra të tjerë prej parisë ushtarake u penduan tek Allahu nëpërmjet dorës së Imamit të nderuar.

Po ashtu, Imam Rabbani رحمته الله, dërgoi edhe shtatëdhjetë vetë në zonat e Turkistanit me në krye Mevlana Muhammed Kasimin. Dyzetë të tjerë i dërgoi në zonat e Arabisë, Jemenit, Sirisë dhe Anadollit me në krye Mevlana Ferruh Husejnin. Dhjetë vetë i dërgoi drejt Kashgarit me në krye Mevlana Muhammed Sadikun dhe tridhjetë të tjerë drejt Turkistanit, Bedahshanit dhe Horasanit me në krye Shejh Ahmed Berkin. Këta njerëz arritën suksese të mëdha në vendet ku shkuan dhe masat e gjera të popullit përfituan shumë prej tyre.¹¹



Njerëzit përreth Imam Rabbanit po shtoheshin dita ditës. Xhemati ishte shtuar aq shumë, sa që për shkak të turmave të mëdha të njerëzve, edhe fisnikët dhe pushtetarët e kohës e kishin të vështirë ta vizitonin atë. Për rrjedhojë, sulltani Xhihangir, i irrituar disi prej këtij interesi të madh që tregohej ndaj tij, e thërret Imam Rabbani në Agra. Ndërsa në një nga letrat e tij, i kërkon llogari Imamit për mendimet e tij sufiste. Por, pas shpjegimeve të arsyeshme të Imamit, ai u bind. Megjithatë, disa persona afër sulltanit filluan t'i thoshin atij:

“Ky shejh nuk bëri sexhden e përshëndetjes para jush dhe ka shumë ndjekës në radhët e ushtrisë. Së shpejti mund të shkaktojë trazira me anë të ndjekësve të tij të shumtë, gjë që do ta dëmtojë pasurinë tuaj, sepse shejh Ahmedi ka aq shumë ndjekës mes ushtarakëve, sa që po të dojë mund të pretendojë edhe për fron.”

Atë kohë, veziri dhe shërbëtorët e sulltanit në përgjithësi ishin prej fraksioneve të devijuara. Dhe, për shkak se Imam Rabbani kishte letra dhe broshura ku kritikonte ashpër medhhebet jashtë sheriatit Islam, ata ushqenin një urrejtje të madhe kundrejt tij. Këta ishin edhe ata që e cypnin sulltanin kundër tij.¹²

Si përfundim, sulltani Xhihangir e burgos

12. Bedahşi, *Menakıbu'l-Hazarat*, vr. 39a-40b.



Imam Rabbanin në kalanë Govaliar, kur ai ishte pesëdhjetepesë vjeç. Po ashtu, ai i konfiskoi shtëpinë, librat, bahçen dhe pusin, ndërsa familjen ia transferoi në një vend tjetër.

Imam Rabbani عليه السلام i cili qëndroi një vit në burg, edhe aty u mësonte njerëzve Islamit, duke u bërë shkak që shumë prej tyre të bëheshin myslimanë.¹³ Po ashtu, vuajtjet që po duronte në burg për hir të Allahut, i shërbyen atij për t'u ngritur edhe më shumë në aspektin shpirtëror.¹⁴

Pas një viti, sulltani Xhihangir u pendua për atë që kishte bërë dhe e liroi atë me kusht që “të qëndronte në kazermë”.¹⁵

Më pas, Xhihangiri i kërkoi Imam Rabbanit të bëhej këshilltari i tij në çështjet e fesë. Pasi u konsultua për pak kohë në lidhje me këtë çështje dhe e kuptoi se Xhihangiri ishte i sigurt në kërkesën e tij, Imami e pranoi propozimin të shoqëruar me këto kushte:

- 1) Të anulohet sexhdeja përshëndetëse ndaj sulltanit,

13. Bedahşi, *Menakıbu'l-Hazarat*, vr. 41a; Muhammed Murad Kazani, *Tercumetu Ahvali'l-Imami'r-Rabbani, Mu'arrabu'l-Mektubat (ed-Dureru'l-Meknunati'n-Nefise)*, Mekke 1317 kenarında, I, 58-59; Necdet Tosun, *Imam Rabbani Ahmed Sirhindi*, Istanbul 2005, s. 29.


14. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 180, no: 5; III, 182, no: 6.

15. Bedahşi, *Menakıbu'l-Hazarat*, vr. 41a-41b.



- 2) Të rindërtohen të gjitha xhamitë e shkatërruara dhe të dëmtuara.,
- 3) Të anulohet urdhri për mos prerjen e lopëve,
- 4) Gjykatësit, myftilerët dhe drejtuesit do të marrin parasysh zbatimin e gjykimeve Islame,
- 5) Të fillojë përsëri marrja e xhizjes,
- 6) Të braktisen të gjitha bid'atet dhe të zbatohen gjykimet Islame,
- 7) Të lirohen të gjithë të burgosurit për shkak të fesë.

Siç shihet, Imam Rabbani nuk kishte asnjë kërkesë personale. Synimi i tij i vetëm, ishte që në fillim të kompensoheshin të gjitha dëmet që ishin bërë nga sunduesit e mëparshëm dhe më pas të parandaloheshin përsëritja e të njëjta gabimeve.¹⁶

Imam Rabbani  qëndrimin pranë sulltanit e perceptoi si një mundësi të mirë për ta nxitur atë drejt parimeve Islame. Ai mori pjesë në kuvendet e sulltanit, ku biseduan për çështje fetare, ndërkohe që të pranishmit e dëgjonin me interes të madh.¹⁷

Sulltani Xhihangir, i cili në fillim të sundimit të vet heshti për shkatërrimin e xhamive, gjë për

16. Halil Ibrahim Şimşek, *Osmanlı'da Muceddidilik*, Istanbul 2004, s. 66-67.

17. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 318, no: 43.



të cilën edhe u kritikua nga Imam Rabbani رحمته الله në sajë të begatisë së këtyre bisedave fetare, më vonë ndërtoi xhami dhe u lidh përsëri pas Islamit, sa bëri edhe kurban.

Imam Rabbani رحمته الله qëndroi katër vjet pranë sulltanit Xhihangir. Ndërkohë, ai vazhdonte t'u shkruante letra miqve të tij. Në vitin 1033, kur Imam Rabbani رحمته الله, u la plotësisht i lirë, u kthye në Sirhind bashkë me bijtë e tij dhe vitin e fundit të jetës së tij e kaloi në vendlindje.

Ndjekja e sheriatit para çdo gjëje

Imam Rabbani رحمته الله i cili vërente me keqardhje të gjitha bid'atet dhe besëtytnitë që kishin hyrë në jetën e myslimanëve, u përpoq shumë për të vënë përsëri në zbatim ligjet e Allahut të Madhëruar. Prandaj, në bisedat, letrat dhe veprat e tij e cekte shpesh këtë çështje dhe thoshte:

“Sheriati ka tre pjesë: Dituria, vepra dhe sinqeriteti. Pa u realizuar këto të tria, nuk realizohet as sheriatu. Kur të jetohet sheriatu, pikërisht atëherë do të fitohet edhe kënaqësia e Allahut të Madhëruar, i Cili është mbi të gjitha lumturitë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Në një ajet fisnik urdhërohet:

«...kënaqësia e Allahut (ndaj tyre) është shpërblimi më i madh...» (Teube, 72)



të dhe në botën tjetër. Përtej shariatit nuk ekziston asnjë synim tjetër. Ndërsa tarikati dhe e vërteta ku janë mbledhur sufistët, janë shërbyesit e shariatit. Këto plotësojnë pjesën e tretë të shariatit, që është sinqeriteti. Për rrjedhojë, arritja e këtyre, plotëson shariatin. Përndryshe, ato nuk janë diçka përtej shariatit.

Frymëzimet, aftësitë dhe dituritë e përsëpirtshme që u jepen sufive në këtë rrugë shpirtërore, nuk janë synimi i vërtetë. Përkundrazi, ato janë iluzione dhe ëndrra me të cilat edukohen fëmijët e tarikatit. Të gjitha këto duhen kaluar për të arritur në gradën e “kënaqësisë”, sepse synimi i kapërcimit të distancave të tarikatit dhe së vërtetës, nuk është asgjë tjetër përveçse përvetësimi i sinqeritetit, i cili është i nevojshëm për arritjen e gradës së kënaqësisë.”¹⁸

Dituria është e detyrueshme për njeriun. Mirëpo, dituria duhet ta orientojë robin tek devotshmëria dhe njohja e Allahut, sepse në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (Fatir, 28)

Robi duhet të punojë me diturinë e tij. Por edhe punët duhet të jenë të sinqerta, sepse veprat e njeriut mund të pranohen vetëm nëse janë të sinqerta.

18. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 206, no: 36.



Dhunnun-i Misri ka thënë:

*“Të gjithë njerëzit janë të vdekur, përveç dijetarëve. Të gjithë dijetarët janë në gjumë, përveç atyre që punojnë me diturinë e tyre. Edhe ata që veprojnë me dituri, ka mundësi të gënjehen, përveç të sinqertëve. Edhe të sinqertët (në çdo çast në botë) janë përballë një rreziku të madh...”*¹⁹

Me pak fjalë, dituria, puna dhe sinqeriteti janë elemente që plotësojnë njëri-tjetrin.

Duke dashur të na tregojë se sheriatit dhe tasavufi nuk janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, na përcjellë këtë thënie të Bahaudin Nakshibendiut:

*“Qëllimi i Udhëtimit Shpirtëror (sejru suluk), është të detajojë dijet koncize dhe të njohë shpirtërisht dijet e argumentuara.”*²⁰

Nisur nga kjo, tarikati synon arritjen e së vërtetës së sheriatit. Përndryshe, ai nuk është diçka e veçantë prej sheriatit dhe së vërtetës.²¹ Dijet që perceptohen në mënyrë shpirtërore janë plotësuese dhe përforcuese të dijeve natyrore.²² Për këtë arsye, perceptimet shpirtërore që nuk përputhen me ligjet e Allahut (sheriatin) dhe konsensusin e dijetarëve të Ehli Sunnetit, nuk meritojnë të pranohen.²³

19. Beyhaki, *Suabu'l-Iman*, V, 345.


20. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 346, no: 84.

21. Imam Rabbani, *Ma'arif-i Ledunniyye*, s. 71, 25. kısım.

22. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 219, no: 41.

23. Imam Rabbani, *Mukaşefat-ı Ayniyye*, s. 29.



Po ashtu, Imam Rabbani  ka thënë:

“Përjetimet shpirtërore vlerësohen nga sheriat, ndërsa sheriat nuk vlerësohet nga përjetimet shpirtërore, sepse sheriat është përcaktuar me anë të shpalljes hyjnore, gjë që e bën atë të sigurt dhe të prerë. Kurse përjetimet shpirtërore përcaktohen prej gjendjeve dhe frymëzimeve shpirtërore, gjë që i bën ato të pasigurta dhe të dyshimta.”²⁴

“Biri im! Kohën tonë duhet ta shpenzojmë gjithmonë duke përmendur Allahun e Madhëruar. Çdo punë e bërë në përputhje me ligjet e Allahut, konsiderohet dhikr, edhe nëse është thjesht një shitblerje. Prandaj, ne duhet të respektojmë vendimet shariatike në çdo punë dhe sjellje që bëjmë, me qëllim që këto të konsiderohen të gjitha dhikr. Kjo, sepse dhikri e mposht indiferencën. Kur veprat tonat të jenë në përputhje me urdhrat dhe ndalesat Islame, atëherë nuk do të mbetemi indiferentë ndaj urdhrave dhe ndalesave të Atij që i ka vendosur dhe do të konsiderohemi sikur jemi duke e përmendur vazhdimisht Atë.”²⁵

Ndërsa në lidhje orientimin drejt tasavufit pas përvetësimit të diturive shariatike, Imam Rabbani këshillon kështu:

24. Kişmi, *Berekat-ı Ahmediyye*, s. 197-212; Ebu'l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, s. 182-188.

25. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 540, no: 25.



“Një prej synimeve të hyrjes në tasavuf, është edhe mundësia për t’i bërë më lehtë veprat e sinqerta dhe për të asgjësuar dembelizmin, inatin dhe kundërshtinë që buron prej nefsit emare.”²⁶

“Pasi të kemi zbukuruar anën tonë të jashtme sipas kriterëve sheriatike, duhet të orientohemi kah ana jonë shpirtërore me qëllim që veprat tona të mos përlyhen me indiferencë, sepse pa mbështetjen e anës sonë shpirtërore, përshtatja e anës sonë të jashtme me vendimet sheriatike është diçka shumë e vështirë.

Kur i jepet rëndësi aspektit të brendshëm të gjërave, duhet t’i jepet edhe aspektit të jashtëm të tyre. Kush merret me aspektin e brendshëm dhe lë pas dore aspektin e jashtëm, është jobesimtar. Ndërsa përjetimet shpirtërore që arrin ai, janë të gjitha istidraxh.²⁷ Kriteri më i mirë që tregon se përjetimet tona shpirtërore janë të shëndetshme, është organizimi i aspektit tonë të jashtëm sipas rregullave të sheriatit. Kjo është rruga e drejtë!”²⁸

26. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 174, no: 266.

27. **Istidraxh:** Është gjendja e njerëzve të devijuar, të cilëve Allahu i Madhëruar, u fal mirësi të shumta, me qëllim që ata të kujtojnë se janë në rrugë të mirë dhe t’i shtojnë edhe më tepër gjynahet e veta. Përveç kësaj, istidraxhi mund të shfaqet edhe në formë të ngjashme me mrekullitë, që i bëjnë mohuesit, gjynahçarët e mëdhenj dhe disa persona që pretendojnë se gjoja janë evlija. Kjo gjë, e rrit së tepërmi egon dhe jo vetëm që nuk të afron tek Allahu, por të largon edhe më tepër nga Ai.


28. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 87-88, no: 87.



Shkurtimisht, aspekti i jashtëm dhe i brendshëm i gjërave janë dy elemente që plotësojnë njëri-tjetrin. Për rrjedhojë, mungesa e njërës e bën të mangët edhe tjetrën.

Ehli Sunnet ue'l-Xhemat

Në kohën e Imam Rabbanit ishin shtuar së tepërmi mendimet e prishura dhe rrymat e devijuara. Shumë myslimanëve u ishte tronditur besimi, u ishin prishur adhurimet dhe veprat.

I mërzitur tej mase për këtë gjendje, Imam Rabbani  u përpoq me të gjitha forcat për t'u mësuar njerëzve rrugën e Ehli Sunnet ue'l-Xhematit. Me anë të letrave që shkruante, pa u mërzitur dhe pa u lodhur ai i nxiste vazhdimisht njerëzit drejt besimit të drejtë të Ehli Sunnetit, duke bërë shpjegime të detajuara. Ndërsa detajet nga fusha e fikhut/jurisprudencës islame, i kalonte në Ilmihal dhe librat e fikhut.

Sipas tij, një mësues duhet t'i porosiste nxënësit e rinj që të mos ua vënë veshin asnjë përjetimi shpirtëror apo ëndrrë që duket qoftë edhe sa një majë gjilpëre në kundërshtim me Kuranin dhe hadithet. Krahas kësaj, ai duhet t'i këshillojë ata të korrigjojnë besimin e tyre në bazë të besimit të Ehli Sunnetit dhe të mësojnë e veprojnë sipas vendimeve të fikhut që janë të detyrueshme për ta.²⁹

29. Imam Rabbani, *Mebde ve Mead*, s. 36, 10. kısım.



Edhe vetë Imam Rabbani رحمته الله u lexonte nxënësve të tij libra nga fushat e shkencave Islame dhe, me anë të letrave i porosiste me këmbëngulje edhe përfaqësuesit e tij që t'u lexonin nxënësve të tyre këto libra në vendet ku ndodheshin. Disa prej atyre librave ishin edhe këto:

Prej fushës së tefsirit, Bejdavi, prej hadithit Buhariu dhe Mishkatu'l-Mesabih, prej fikhut Pezdevi dhe Hidaje, prej akaidit Sherhu'l-Meuakif dhe Hashije-i Adudi dhe prej tasavufit Auarifu'l-Mearif.³⁰

Edhe pse Imam Rabbani رحمته الله i kishte mësuar përmendësh çështjet e fikhut, i njihnte mirë ato dhe gëzonte kompetencë të plotë në metodën e fikhut, kur shfaqej ndonjë gjë e re, ai kërkonte nëpër librat e besueshëm, të cilët nuk i ndante nga vetja. Ai vepronte sipas mendimit për të cilin ishte dhënë fetva dhe mendimit të juristëve të mëdhenj Islam.³¹

Ndjeshmëria në ndjekjen e Sunetit profetik

Imam Rabbani në çdo sjellje të tij, sado e thjeshtë të ishte, patjetër ka vepruar në përputhje me sunetin e Profetit صلوات الله عليه dhe, po kështu i këshillonte edhe të tjerët të vepronin.


Njëherë, një prej nxënësve të tij i kërkoi leje


30. Bedreddin Sirhindi, *Hazaratu'l-Kuds*, II, 89.

31. Ebu'l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, s. 182.




që të shkruante lutjet ditore, dhikret dhe adhurimet vullnetare të Imam Rabbanit. Mirëpo, ai i tha:


“Veprat që meritojnë të pasohen, janë ato të Profetit . Shikoni librat e hadithit dhe mësojini prej tyre!” Nxënësi këmbënguli dhe tha:


“I nderuar, edhe veprat tuaja janë në përputhje me ato të Profetit tonë .” Për këtë arsye, Imam Rabbani tha:

Mirë pra, shkruajini atëherë!”³² (Kışmi, *Berekat*, s. 427-428)

Adhurimet e tij

Imam Rabbani  u jepte shumë rëndësi adhurimeve dhe të njëjtën gjë ua këshillonte edhe nxënësve të vet. Në një prej këshillave të tij, shprehet:

“Megjithëse Resulallahu , ishte i Dashuri i Allahut dhe gëzonte gradët më të larta, ai bënte aq shumë adhurime, sa i ënjteshin edhe këmbët e tij të bekuara. Kështu kanë vepruar edhe njerëzit e devotshëm që e kanë pasuar atë me përpikëri... Sa më shumë që njeriu ta adhurojë dhe t'i bindet Allahut, aq më shumë përparon.”³³

Imam Rabbani  shprehej se përveç adhurimeve farz, edhe adhurimet vullnetare duheshin

32. Muhammed Salih Kulabi, i cili arriti ta marrë këtë leje, ka shkruar një vepër me titullin, “Hidajetu’t-Talibin ose Hedijetu’t-Talibin”. Shih. Beyazit Devlet Ktp., Beyazit bölümü, nr. 3823, vr. 1a-17a.

33. Kışmi, *Berekat-ı Ahmediyeye*, s. 201.



konsideruar si pasuri më vete. Qoftë dimrit apo verës, e qoftë në udhëtim apo në shtëpi, shpesh ai ngrihej në gjysmë të natës, ose pasi kishte kaluar dy e treta e natës. Ai bënte duatë që ishin sunnet të bëheshin në atë kohë dhe merrte abdes me kujdes dhe edukatë të madhe. Ai nuk preferonte që ujin e abdesit t'ia hidhte dikush tjetër. Ujin e abdesit e përdorte me kursim të madh dhe nuk harronte asnjëherë të kthehej nga kibla gjatë marrjes së abdesit. Mirëpo, kur lante këmbët, kthehej ose nga veriu, ose nga jugu. Saherë që merrte abdes përdorte edhe misvak. Gjymtyrët i lante me kujdes dhe çdo herë i fshinte me duar gjymtyrët e lara derisa të mos pikonte më ujë nga duart. Po ashtu, gjatë abdesit këndonte duatë që përmenden në hadithet fisnike. Pas abdesit, këndonte duanë e tehexhudit dhe fillonte namazin.

Namazin e tehexhudit e falte me përkushtim të thellë, duke kënduar sure të gjata. Në kohët e para, në namazin e tehexhudit ka kënduar vazhdimisht suren Jasin. Por në kohët e fundit përpiqej më tepër ta këndonte të gjithë Kuranin Fisnik në namaz. Pasi përfundonte namazin e tehexhudit, me një përkushtim të thellë zhytej në meditim. Para namazit të sabahut, zbatonte sunnetin dhe shtrihej pak. Më pas, pa aguar ende dita, ngrihej, merrte abdest dhe falte namazin e sabahut.

Sunnetin e namazit të sabahut e falte në shtëpi dhe mes sunnetit dhe farzit thoshte pa zë:



“سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ”

Pasi e falte namazin e sabahut me xhemat qëndronte me shokët e tij në xhami duke plotësuar dhikrin deri pas lindjes së diellit. Më vonë, duke kënduar sure të gjata, falte katër rekate të namazit të ishrakut. Më pas bënte duatë dhe dhikrin e atij vakti.

Më vonë shkonte në shtëpi, interesohej për gruan dhe fëmijët dhe linte porosi punët që duheshin kryer. Më pas futej në dhomën e tij dhe lexonte Kuran. Pas kësaj thërriste nxënësit e tij dhe interesohej për ta. Po ashtu, ai i këshillonte ata t'i mbanin lart synimet e tyre, të pasonin sunnetin, të vazhdonin dhikrin, të mos i shfaqnin përjetimet e tyre shpirtërore dhe të lexonin librat e fikhut.

Kuvendet e tij kalonin më tepër në qetësi. Ai ruhej rreptësisht nga përgojimi dhe hetimi i të metave dhe gabimeve të myslimanëve. Po kështu, për shkak të respektit dhe autoritetit që kishte, edhe rrethi i tij i afërm nuk përgojonte askënd në prani të tij. Ndërsa përjetimet e tij shpirtërore i fshihte me shumë kujdes. Namazin e duhasë e falte në dhomën e vet me tetë rekate. Më pas hante bashkë me familjen e tij. Nëse në atë moment nuk ndodheshe ndonjë prej fëmijëve apo shërbëtorëve të tij, ai ia ndante ushqimin.

Pas ushqimit të drekës, ai respektonte sunnetin profetik dhe flinte pak gjumë. Ndërsa pas namazit



të drekës, dëgjonte Kuran, afërsisht një xhuz, prej ndonjë hafizi dhe, nëse kishte ndonjë mësim për të dhënë, e jepte.

Namazin e ikindisë e falte sapo hynte dhe nuk i braktiste kurrë sunnetet e këtij namazi. Pas namazit të ikindisë ulej e meditonte bashkë me nxënësit e vet.

Po ashtu, edhe namazin e akshamit e falte sapo hynte, dhe pas farzit, pa u ngritur nga vendi thoshte dhjetë herë me zemër:

“لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ”

Pas sunneteve të namazit të akshamit falte namazin evabin.



Në rekatën e parë të namazit të vitrit, në përgjithësi këndonte suren A'la, në rekatën e dytë këndonte suren Kafirun, ndërsa në rekatën e tretë suren Ihlas. Namazin e vitrit ndonjëherë e falte pas jacisë, e ndonjëherë pas namazit të natës.

Imam Rabbani bënte shumë kujdes ndaj të gjitha sunneteve të namazit dhe etikës së tij. Pasi merrte abdes dhe hynte në xhami, i falte përherë dy rekate namaz.

Pas namazit të jacisë, shkonte për të fjetur, thoshte lutjet e gjumit, bënte dhikrin dhe salavatet. Ai i këshillonte edhe ata që i qëndronin gjithmonë pranë për t'i shërbyer, që të bënin sa më shumë dhikër dhe meditim.



Ata që e dëgjonin atë duke kënduar Kuran, arrinin të ndjenin thellësinë e kuptimeve të Kuranit Fisnik. Kur kalonin ajetet e frikës, çudisë apo hutisë, ai i këndonte në përputhje me atë çka përcillnin ato. Aq, sa në zërin dhe fytyrën e tij dukej sikur shfaqej kuptimi i atyre ajeteve. Gjatë udhëtimeve, ai e vendoste Kuranin mbi një jastëk dhe e lexonte ndërkohë që vazhdonte udhëtimin mbi kafshën e vet.

Imam Rabbani  tregonte një kujdes të jashtëzakonshëm edhe për muajin e Ramazanit, në të cilin e lexonte më së paku tre herë Kuranin Fisnik. Ashtu siç ka porositur edhe Profeti , në hadithet fisnike, ai nxitonte në çeljen e iftarit dhe e vononte syfyryn. Ndërsa në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit hynte në itikaf.

Po ashtu, Imam Rabbani, tregonte kujdes të madh edhe në lidhje me zekatin. Ai e llogariste sasinë e mallit që kishte për të dhënë zekat dhe e jepte atë pa e mbushur ende një vit. Kur jepte zekatin, si fillim zgjidhte ata që merrnin pjesë në shërbimin në rrugë të Allahut, gratë e veja dhe të afërmit nevojtarë.

Kur vizitonte të sëmurët dhe varret, bënte edhe duatë përkatëse sipas sunnetit. Ai u përgjigjej ftesave, por nuk merrte pjesë në mbledhje ku bëheshin gjynahe.

Imam Rabbani, e falënderonte vazhdimisht Allahun e Madhëruar dhe kërkonte falje prej Tij. Ai falënderonte edhe për një mirësi të vogël. Kur



i binte ndonjë fatkeqësi, thoshte: “Kjo është për shkak të gjendjes dhe veprave tona të këqija”. Mirëpo, atë fatkeqësi e konsideronte si një lloj pastrimi prej shumë papastërtive dhe shprehej se durimi ndaj tyre bëhej shkak për ngritje në nivele të larta shpirtërore.³⁴

Edhe pse ai bënte një jetë të mbushur me adhurime dhe frymëzime shpirtërore, ai gjithmonë e konsideronte veten të mangët dhe të paplotësuar.

Morali i bukur

Ai ishte shumë i mirësjellshëm me njerëzit. Kur dikush vinte për t’u takuar me të, ai ngrihej në këmbë me respekt, i lëshonte vendin në krye dhe sipas gjendjes së tij shpirtërore, i thoshte fjalë që i gëzonin zemrën. Ndërsa për jomuslimanët, nuk ngrihej asnjëherë në këmbë, qofshin ata udhëheqës apo njerëz me pozita të larta. Ai gjithmonë ishte i pari që jepte selam.

Imam Rabbani رحمته الله, i respektonte me rigorozitet të drejtat njerëzore. Kur i vinte lajmi për vdekjen e dikujt, i lutej Allahut që ta mëshironte dhe këndonte ajetin:


إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ

“...Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi.” (Bekare, 156). Ai merrte pjesë në namazet e xhenazeve, lutej dhe këndonte Kuran.



Për namazet e xhumasë dhe të bajramit vishte roba të bukura. Kur dëshironte të vishte ndonjë robë të re, në fillim ia vishte njëherë shërbyesit, ose ndonjërit prej familjes. Në shumicën e rasteve, rreth tij gjendeshin 50-60 vetë, madje edhe 100 vetë. Në kuvendet e tij gjendeshin përherë dijetarë, njerëz të urtë, mësues, hafiza dhe njerëz me pozita të larta, të cilët i ushqente të gjithë prej shtëpisë së tij.³⁵

Ai e respektonte jashtëzakonisht edhe etikën fetare. Njëherë, kur një prej hafizëve filloi të këndojë Kuran, vuri re se ai qëndronte në një ndenjësë më të ulët se ndenjësja mbi të cilën qëndronte vetë. Për këtë arsye, ai u ngrit dhe e hoqi menjëherë ndenjësen e vet, duke qëndruar kështu më poshtë se hafizi.³⁶

Imam Rabbani , ishte shumë modest dhe i thjeshtë. Këtë e tregon qartë edhe metoda e tij në letrat dhe veprat që shkruante, ku veten e tij e identifikonte gjithmonë si, “fakir/i gjorë”, ose “dervish”.³⁷

Në një prej letrave të tij, shprehet:

“...Ky i gjorë, dëshiron të ofrojë veten në mbështetje të Islamit dhe përpiket me aq sa ka mundësi në këtë rrugë. Duke u nisur nga urtësia se, «kush e shton hijen e një populli, ai është prej

35. Ebu'l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, s. 187-188.

36. Kişmi, *Berekat-ı Ahmediyye*, s. 199.

37. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 120, no: 261.



tyre.»³⁸ shpresohet që ky rob i gjorë dhe i dobët, do të përfshihet në atë grup. Gjendja ime i ngjan asaj plakës që shkoi në tregun ku shitej Jusufi عليه السلام dhe deshi ta blinte atë me shtëllungën e leshit që kishte në dorë.»³⁹

Dobësia e mendjes dhe nevoja e profetësisë

Sipas Imam Rabbanit mendja dhe frymëzimi janë shumë të dobëta në kuptimin e duhur të individualitetit dhe cilësive të Allahut dhe në arritjen e diturisë absolute. Përfundimet që mund të arrijnë mendja dhe frymëzimi dhe dijet që zbulojnë ato, nuk mund të jenë kurrë të pastra prej dyshimit, hezitimit, gabimit dhe mangësive. Prandaj, kuptimi i drejtë i domethënies së jetës dhe gjithësisë dhe njohja e Allahut ashtu siç është në të vërtetë, bëhet e mundur vetëm në sajë të profetëve, të cilët janë burimet e të vërtetave absolute të frymëzuar prej shpalljeve hyjnore. Ashtu siç aftësia dhe fuqia e perceptimit që ka mendja, është përtej shqisave të shikimit dhe dëgjimit, ashtu edhe aftësitë dhe kompetencat e profetësisë janë përtej mendjes. Për rrjedhojë, edhe mënyrën e madhërimit, adhurimit dhe bindjes ndaj urdhrave hyjnore të Allahut të Madhëruar, mund të na e tregojnë vetëm profetët.

38. Ibn-i Mubarek, *Kitabu'z-Zuhd*, I, 12; *Zeyla'i*, *Nasbu'r-Raye*, IV, 346; *Acluni*, *Keşfu'l-Hafa*, II, 374.

39. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 244, no: 47.



Filozofët, të cilët e konsiderojnë mendjen si një qenie e cila ka fuqi të pakufishme në arritjen e të vërtetave, duke e matur çdo gjë me anë të saj, kanë bërë gabime shumë qesharake në çështjen e njohjes së Allahut. Ashtu siç nuk ekziston asnjë mendje plotësisht e pastër, ashtu nuk mund të bëhet fjalë as për një frymëzim të pastër e të liruar prej dëshirave të egos dhe ndikimeve të jashtme.

Është e pamundur që mendja të jetë e papërzierë, e patëmeta dhe plotësisht e pastër, sepse ajo ndikohet nga opinionet, mendimet e kthyer në besime dhe influencat e jashtme. Ajo nuk mund të shpëtojë nga dobësitë si lakmia, zemërimi dhe ambicia, e as prej të metave si harresa, hutimi dhe gabimet. Shumë gjykime të saj, dalin në pah të ngjyrosura me ngjyra të jashtme dhe të përziera. Për këtë arsye, mendja nuk është një burim patëmeta, por përkundrazi, e pamjaftueshme.

Përkundër kësaj, meleku që u ka sjell shpalljen hyjnore profetëve, është i pastër prej të gjitha këtyre të metave dhe është i paprekshëm nga çdo ndikim negativ. Prandaj, burimi më i pagabueshëm dhe më i saktë, është profetësia. Pa institucionin e profetësisë, edhe pastrimi i vërtetë i egos do të ishte i pamundur.⁴⁰

Lidhur me këtë çështje, dijetari, historiani dhe sociologu i madh Islam, Ibn Halduni ka thënë:

40. shih. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 150, no: 266; III, 239-242, no: 23; Ebu'l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, s. 203-204, 227.


“Mendja është një peshore e drejtë. Por, me të nuk mund të peshoni çështjet në lidhje me Allahun, të vërtetat profetike dhe ato përtej mendjes. Kjo do të ishte një përpjekje e kotë dhe i ngjan atij që dëshiron të peshojë malet me peshoren e argjendarit, për të parë se sa saktë peshon ajo. Lidhur me saktësinë e peshores s’mund të thuhet asgjë, por fuqia e saj ka një kufi. Po kështu, edhe fuqia e mendjes për të «ditur, gjetur dhe kuptuar», ka një kufi, jashtë së cilit ajo s’mund të hedhë asnjë hap.”⁴¹

Metodat filozofike dhe të ngjashme me to, pretendojnë se mund ta kuptojnë të vërtetën me përpjekjet e veta pa nevojën e kumtimit dhe udhëzimit të profetëve. Mirëpo, këto të vërteta nuk mund të mësohen pa ndërmjetësimin e robërve të veçantë, të cilëve Allahu i Madhëruar u ka dhënë profetësinë. Ata janë mirësia më e madhe e Allahut për të gjithë njerëzimin. Me anë të mendimit filozofik mijëvjeçar, kërkimeve, analizave, vëzhgimeve dhe purifikimit të egos, njerëzit nuk mund të arrijnë qoftë edhe një grimcë të asaj diturie të mrekullueshme që na kanë sjellë profetët në lidhje me individualitetin dhe cilësitë e Allahut, pa pritur asgjë në këmbim “**...Kjo është dhuntia e Allahut ndaj nesh dhe njerëzve të tjerë, ndonëse shumica e njerëzve nuk janë mirënjohës.**” (Jusuf, 38)⁴²

41. Ibn-i Haldun, *Mukaddime*, s. 473.

42. Ebu'l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, s. 211-212.

Fjala e teuhidit dhe dhikri i vazhdueshëm

Duke treguar madhështinë e Fjalës së Teuhidit, Imam Rabbani , shprehet:

“Mendoj se fjala «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» / **La ilahe il-lallah**» është çelësi i nëntëdhjetenëntë mëshirave që Allahu i ka ruajtur për ditën e gjykimi. Unë di se nuk ka asgjë tjetër më të efektshme për të eliminuar errësirat e mohimit dhe mbetjet e idhujtarisë sesa kjo fjalë e bukur...

Në këtë botë, nuk ka asnjë dëshirë të ngjashme me dëshirën e një njeriu për t’u tërhequr në një cep me qëllim që të arrijë kënaqësinë shpirtërore duke bërë këtë dhikër. Mirëpo, për fat të keq, është e pamundur të arrish çdo dëshirë. Ndonjëherë, shkujdesja të pengon nga kjo, sepse duhet të përzihesh me njerëzit.”⁴³

Ja disa thënie të Imam Rabbanit, ku ai këshillon dhikrin e vazhdueshëm:

“Ai që e dëshiron këtë rrugë, pasi të ketë rregulluar besimin e tij në bazë të mendimeve të ehli sunnetit, të ketë mësuar mirë vendimet e fikhut dhe të ketë punuar siç duhet me ato që di, duhet ta shpenzojë të gjithë kohën e tij duke bërë dhikër Allahun. Mirëpo, është kusht që ky dhikër të merret prej një shejhu që gëzon gradat e duhura shpirtërore, sepse ai që ka mangësi për vete, nuk mund t’i

43. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 591-594, no: 37.



përsosë të tjerët... Ai duhet të merret vazhdimisht me dhikër, qoftë me abdest apo pa abdest, ulur apo në këmbë... Ai nuk duhet ta braktisë asnjehere dhikrin, edhe nëse është duke ikur, duke ardhur, duke ngrënë apo edhe duke u shtrirë.”⁴⁴

“Ta dini mirë se, lumturia dhe shpëtimi juaj, e madje i gjithë njerëzve, varet nga dhikri që i bëni Allahut. Prandaj, brenda mundësive, të gjithë duhet t’ia kushtojmë kohën tonë dhikrit të Allahut. Dhe, në këtë çështje nuk është e drejtë të bëhet qoftë edhe një çast shkujdesje.”⁴⁵

Kafshata hallall

Imam Rabbani رحمته عليه ka thënë:

“Ju këshilloj të bëni kujdes për kafshatën që hani! Nuk është e drejtë që njeriu të hajë çdo gjë pa menduar se nga vjen dhe a është hallall apo haram, sepse ai nuk është lënë pa mbikëqyrje që të veprojë çfarë të dojë. Përkundrazi, ai ka një Zot, i Cili i ka dhënë disa urdhra dhe ndalesa. Me anë të profetëve, Ai u ka bërë të ditur ato që i pëlqen dhe nuk i pëlqen. Kush rend pas dëshirave që janë kundër pëlqimit të Allahut do të humbasë lumturinë e përjetshme...”⁴⁶

“Duhet që pesë namazet farz të falen me xhemat dhe të bëhet dallimi mes hallallit dhe

44. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 454, no: 84.



45. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 569, no: 190.

46. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 44, no: 69.



haramit... Kënaqësive të përkohshme dhe mirësi-
ve kalimtare nuk duhet tua hedhësh fare shikimin.”⁴⁷

Rëndësia e bisedave fetare

Imam Rabbani  na kujton shpesh se “biseda fetare” është një element shumë i rëndësishëm në rrugën Nakshibendije dhe, prej Haxhe-i Ahrar  transmeton këtë ndodhi:

“Ishim bashkë me dervishët, ndërkohë që u hap fjala për kohën kur pranohen duatë e ditës së xhuma. Dikush pyeti:

«Nëse bëhet kështu arritja e kësaj kohe, çfarë duhet të kërkohet nga Allahu i Madhëruar?»

Të gjithë thanë diçka. Por kur më erdhi radha mua, thashë:

«Duhet të kërkohet biseda e të gjithë njerëz-
ve të përsosur, sepse brenda tyre gjendet të gjitha lumturitë.»⁴⁸

Imam Rabbani, në një letër të tij e ka shpjeguar kështu rëndësinë e bisedave fetare:

“Asgjë mos e barazo me bisedën fetare! A nuk e sheh se sahabët, në sajë të bisedave me të

47. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 467, no: 143.

48. **Cem’iyyet:** Salikin butun himmetini Allah’a teveccuh noktasında toplamayı ve masıvayı terk edip sadece O’nunla meşgul olması halidir. Diğer bir ifadeyle, kalpte hasıl olan manevi toparlanma, huzur ve Allah Teala ile beraberlik halidir.



Dërguarin e Allahut, u bënë më të mirët prej të gjithëve, jashtë profetëve. Të tjerët jashtë sahabëve, qoftë Veysel Karani, e qoftë Omer Ibn Abdulazizi, janë të gjithë në një gradë më të ulët se sahabët. E në fakt, këta njerëz të mirë arritën grada të larta, por nuk arritën të merrnin pjesë në bisedat e Profeti ﷺ...

Nëse Veysel Karani do ta dinte se bisedat fetare do të ishin kaq të rëndësishme, asgjë nuk do ta pengonte atë nga pjesëmarrja në kuvendet e Profetit (a.s.) dhe ai nuk do të zgjidhte asnjë virtut tjetër përveç këtij.”⁴⁹

Shfrytëzimi i mundësive

Imam Rabbani رحمته الله e konsideronte si një mundësi këtë jetë të shkurtër të kësaj bote dhe nxënësit e tij i këshillonte që ta shfrytëzonin mirë atë. Në një nga letrat e tij shprehet kështu:

“Biri im i shtrenjtë! Mundësia është mirësi. Është e domosdoshme që asnjë çast i jetës të mos kalohet me punë të padobishme. Përkundrazi, duhet që të gjithë jetën ta përdorësh në rrugë të Allahut të Madhëruar. Pesë kohët e namazit duhen falur me xhemat, duke respektuar të gjitha normat dhe rregullat e tij. Namazi i natës nuk duhet neglizhuar dhe mundësia për të bërë istigfar në kohën e agimit nuk duhet humbur asnjëherë. Nuk




duhet të mashtrohem me gjumin e ëmbël dhe nuk duhet të kaplohem prej kënaqësive të çastit. Duhet të meditojmë shpesh mbi vdekjen dhe gjithmonë duhet t'i kemi parasysh shqetësimet dhe frikën në lidhje me botën tjetër.

Me pak fjalë, duhet t'i kthejmë shpinën kësaj bote dhe duhet të drejtohem nga bota tjetër. Lidhja jonë me këtë botë, duhet të jetë aq sa është e nevojshme dhe pjesën tjetër të kohës duhet ta ndajmë të gjithën për punët e botës tjetër.

Si përfundim, mund të themi se; duhet ta shpëtojmë zemrën tonë nga robëria e çdo gjëje tjetër përveç Allahut. Po ashtu, aspektin tonë të jashtëm duhet ta zbukurojmë sipas ligjeve të Allahut. Kjo është gjëja kryesore. Gjithçka tjetër është e pavlerë!”⁵⁰

Ndërsa në letra të tjera shprehet:

“Sipas rregullit, «ajo që nuk arrihet e plotë, nuk braktiset e gjitha», disa ditë të jetës sonë, duhet t'i kalojmë duke e pasuar Profetin , me sa fuqi që kemi, sepse shpëtimi prej dënimit në botën tjetër dhe arritja e mirësive të përjetshme, është e lidhur fort me lumturinë e këtij pasimi.”⁵¹

“Koha për të bërë vepra të mira, është padyshim ajo e rinisë. Njeriu i mençur, nuk e çon dëm këtë kohë, por e shfrytëzon atë në mënyrën

50. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 552, no: 31.

51. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 298, no: 70.



më të mirë, sepse njeriu nuk e ka aspak të sigurt se mund të arrijë pleqërinë. Por, edhe nëse e arrin, ai do ta ketë të vështirë të bëjë vepra të mira kur të bjerë në kthetrat e dobësisë së pleqërisë. Ndërkohë që në rini, është më e lehtë t'i përkushtohesh Allahut në çdo aspekt...

Kjo është koha e fuqisë dhe mprehtësisë, e cila duhet të shfrytëzohet mirë. Atëherë, çfarë justifikimi mund të ketë lënia e një pune për të nesërmen? Cili arsyesim mund ta legjitimojë këtë neglizhencë?"⁵²

"Vëlla i shtrenjtë! Kjo është koha kur duhet punuar, e jo kur duhet bërë fjalë. Është koha kur zemra duhet të lidhet pas Allahut nga brenda dhe nga jashtë. Pa lejen e Allahut, nuk duhet parë askush tjetër përveç Tij. Kjo ka rëndësi, të tjerat janë padobi!"⁵³

"Mik i shtrenjtë! Koha që duhet shfrytëzuar për të punuar po ikën. Çdo çast pakësohet një pjesë prej jetës sonë dhe exheli i caktuar prej Allahut po na afrohet. Nëse nuk arrijmë të zgjohemi sot, nesër, e vetmja gjë që do të fitojmë, mund të jetë vetëm malli dhe pendimi.

Duhet të tregojmë kujdes, që në këto ditë të numëruara, të kryejmë punë të mira në përputhje me ligjet e Allahut, me qëllim që të bartim shpresat për shpëtim. Kjo është koha e punës, e jo e rehatisë, sepse rehatia është fryt i punës. Puna ësh-

52. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 307, no: 73.

53. Imam Rabbani, *Mukaşefat-ı Gaybiyye*, 20. kısım.



të ende para nesh. Prandaj, të shikosh rehatinë në kohë pune, do të thotë të çosh dëm të mbjellat.”⁵⁴

Braktisja e egos

Braktisa e egos/unit, është kushti i parë i përparimit shpirtëror. Pa u braktisur egoja, nuk mund të arrihet dashuria hyjnore. Lidhur me këto të vërteta, Imam Rabbani, shprehet:

“Zemra nuk mund të dojë dy gjëra në të njëjtën kohë. Kur lidhëza e dashurisë së zemrës lidhet pas diçkaje, aty nuk ka më vend për dashuri tjetër. Nëse njeriu ka shumë dëshira dhe lidhet fort pas gjërave të tilla si pasuria, fëmijët, pushteti, lavdërimi, etj., në të vërtetë, ai dashuron vetëm një gjë. Dhe ajo është egoja (vetja) e tij. Pra, dashuria ndaj atyre gjërave, në fakt është shprehje e dashurisë ndaj vetes, sepse ky njeri nuk i do ato për ç’ka janë, por për veten e tij. Nëse zhduket dashuria e tij ndaj egos, atëherë zhduket edhe dashuria ndaj gjërave të tjera. Për këtë arsye është thënë:

«Perdja mes robit dhe Zotit, nuk është bota, por vetja e tij.»

Pra, dëshira dhe dashuria kryesore e robit, është vetëm egoja e tij. Dhe, perdja, e cila është pasoja e paevitueshme e kësaj, është vet egoja e robit. Pa u zhveshur plotësisht prej dëshirave të egos, robi nuk mund ta vendosë dashurinë për Zotin në zemrën e tij.”⁵⁵

54. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 91, no: 89.

55. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 163-164, no: 24.



Imam Rabbani, i ka këshilluar bijtë e tij që ta shpëtojnë zemrën e tyre prej dashurisë për gjërat e përkohshme dhe ta orientojnë atë drejt dashurisë hyjnore:

“Mos u kënaqni me asgjë tjetër përveç atyre me të cilat është i kënaqur Allahu i Madhëruar! Mos i dëshironi ato! Meqenëse ato do të shkëputen prej nesh sapo të largohemi nga kjo botë, le t’i braktisim që tani! Mos t’u japim rëndësi atyre! Njerëzit e devotshëm i braktisin me dëshirën e vet këto.”⁵⁶

Vdekja

Disa muaj para se të ndërronte jetë, Imam Rabbani, filloi të ndjente ngushtim në frymëmarrje. Në ditët e fundit, u tha bijve të tij:

“Bijtë e mi të shtrenjtë! Me këtë botë nuk më mbeti më asnjë lidhje. Tashmë, mendimi për botën e përjetshme, më mbizotëron. Duket se dita e udhëtimit tim është afër.”

Më pas, preu të gjitha marrëdhëniet me botën e jashtme dhe preferoi të qëndronte vetëm. Ai nuk dilte më jashtë përveçse për namazet farz dhe për namazin e xhumasë. Pjesën tjetër të kohës e kalonte duke përmendur Allahun dhe duke kërkuar falje prej Tij. Kjo gjendje, ishte zbatim i ajetit fisnik: **“Përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoju plotësisht Atij!”** (Muzzemmil, 8)

Nga dëshira e madhe për t’u takuar me Allahun,



shpeshherë derdhte lot dhe nuk i hiqte prej gojës këto fjalë: “اللَّهُمَّ الرَّفِيقَ الْأَعْلَى: të cilat nënkuptonin se ai donte të ishte në Xhenet bashkë me miqtë e Allahut të Madhëruar. Ndërkohë, disa ditë i kaloi i qetë. Zemrat e plagosura dhe të hidhëruara gjetën pak qetësi. Mirëpo ai tha:

“Kënaqësinë që ndjeja kur isha sëmurë, nuk po e gjej në këto ditë që jam i qetë!”

Ato ditë shpërndau sadaka me shumicë dhe bëri bamirësi. Kur njëri prej miqve të afërt pa se sa shumë sadaka po jepte, e pyeti:

“A janë këto për të larguar fatkeqësitë?” Imam Rabbani, u përgjigj:

“Jo, përkundrazi janë nga dëshira për të takuar Allahun!”

Një ditë, fëmijët e tij e panë atë duke qarë dhe kur e pyetën për shkakun, Imam Rabbani tha:

“Po qaj nga gëzimi i takimit me Allahun!” Djemtë e pyetën:

“Edhe pse nuk e keni zakon, ditët e fundit po na privoni prej mirësisë suaj?” Ndërsa Imami u përgjigj:

“Allahu i Madhëruar për mua është më i dashur se ju!”

Ditët e tij të fundit, i kaloi duke treguar për mirësitë e pafundme të Allahut. Të gjitha veshjet e veta ia shpërndau nevojtarëve. Dhe, për shkak se nuk kishte asnjë veshje pambuku, i ftohti i shkaktoi



përsëri temperaturë të lartë. Ashtu si Profeti ﷺ, i cili para se të ndërronte jetë u përmirësua pak dhe më pas u rëndua përsëri, edhe Imam Rabbanit u rëndua përsëri sëmundja.

Edhe ato ditë kur nuk kishte fuqi, ai nuk fali asnjë namaz pa xhemat. Po ashtu, ai kryente vazhdimisht edhe dhikrin dhe nuk hoqi dorë nga asnjë prej urdhrave dhe parimeve të sheriatit dhe tarikatit. Ai vazhdoi të falte namaz nate deri natën e tij të fundit.

Njerëzit përreth i këshillonte vazhdimisht të lidheshin fort pas sunnetit, të ruheshin nga bid'atet dhe të kryenin adhurimet dhe dhikrin:

“–Profeti ﷺ, i cili ka qenë përfaqësues i ligjit të Allahut (sheriatit), ka thënë se «*Feja është këshillë.*» (Muslim, Iman, 95) Për rrjedhojë, ai nuk u kursye kurrë nga puna dhe përpjekja në të mirë të umetit të tij. Duhet punuar me librat fetarë të besueshëm. Në lidhje me përgatitjen e xhenazes sime veproni plotësisht sipas sunnetit dhe mos braktisni asnjë sunet!”

Ndërsa bashkëshortes së vet i tha:

“–Më duket se emigrimi im në botën tjetër do të jetë para teje! Përgatitjet e xhenazes sime bëji me mehrin tënd!” E në fakt, mehri i gruas është prej pasurive më hallall.


Ai qëndronte gjithmonë me abdes, me qëllim që të kishte mundësinë të jepte shpirt i pastër. Kur u shtri në shtratin e vet në momentet e fundit, e mbështeti faqen e djathtë mbi dorë dhe filloi të bënte dhikër. Kur bijtë e tij vunë re se ai po merrte frymë shpejt, e pyetën:



“Si jeni?” Imami tha:


“Ne jemi mirë!”

Pas kësaj, nuk tha asgjë tjetër përveç emrit të Allahut. Dhe, pas një kohe të shkurtër ia dorëzoi shpirtin Allahut të Madhëruar.

Imam Rabbani , ndërroi jetë më 28 Safer të vitit 1034 (10 dhjetor 1624) në moshën 63 vjeçare. Kur trupi i tij i soll për t’u larë, njerëzit vunë re se Imam Rabbani i kishte duart të lidhura si në namaz. Ata ia zgjidhën duart, por pasi e lanë, vunë re se ai i kishte përsëri të lidhura si më parë. Edhe pasi e qefinosën vunë re se ai i kishte duart të lidhura sipas sunnetit. Për rrjedhojë, bijtë e tij thanë:

“Meqenëse Imami dëshiron kështu, atëherë kështu t’i lëmë.”

Njerëzit qanin, ndërkohë që fytyra e Imamit ndriçonte nga një buzëqeshje e pashpjegueshme. Ashtu siç e la amanet, përgatitja e xhenazes së tij u bë sipas sunnetit dhe u varros në vendlindjen e tij, në qytezën Sirhind të Indisë.⁵⁷

Imam Rabbani  ishte një mik i Zotit, emri i të cili u bë i njohur jo vetëm në kohën e vet, por edhe në shekujt e mëpasshëm, deri në ditët tona. Në sajë të veprave të tij, ai vazhdon edhe sot të frymëzojë dhe të bëhet shkak udhëzimi i shumë njerëzve.

57. shih. Kişmi, Berekat-ı Ahmediyye, s. 300-315; Ebu’l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, s. 174-179; Bedreddin Sirhindi, *Visal-i Ahmedi* (nşr. Gulam Mustafa Han), Karaçi 1388/1968, s. 6, 12, 26.



Disa prej këshillave të tij të urta

“Biri im! Mirë është të qëndrosh larg nga mubahet⁵⁸ e tepërta dhe të mjaftohesh me ato më të nevojshmet. Madje, edhe ato duhet t’i përdorësh për të fituar forcën trupore dhe vigjilencën shpirtërore me qëllim që t’i kryesh sa më mirë detyrat e devotshmërisë ndaj Allahut.”⁵⁹



“Kohën nuk duhet ta kalosh me lojëra e argëtime... Krahas largimit nga punët e ndaluara, jeta nuk duhet shkuar kot as me punët e padobishme. Bëj kujdes të mos jepesh pas veglave muzikore dhe këngës dhe të shkosh drejt mashtrimit të madh, duke ndjerë kënaqësi prej tyre! Kjo, sepse veglat muzikore (të cilat ngacmojnë egon), janë helme të lyera me mjaltë.

Ruhuni prej përgojimit dhe thashethemeve! Sepse ndaj atyre që i veprojnë këto dy gjëra të shëmtuara, ka kërcënime të rënda. E rëndësishme është të ruhesh shumë edhe prej gënjeshtërisë dhe shpifjes, sepse këto dy poshtërsi janë të ndaluara në të gjitha fetë. Ata që i veprojnë këto, do të përballen me rreziqe të mëdha.

Mbulimi i të metave dhe gjynaheve të njerëz-





58 Mubah: Një punë për të cilën nuk përfitohet as sevap, e as gjynah (si ushqimi, pija etj).

59. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 306, no: 73.



ve dhe falja e gabimeve të tyre, kanë sevape të mëdha.”⁶⁰



“Pasimi i Profetit , dhe i njerëzve me zemër të pastër e ngre robin në grada të larta. Ebu Bekri , pasoi gjithmonë Profetin , e besoi atë me gjithë shpirt dhe u bë prijësi i besnikëve. Kurse Ebu Xhehli i mallkuar, i cili nuk e pasoi Profetin , për shkak të egos së tij të ulët, u bë prijësi i të mallkuarve.”⁶¹



“Dashuria e dijetarëve për këtë botë, është një njollë mbi fytyrat e tyre të bukura. Edhe nëse dija e këtyre lloj dijetarëve u bën dobi njerëzve, për ata vet nuk ka asnjë dobi. Sado që forcimi i fesë është lënë mbi supet e këtyre, kjo nuk merret për bazë, sepse forcimi i fesë mund të arrihet edhe me dorën e disa njerëzve të padrejtë dhe gjynahqarë... Mirëpo, nëse dijetarët nuk tregohen të dhënë pas kësaj bote dhe e eliminojnë dashurinë për pozitë, pushtet, pasuri dhe epërsi, ata bëhen trashëguesit e vërtetë të profetëve. Krahas kësaj, ata bëhen më të mirët ndër të gjitha krijesat.”⁶²



60. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 292, no: 34.

61. Imam Rabbani, *Mebde ve Mead*, 51. kısım.

62. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 197-199, no: 33.



“Kjo botë, është ara e botës tjetër. Turp për ata që nuk e mbjellin këtë arë dhe e lënë djerrë këtë tokë pjellore, duke i çuar dëm farat e veprave të tyre! Duhet ditur se, shpërdorimi i tokës, bëhet atëherë kur aty nuk mbillet asgjë, ose mbillen fara të prishura. Dhe, dihet mirë nga të gjithë se, dëmi i këtyre të dytëve, është më i madh në krahasim me këta të parët.”⁶³



“Të dihet se, një ajet i zbritur mbi një ngjarje të veçantë, ka dobi të plotë në atë çështje edhe për atë që e lexon atë ajet. Për shembull, leximi i një ajeti në lidhje me pastrimin e egos, ndikon shumë në pastrimin e egos nga veset e këqija. Kjo vlen edhe për ajetet e tjera.”⁶⁴



(Allahu i Madhëruar u mëson robërve të Vet këtë lutje:

“...O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!” (Furkan, 74)

Pra, nuk mjafton të jesh i devotshëm, por duhet të përpiqesh të jesh ndër të parët në devotshmëri.)



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani

RAHMETULLAHI ALEJH

Abdullah ibn Dejlami,
në lidhje me ndjekjen e sunetit me bindje
dhe dorëzim të plotë, është shprehur:

*“...Fillimi i humbjes (dobësimit) së fesë,
do të jetë në braktisjen e sunetit. Siç zgjidhet
litari fije fije dhe në fund këputet, ashtu edhe feja
humbet me braktisjen një nga një të suneteve.”*

(Darimi, Mukaddime, 16)



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani رحمته عليه -1-

I nderuari Imam Rabbani thotë:

“E cila është pjesa jonë në përpjekjet për t’u bërë një rob i mirë i Allahut!? Çdo gjë që kemi, është mirësi e Allahut. Por nëse patjetër na duhet të tregojmë një arsye për këtë, mund të them, se shkak i të gjitha këtyre mirësive, është lidhja pas Resulullahut صلى الله عليه وسلم dhe ndjekja e gjurmëve të tij...

Nëse njeriu nuk ka pasur sukses në arritjen e ndonjë pune, ose të një pjese të saj, shkak për këtë mund të jetë mangësia në ndjekjen e plotë të sunetit të Resulullahut صلى الله عليه وسلم.

Njëherë u tregova u shkujdesur dhe hyra në abdes’hane me këmbën e djathtë. (Për shkak të kësaj sjellje që nuk përshtatet me sunetin e Resulullahut صلى الله عليه وسلم) Atë ditë u privova nga shumë mirësi shpirtërore.”⁶⁵

[Frymëzimi shpirtëror që e afron robin me Allahun, mund të arrihet vetëm me dorëzimin dhe bindjen e plotë ndaj të Dërguarit të Allahut صلى الله عليه وسلم. Në Kuranin fisnik, urdhërohet:

65. Kishmi, *Berekat*, f. 197.



“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet!..” (Al-i Imran, 31)

Pra, dashuria e Allahut të Madhëruar mund të arrihet vetëm duke iu bindur e dorëzuar të dashurit të Tij, e veçanërisht duke ndjerë dashuri për të. Atij që neglizhon sado pak në këtë rrugë, ngurron apo dyshon, dera e dashurisë hyjnore i mbetet e mbyllur. Ekzistojnë ajete të qarta që tregojnë se dashuria për Pejgamberin ﷺ, është dashuri për Allahun; bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut; e mosbindja ndaj tij, është mosbindje ndaj Allahut.


Për këtë arsye, besimtari, çdo punë të tij, qoftë e madhe apo e vogël, është i detyruar ta bëjë me kujdesin dhe me respektin më të plotë ndaj Sunetit Pejgamberik, pra simbas stilit të jetës së Pejgamberit ﷺ, të Dashurit të Allahut, i cili është edhe interpretimi praktik i Kuranit Fisnik.

Është fakt, se -në përgjithësi- besimtarët që kapen siç duhet pas sunetit të Pejgamberit ﷺ, i zbatojnë me përpikëri farzet dhe nuk lëshojnë apo lënë mangët diçka prej tyre. Ndërsa, ata që neglizhojnë sunetet, janë më të prirur të kenë firo edhe në farze.

Nisur nga ky postulat, kujdesi në respektimin e sunetit është si një mburojë e fortë që merr nën mbrojtje edhe farzet të cilat janë pjesët themelore të jetës fetare. Për këtë arsye, kur iblisi dhe ndihmësit e tij i ngjiten fesë dhe besimit të një njeriu, në fillim



përpiqen ta largojnë atë nga sunetet. Por nëse nuk arrijnë të kenë sukses në këtë pikë, ata e dinë shumë mirë se farzet nuk mund t'i prekin dot kurrë.

Për këtë arsye, Abdullah ibn Dejlami , në lidhje me ndjekjen e sunetit me bindje dhe dorëzim të plotë, është shprehur:

“Fillimi i humbjes (dobësimit) së fesë, do të jetë në braktisjen e sunetit. Siç zgjidhet litari fije fije dhe në fund këputet, ashtu edhe feja humbet me braktisjen një nga një të suneteve.” (Darimi, Mukaddime, 16)

Nisur nga kjo, dalja e suneteve një nga një prej jetës sonë, -Allahu na ruajttë- e vështirëson shpëtimin tonë të përjetshëm në botën tjetër. Nëse shohim historinë e feve, vërejmë se edhe Hebraizmi dhe Krishterimi kështu kanë filluar të dëmtohen. Në fillim, ata kanë braktisur sunetet e pejgamberëve, më vonë u është larguar edhe besimi, edhe adhurimi. Si përfundim, u braktis namazi dhe në vend të tij u futën meshat e ceremonitë; u braktis agjërimi dhe në vend të tij zuri vend pehriza; mbulesa e femrës u braktis, duke ngelur e veçantë vetëm për murgeshat, madje në ditët tona, edhe murgeshat kanë filluar ta heqin mbulesën.

Në këtë pikë, si besimtarë që jemi, të gjithë ne duhet të tregohemi të urtë dhe të jemi të vetëdijshëm se në ditët tona, armiqtë e hapur dhe të fshehtë po përpiqen me të gjitha mundësitë që ta realizojnë edhe mbi Islamin dëmin që arritën t'i bëjnë krishterimit. Ata, me qëllim që të mos e bëjnë të qartë synimin e tyre të vërtetë, në fillim nuk sulmojnë parimet themelore të fesë dhe ligjet që janë farz, por mundohen që të



zhvlerësojnë sunetet, të cilat luajnë rolin e mburojës së bazave.

Por më e keqja është se, në ditët tona në të cilat po përhapen shumë idetë dhe mendimet që janë larg ehl-i Sunetit ue xhematit, dhe kur besimi i shumë muslimanëve po lëkundet e adhurimet dhe veprat e tyre po tronditen, brenda këtyre lëvizjeve për prishje shpesh vihen re edhe njerëz që kanë cilësinë e dijetarëve të fesë dhe mësuesve të teologjisë. Këta persona po pështjellojnë mendjet dhe po turbullojnë zemrat edhe në çështje që kanë arritur konsensus nga dijetarët që prej 1400 vjetësh.


Për shkak të mendjeve të tyre të kufizuara, këta njerëz i mohojnë mrekullitë dhe përpiqen të bëjnë ndryshime sipas qejfit të tyre edhe në kodin ligjor të trashëgimisë, duke e ditur se në këtë çështje ka argumente të prera dhe nuk ka nevojë për interpretime. Ata e nënvleftësojnë mbulesën e gruas, refuzojnë hadithet që nuk u përshtaten mendimeve të veta dhe sunetet i shohin si të parëndësishme.

Me anë të sloganit “Ne na mjafton Kurani!”, që i bën të duken sikur janë në rrugë të drejtë, ata e përjashtojnë sunetin e pejgamberit, i cili është edhe shpjegimi, komentimi dhe zbatimi në jetë i Kuranit Fisnik, dhe mundohen të nxjerrin sipas qejfit të tyre, gjoja një “Islam të Kuranit”.

Në lidhje me këta “dëmtues të fesë” të veshur me rrobën e “dijetarit të fesë”, të cilët duke nxjerr Kurandin në plan të parë i fshehin qëllimet e tyre të vërteta, Resulullahu, ﷺ, shprehet:



“Kujdes! Mua më është dhënë Libri dhe një i ngjashëm me të. Kujdes! Është afër koha kur një person me barkun plot dhe i mbështetur në kolltukun e tij do t’ju thotë: «Duhet të ndiqni këtë Kuran. Hallalli që gjeni aty është hallall dhe harami që gjeni aty është haram (s’keni nevojë për burim tjetër!). Kujdes! Ato që ndalon i Dërguari i Allahut, janë njësoj si ato që ndalon Allahu.”⁶⁶

Ndërsa në një transmetim tjetër, Resulullahu,  shprehet se ndjekja e sunetit është e detyrueshme dhe thotë:

“A mendon dikush prej jush, i mbështetur në kolltukun e tij se, përveç këtyre që Allahu i ka ndaluar në këtë Kuran, nuk ka ndaluar gjë tjetër?! Kujdes! Vallahi, unë këshillova, urdhërova dhe ndalova. Këto (urdhëra dhe ndalesa) janë po aq sa ka edhe në Kuran, mbase edhe më tepër.” (Ebu Davud, Haraxh, 31)

Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar na tërheq vëmendjen në lidhje me faktin se Kurani mund të kuptohet drejtë vetëm me anë të sunetit:

“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.”
(Shuara, 193-195)

Nisur nga sa thamë, të fshehtat dhe urtësitë e Kuranit mund të kuptohen vetëm nëse merret hise prej

66. Ebu Davud, Sunnet 6, hd. nr: 4604, 4/200; Ibn-i Maxhe, Mukaddime 2, hd. nr: 12, 1/6; Tirmidhi, Ilm 10, 2663, 2801; 5/37; Ahmed ibn Hanbel, 6/8.



zembrës së Pejgamberit ﷺ. Jeta pejgamberike prej 23 vitesh e Muhammedit ﷺ, është nga fillimi deri në fund një interpretim i gjallë i Kuranit. Prandaj, të kuptuarit e Resulullahut, ﷺ, është shkalla më e rëndësishme në devotshmërinë ndaj Allahut. Pa e njohur dhe pa e kuptuar atë, pa ndjekur gjurmët e tij dhe pa marrë hise prej ndjenjave të tij shpirtërore, as besimi ynë nuk do të jetë i plotë, as Kuranin Fisnik nuk do të mund ta kuptojmë ashtu siç duhet dhe as devotshmëria jonë nuk do të jetë e plotë...

Mënyra e zbatimit të një pjese të urdhrave hyjnorë, në Kuranin Fisnik nuk na janë bërë të ditura me detaje. Ato i mësojmë vetëm në saje të zbatimeve të Pejgamberit ﷺ.

Për shembull: Në Kuranin Fisnik është bërë e ditur se ngrënia e ngordhësirave është haram. Mirëpo peshku, i cili kapet i gjallë dhe më pas ngordh vetvetiu, është një përjashtim i këtij rregulli. Këtë ne e mësojmë nga suneti i Pejgamberit ﷺ.

Po ashtu në Kuran urdhërohet edhe namazi, por detajet se si duhet ta falim atë, numrin e rekateve, suret dhe duatë që duhet të lexohen në të dhe çështje të tjera si rregullat e qëndrimit në namaz, ne i mësojmë nga suneti.

Kurani Fisnik, të fshehtat dhe urtësitë e veta, ia mundëson “besimtarëve të devotshëm”. Në lidhje me këtë fakt, në një ajet fisnik thuhet:


“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (Bekare, 2)


Për këtë arsye, ata që e kuptojnë më mirë



Kuranin, janë besimtarët që bëjnë një jetë të devotshme dhe arrijnë nivele të larta shpirtërore. Edhe pse të gjithë lexojnë të njëjtin Kuran, gjithsecili përfiton prej Kuranit sipas nivelit shpirtëror që zotëron.

Kjo ndodhi e **Omerit**  e shpjegon shumë bukur këtë të vërtetë:

Një ditë, kur Omeri , po kalonte para një shtëpie, dëgjoi se i zoti i shtëpisë po lexonte me zë të lartë suren et-Tur. Kur ai arriti tek ajetet:

“Me të vërtetë, dënimi i Zotit tënd do të ndodhë dhe askush nuk mund ta pengojë.” (Tur, 7-8) Omeri  zbriti nga kafsha e tij dhe e dëgjoi për një farë kohe i mbështetur në mur. Më vonë, për shkak se u ndikua shumë nga paralajmërimi i ashpër i këtij ajeti, qëndroi i sëmurë për disa ditë.⁶⁷

Ja pra, Kurani Fisnik është si një oqean paanë e pafund në thellësitë e të cilit mund të zhytesh sipas nivelit shpirtëror. Ashtu si një zhytës i aftë mund të futet në vendet më të thella të detit dhe mund të shikojë pamje e botë të tjera, të çuditshme, të mahnitshme dhe të ndryshme, të cilat nuk mund t'i shohin ata që qëndrojnë në breg, ashtu edhe ata që ngrihen në shkallë të larta shpirtërore në rrugën e devotshmërisë, përballen me shfaqjet e shumë urtësive të Kuranit dhe marrin prej tij frymëzimin e vërtetë shpirtëror.

Mirëpo, të mjerët që bëjnë sikur nuk i shohin këto dhe shumë të vërteta të tjera -gjoja me synimin

67. Ibn-i Rexheb el-Hanbeli, *et-Tahuif mine'n-Nar*, Damask 1979, f. 30.



për zbatuar Kuranin-, e përgjysmojnë fenë, duke u përpjekur që t'ia përshtasin atë mendimeve të tyre të cekëta. Përveç kësaj, ata guxojnë të kritikojnë paturpësisht edhe dijetarët dhe muxhtehidët e mëdhenj, pranë dijes dhe urtësisë së të cilëve nuk janë as çirakët e tyre.


Duke u mbështetur në mendimin se, “-Ata kanë qenë dijetarët e para njëmijë vjetëve dhe tashmë kohët kanë ndryshuar shumë...”, luajnë me ligjet e fesë që janë të pandryshueshme dhe të pandikueshme nga koha. Ky qëndrim e dëmton fenë më tepër se tentativat që kanë bërë orientalistët jomyslimanë dhe misionarët. Këta grupe janë një tufë njerëzish të pavetëdijshëm, të cilët pandehin se të jeshë dijetar i fesë do të thotë ta kritikosh atë në vend që t'i shërbesh.

Nga ky këndvështrim, në mënyrë të veçantë, vëllezërit tanë të rinj që kryejnë studimet në fushën e teologjisë, duhet të tregohen vigjilentë në lidhje me këto çështje dhe të kenë kujdes në përzgjedhjen e burimit nga e mësojnë fenë, sepse Pejgamberi (a.s.) ka porositur një nga sahabët e tij më të dashur, Abdullah ibn Omerin (r.anhum), duke i thënë:

O Ibn-i Omer! Kapu fort pas fesë tënde, kapu fort pas fesë tënde! Sepse ajo është mishi dhe gjaku yt. Bëj kujdes prej kujt e mëson fenë tënde! Dijet dhe ligjet e fesë merri prej dijetarëve që ndodhen në rrugë të drejtë, jo pre atyre që lëkunden sa majtas djathtas!”⁶⁸



Sahabët fisnikë dhe besimtarët e devotshëm që ndoqën gjurmët e tyre dhe u treguan të kujdesshëm në këtë çështje, ndonjëherë, për të marrë një hadith nga një transmetues, udhëtonin drejt dijes për muaj të tërë në kushtet e asaj kohe. Gjithashtu, në sajë të edukimit pejgamberik, ata arritën të bëheshin monumente virtytesh të atillë sa që nuk e konsideronin të vlefshëm as moralin e një njeriu, i cili për të ndjellë kafshën e vet, e mashtronte atë duke i treguar trastën bosh të ushqimit. Pra, personin, në karakterin dhe moralin e të cilit gjendej dobësia e mashtrimit qoftë edhe ndaj një kafshe, nuk e konsideronin të denjë për të transmetuar hadithet, për shkak se ai nuk jetonte në përputhje me hadithet e Pejgamberit ﷺ.

Një nga imamët e famshëm të brezit të tabiinëve, Ebu'l-Alije  thotë:

“Kur ne shkonim tek një person për të marrë (hadith) prej tij, më parë shikonim namazin e tij; nëse namazin e falte në rregull, thoshim se; «ai, edhe punët e tjera i kryen në rregull» dhe uleshim pranë tij. Por nëse namazin e falte pa përkushtim dhe pa respektuar qëndrimin e rregullt në të, thoshim se «ai, edhe punët e tjera i kryen kështu» dhe largoheshim prej tij.” (Darimi, Mukaddime, 38/429)

Ja pra, edhe sot është kusht që dijetarët të cilëve u duhet besuar, të vlerësohen nën dritën e këtyre kritereve, sepse Allahu i Madhëruar në një ajet fisnik njofton:

“...Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (Fatir, 28). Nga ky ajet kuptojmë se kushti i parë i të qenit



një dijetar i vërtetë, duhet të jetë “takua”-ja, pra “frika ndaj Allahut”, sepse Ai vetëm këtë rob e konsideron si “dijetar të vërtetë” dhe jo ata që pa u frikësuar ndaj Allahut dhe pa ju skuqur fytyra ndaj Rasulullahut, ﷺ, pandehin se kriteri i vetëm i së vërtetës janë mendjet e tyre të kufizuara dhe duke e kaluar fenë prej kësaj site, marrin pjesët që u përshtaten mendimeve të tyre dhe hedhin ato që nuk u përshtaten!..

Në thelb besimi është një para-pranim që kërkon aprovimin me zemër të shumë çështjeve, të cilat mendja është e pafuqishme t’i kuptojë plotësisht. Ashtu si syri që ka një largësi të caktuar të shikimit, ashtu edhe mendja ka një aftësi të kufizuar kuptimi; prandaj ajo nuk mund të kuptojë çdo gjë. Mirëpo, a nuk ekziston asnjë e vërtetë tjetër, përtej atyre të cilave mendja njerëzore ka aftësisë t’i rrokë? Përderisa është vetë Allahu i Madhëuar me dijen e Tij absolute, Ai që ia shpjegon të vërtetat e fesë birit të njeriut, i cili ka mendje dhe dije të kufizuar, atëherë natyrisht që ekzistojnë të fshehta dhe urtësi të panumërta të cilat mendja është e paaftë t’i kuptojë.

Ky hadith fisnik na e shpjegon më qartë këtë të vërtetë:

“Gjatë udhëtimit kur Hizri عليه السلام i tregoi Musait عليه السلام ngjarje të çuditshme me kuptime të fshehta, një trumcak u ul në anë të anijes ku kishin hipur ata dhe me sqepin e tij mori ujë nga deti. Duke ia tërhequr vëmendjen mbi këtë veprim, Hizri عليه السلام, i tha kështu Musait عليه السلام:

«Para dijes së Allahut, dija jote, e imja dhe e të



gjitha krijesave, është aq sa uji që mori ky trumcak para ujit të të gjithë detit!» (Buhari, Tefsir, 18/4)

Ashtu siç dija dhe mendja e një milingone është gati zero në krahasim me dijen dhe mendjen e njeriut, ashtu edhe gjendja jonë përballë Allahut të Madhëruar, është veçse një “hiç”. Ato që njeriu di, janë asgjë në krahasim me ato që nuk di. Kjo është edhe arsyeja që një ajet fisnik shprehet se një nga cilësitë e njeriut është **“xhehul”**⁶⁹ pra “shumë i paditur”. Përkundër kësaj, Allahu i Madhëruar, madhështinë dhe pafundësinë e dijës së Tij hyjnore, e shpreh me këto fjalë:

“Sikur të gjithë drurët që gjenden në Tokë të ishin pena, e deti bojë shkrimi e t’i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Lukman, 27)

Për shkak se dija e të gjitha krijesave është sa një pikë prej oqeanit, krahasuar me dijen e Allahut të Madhërua i Cili i krijoi ato, ekzistojnë shumë të fshehta dhe urtësi që njeriu nuk mund t’i kuptojë me mendjen e tij të kufizuar. Një pjesë prej tyre u janë zbuluar njerëzve të zgjedhur, disa të fshehta më të thella u janë zbuluar pejgamberëve dhe disa të tjera edhe më të thella, i janë zbuluar vetëm Pejgamberit tonë ﷺ. Për këtë arsye, Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“Nëse do të dinit ato që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë.” (Buhari, Tefsir, 5/12)

Nisur nga kjo, mendja e kufizuar që na është dhu-

69. shih. Ahzab, 72.



ruar, ka një vlerë vetëm brenda kuadrit të Kuranit dhe Sunetit. Rumi, në lidhje me rëndësinë që ka lënia mënjanë e të gjitha dyshimeve e pyetjeve, duke u dorëzuar me gjithë zemër ndaj Allahut dhe të Dërguari të Tij, shprehet:

“Megjithëse mendja është e suksesshme në çështjet e kësaj bote, për shkak të përbërjes së saj, ajo është e pamjaftueshme për arritjen e së vërtetës, të fshehtës hyjnore, pra njohjen e përkryer të Allahut. Për këtë udhëtim të nivelit të lartë, ka nevojë për një mjet. Ky mjet është shpirti, dashuria dhe pasioni. Ndërsa mendja, iu bëftë kurban Mustafait!”

Vetëm në saje të këtij dorëzimi, mendja mund t'i shërbejë lumturisë së njeriut në këtë botë dhe në tjetrën. Përndryshe ajo vetëm sa e sjellë njeriun vërdallë nëpër qorrsoke.


Ja pra, Allahu i Madhëruar kërkon që ne, në lidhje me pranimin e të vërtetave -si mrekullitë, kaderin dhe besimin në të fshehtën-, të cilat mendja është e paaftë t'i kuptojë plotësisht, të vëmë në punë zemrën, e cila është edhe qendra e një kuptimi më të lartë se mendja. Me këtë, Ai dëshiron që ne të ngrihemi në horizontin e një dorëzimi të plotë.


Besimi i vërtetë, më tepër se shqiptimi me gjuhë, vjen si pasojë e aprovimit me zemër; jo aprovimit me mendje. Të pranosh vetëm ato që t'i merr mendja, nuk do të thotë “të besosh”, por të “bindesh”. Dhe për arsye se kjo nuk përmban asnjë aspekt të dorëzimit ndaj Allahut, nuk ka as vlerë tek Ai.



Shkurtimisht, është kusht që feja jonë madhështore, Islami, të mësohet prej dijetarëve të devotshëm, me moral të bukur dhe që bëjnë një jetë të mbushur me vepra të mira nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit. Të jesh në rrugën e drejtë duke u kapur fort pas Kuranit dhe Sunetit, konsiderohet si mrekullia e ditëve tona.

Kjo gjendje e njerit prej të dashurve të Allahut, Bejazid Bistamiut, është një shembull shumë domethënës në lidhje me evidentimin e atyre që duhen vlerësuar në aspektin e dijës fetare:

Një ditë, Bejazid Bistamiu, doli për udhë së bashku me nxënësit e tij për të vizituar një person i cili ishte bërë i njohur në popull si “evlija”. Kur ai person doli nga shtëpia për të shkuar në xhami, pështyu në drejtim të kiblës. Bejazidi , u prek shumë prej sjelljes së tij të paedukatë dhe u kthye nga kishte ardhur, pa i dhënë fare selam. Ndërsa nxënësve të vet u tha:

“-Ky njeri nuk është i besueshëm as në njërën prej sjelljeve të bukura që na ka mësuar Resulullahu, ! Si t’i besohet atij në lidhje me të fshehtën hyjnore!”^{70]}

I nderuari Imam Rabbani, thotë:

“Kryerja e punëve të pëlqyeshme, nuk duhet neglizhuar, sepse punët e pëlqyeshme janë veprime që Allahu i Madhëruar i do dhe i pëlqen. Nëse njeriu di një punë të mirë në ndonjë cep të tokës, të cilën Allahu e do dhe kënaqet me të, dhe ai ka mundësinë ta kryejë, atëherë duhet

70. Kushejri, Risale, f. 57, 416-417.



ta konsiderojë atë si një mirësi të madhe. Kjo, i ngjan atij që blen diamante të çmueshëm me disa copa vazoje të thyer.”⁷¹

[Një ditë, Imam Rabbani رحمته الله, i thotë njërit prej nxënësve të tij:

“-Më sill ca karafila nga kopshti!” Ai shkoi dhe solli gjashtë karafila. Kur e pa, Imam Rabbani me një qëndrim paksa të mërzitur, tha:

“Nxënësit tanë, ende nuk tregojnë kujdes ndaj fjalës së Profetit tonë të dashur ﷺ, që thotë: «Allahu është tek dhe e do tekun.»⁷² Të tregohesh i kujdesshëm ndaj këtij hadithi, është gjë e pëlqyeshme.

Çfarë pandehin njerëzit se është mustehabi? Një vepër e tillë mustehab me të cilën kënaqet Allahu, nuk ndërrohet edhe nëse të jepet e gjithë kjo botë dhe bota tjetër. Ne e vlerësojmë aq shumë mustehabin, sa që edhe kur lajmë fytyrën, lagim më parë anën e djathtë, sepse të fillosh nga e djathta është mustehab.”⁷³

Siç shihet, gjëja më e jashtëzakonshme që kanë bërë të dashurit e Allahut, dijetarët dhe njerëzit e devotshëm që e kanë njohur mirë Pejgamberin tonë ﷺ është përpjekja e tyre për ta jetuar sunetin Pejgamberik me një përpikëri të veçantë, pa bërë dallim në punë të vogla apo të mëdha.

Nuk duhet ta harrojmë faktin se, me qëllim që ne të përpiqemi në të gjitha veprat e mira dhe të

71. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 172, nr: 266.


72. Buhari, *Deavat*, 68.

73. Kishmi, *Berekat-i Ahmedijje*, f. 198; Ebu'l-Hasan en-Nedvi, *Imam Rabbani*, f. 180-181.



ruhemi nga të këqijat, Allahu i Madhëruar e ka lënë të fshehtë faktin se në cilën vepër shfaqet kënaqësia apo zemërimi i Tij. Si kënaqësia, ashtu edhe zemërimi i Allahut, ndonjëherë mund të shfaqet në një punë të madhe, ndonjëherë në ndonjë punë të mesme dhe ndonjëherë në ndonjë punë shumë të vogël.

Siç na lajmëron edhe një hadith fisnik, një grua gjynahqare e cila i dha ujë një qeni të etur për ujë, u bë prej banorëve të xhenetin në saje të mëshirës që tregoi për të. Përkundër kësaj, një grua tjetër e devotshme në fe, e cila e braktisi macen e saj dhe e la të ngordhte prej urisë, u bë prej banorëve të xhehenemit për shkak se u tregua e pamëshirshme.⁷⁴

Një nga sahabët fisnikë, **Enes ibn Malik**  ka thënë:

“Ju kryeni disa veprime, të cilave nuk u kushtoni rëndësi as sa një qime. Por në kohën e Resulullahut, (a.s.), ato veprime ne i konsideronim si gabime të mëdha e shkatërruese.” (Buhari, Rikak, 32)

Ata, në saje të dashurisë dhe frikës që kishin në zemrat e tyre ndaj Allahut, edhe gjynahet e vogla i konsideronin humbje të mëdha, madje i konsideronin si shkak shkatërrimi. Ata nuk shikonin vogëlsinë e gabimit por madhështinë e Allahut ndaj të cilit bëhej gabimi.

Domethënë, për t'u bërë një besimtar i devotshëm, nuk mjafton të kryesh vetëm farzet dhe të ruhesh nga haramet, por kërkohet edhe një zemër

74. shih. Muslim, Selam, 151-155.



e mbushur me entuziazmin e besimit. Rahmet pastë, babai im i nderuar Musa Efendiu عليه السلام, në lidhje me këtë çështje është shprehur:

“Shumë njerëz ndihen të qetë duke pandehur se, me faljen e namazeve dhe mbajtjen e agjërimeve, i kanë kryer të gjitha detyrat fetare. Mirëpo këto adhurime nuk mjaftojnë. Bashkë me respektimin dhe madhërimin e urdhrave të Allahut, duhet të tregohet mëshirë edhe ndaj krijesave. Kjo mund të arrihet vetëm me sakrificë dhe shërbim të sinqertë. Çështja që duhet të ketë më tepër kujdes çdo mysliman me mendje të shëndoshë, pasi të ketë plotësuar farzet dhe të jetë ruajtur nga gjynahet, është shërbimi ndaj Islamit, shoqërisë dhe të gjitha krijesave, duke u bërë i dobishëm për ta... sepse këto që u përmendën, janë plotësuesit e farzeve dhe pjesë të sunetit të pejgamberit tonë عليه السلام...”]

I japim fund fjalëve tona me këtë lutje të bukur të Imam Rabbanit:

“Allahu i Madhëruar, për hir të dashurisë ndaj Pejgamberit عليه السلام, i cili u dërgua për të gjitha racat, na shpëtoftë ne dhe ju prej fjalëve që nuk përjetohen dhe dijes me të cilën nuk punohet.”⁷⁵

Amin!..



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani

RAHMETULLAHI ALEJH 2

Duke u nisur nga thënia: “çdonjëri që takon, duhet ta vlerësosh porsì një Hizër dhe çdo natë që kalon, duhet ta vlerësosh si natën e Kadrit.”, virtytin e gjallërimit të netëve të Muajit të Madhërueshëm të Ramazanit duhet ta shpërndajmë ne të gjithë vitin. Inshallah e gjithë jeta na kalon me klimën e Ramazanit, plot me përshpirtshmëri dhe entuziazëm.



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani رحمته عليه -2-

Imam Rabbani ka thënë:

“Virtyt është bindja ndaj Sunetit të Resulullahut, ﷺ; mezijeti lidhet me përjetimin e sheriatit që ka shpallur Ai. Për shembull, të flesh gjumë në drekë me qëllim që të ndjekësh Sunetin, është më e virtytshme sesa shumë ibadete nafile që kryhen në kundërshtim me Sunetin... Një qindarkë zekat që është dhënë duke ndjekur urdhërin e Allahut, është shumë më e virtytshme sesa male me flori që harxhohen në istikamet të dëshirës vetjake (të përzier me qëllime vetjake dhe epshore).”⁷⁶

[Detyra e besimtarit është që të kryejë urdhërat e Allahut vetëm pse ka urdhëruar Allahu dhe ashtu sikurse i ka kryer Resulullahu. Në këtë aspekt, nëse veprohet me mendimin personal dhe jashtë Sunetit –sado me qëllim të mirë qoftë- njeriun shkon drejt gabimeve. Ndaj dhe cilën vepër të mirë, kur, si, në ç’mënyrë duhet ta veprojë, këtë mund ta mësojë përmes Sunetit.

76. shih. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 418, nr: 114.



Në një hadith profetik thuhet:

“Një vepër e vogël në përputhje me Sunetin është më e mirë sesa shumë punë që mund të bëhen, të cilat janë bidat. Kush vepron me Sunetin tim është nga unë, kush ia kthen kurrizin Sunetit tim, nuk është nga unë.” (Abdurrezzak, Musannef, XI, 291)

Sa bukur që e shpreh kjo ngjarje këtë të vërtetë:

Një nga dijetarët e brezit të tabiinëve, Said bin Musejjeb رضي الله عنه, kishte parë një njeri që po falte dy rekat më tepër pas ikindisë. (Nuk i pëlqeu veprimi i personit në fjalë, i kryer në kohë keraheti.) Personi që po falte namaz, u mbrojti:

“- O mjeshtër! Mos vallë Allahu do më dënojë ngaqë fala namaz?”

Kurse i nderuari Said bin Musejjebi i tha:


“- Jo! Zoti i Madhëruar nuk të dënon pse ke falur namaz, por sepse ke vepruar në kundërshtim me Sunetin profetik! (Darimi, Mukaddime, 39/442)

Lidhur me këtë kontekst, i nderuari Fudajl ibn Ijad ka thënë:


“Nëse një vepër kryhet me sinqeritet, por nuk është e saktë, atëherë nuk pranohet. Nëse është e saktë, por nuk bëhet me sinqeritet, sërish nuk pranohet deri kur të kryhet edhe me sinqeritet dhe në mënyrë të saktë. Sinqeriteti qëndron tek të vepruarit për hir të Allahut dhe saktësia qëndron tek kryerja e veprës sipas Sunetit.”



perputhje me pëlqimin e Zotit të Madhëruar, duhet që qëllimi që kemi në zemër të jetë i sinqertë, si dhe vepra të kryhet sipas përcaktimit të bërë në Sunet.

Për shembull, Pejgamberi , pas namazeve farz këshillonte të bëhej tespihë 33 herë **subhanallah**, 33 herë **elhamdulil-lah** dhe 33 herë **Allahu Ekber**. Ne nuk mund t'i bëjmë nga 34 herë, me qëllim që të bëjmë më shumë sevap. Një sjellje e tillë nuk manifeston devotshmëri, perkundrazi tregon një guxim të madh sepse me këtë sjellje tregojmë se mendimi ynë është më i rëndësishëm sesa i Resulullahut. Mirëpo, në ajetin e mëposhtëm kuranor thuhet:

“...Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij!..” (Huxhurat, 1) Pra duke qenë i qartë mendimi dhe qendrimi i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, t'i japësh përparësi qendrimit dhe mendimit tënd është sjellje më e tmerrshme sesa gafleti dhe devijimi.

Ndaj dhe i nderuari Imam Maliku, kur është pyetur: “Nga ku të hyj në ihram (të bëj nijetin)?”⁷⁷, ai qe përgjigjur se vendi më i përshtatshëm ishte vendi ku kishte hyrë edhe vetë Resulallahu, , vendi Dhulhulejfe. Mirëpo pyetësi, i kishte thënë:

“–Por unë dua të hyj në ihram nga Xhamia

77. Rrobat e ihramit mund të vishen edhe para vendit mikat, nga ku fillojnë ndalesat e ihramit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ke hyrë në ihram. Të hysh në ihram është “bërja nijet për ihram” para se të hysh në vendin mikat ose veshja e rrobave dhe “bërja nijet për ihram”. Ndalesat e ihramit fillojnë pas këtij nijeti. Kuptimi i “hyrjes në ihram” është “bërja e nijetit për ihram”, veprim i cili nis ndalesat e ihramit.



e Pejgamberit. Imam Maliku e ndaloi atë. Por, ai këmbëngulte duke thënë:

- Unë dua të hyj në ihram pranë varrit të bekuar, nga xhamia e Pejgamberit.

Atëherë Imam Maliku i kishte dhënë këtë përgjigje të urtë:

“A mund të ketë fitne më të madhe sesa të menduarit që ke arritur në një virtyt më të lartë, të lënë mangut nga Resulallahu, ﷺ? Allahu i Madhëruar ka thënë: **«...Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një denim i dhembshëm.»**⁷⁸”

(Shatibi, *Í'tisam*, I, 97)

Görulduğu uzere salih amellerde bile haddi aşmamak icab eder. Ruhi bir coşkunlukla aşırı tavirlara girmek, “dindarlık ve takva” zannedilmemelidir.



Pra, as në vepra të mira nuk duhet tepruar. Kryerja e veprimeve të tepruara duke u nisur nga euforia, nuk duhet të mendohet si “fetari dhe devotshmëri”. Ndaj dhe Pejgamberi ﷺ ka penguar një sahab që kishte një entuziazëm të tillë në të agjëruarit çdo ditë. Pas këmbënguljes së sahabit, ajo çfarë i rekomandoi Profeti atij, ishte agjërimi i Davudit عليه السلام, pra një ditë agjërim e një ditë pushim. Kësisoj, ky sahab, ngaqë e pati të vështirë kryerjen e kësaj detyre kur u plak, ishte penduar që nuk kishte vlerësuar lejen që i pati dhënë i Dërguari i Allahut.⁷⁹




78. Nur, 63.

79. shih. Buhari, Saum 55, 56, 57, Tehexhud 7, Enbija 37, Nikah



Kështuqë fetaria dhe devotshmëria e vërtetë është kryerja e porosive të të Dërguarit të Zotit, ashtu siç i ka përshkruar ai. Sekret i dobisë së vërtetë, ashtu siç tek ilaçet që është i fshehur tek respektimi i dozës së përcaktuar, po ashtu në këtë rast është tek dorëzimi i plotë tek porositë e të Dërguarit të Zotit.

Ashtu siç është gabim të tepruarit me vepra të mira duke u bazuar tek mendimet dhe opinionet personale, po ashtu edhe e kundërta e kësaj, pra të munguarit në vepra, është po aq gabim. Pra, ndërkohë që Profeti  këshillon që të bëhen 33 herë tespìh, ne nuk mund të themi: “Mua më mjaftojnë 32 herë.” Në këtë kontekst, nuk duhet të harrojmë ndodhitë e Junusit :

Junusi , në vendin ku do të kumtonte për dyzet ditë me rradhë sipas porosisë hyjnore, la kumtimin në fundin e ditës së tridhjetë e shtatë, pasi populli i tij nuk kthehej në iman. Ndërkohë, kishin mbetur edhe tri ditë nga koha që i kishte dhënë Zoti i Madhëruar. Mirëpo Junusi  u largua që aty i pashpresë. Pasi i ndodhën disa ngjarje në anijen që kishte hipur, kuptoi gabimin që kishte bërë, mirëpo e hodhën nga anija në ujë. Ndërkohë që po përpiqej të shpëtonte dhe po kuptonte se sa kishte gabuar, u gëlltit nga një peshk i madh. Junusi  u pendua ndërkohë që ishte në barkun e peshkut, bëri istigfar, dhikër dhe tespìh. Në ajetet kuranore kjo ndodhi tregohet në këtë mënyrë:



“(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: “S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”” (Enbija, 87)

“Po të mos ishte nga ata që i luten Allahut me siguri do të mbetej në barkun e saj deri në Ditën e Ringjalljes.” (Saffat, 143-144)

Kështuqë, është kusht që urdhrave të Allahut t’i bindemi me durim. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar, duke dhënë shembull Junusin عليه السلام, qorton në këtë mënyrë:

“Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi عليه السلام), kur i lut Zotit të vet i dëshpëruar (në barkun e balenës!)” (Kalem, 48-49)

Një adhurim i pranuar është i lidhur me kryerjen siç urdhërohet – as më tepër e as më pak. Qëllimi i veprave të mira nuk është vetë vepra e mirë, por dorëzimi, dashuria dhe përkushtimi, që na çojnë tek pëlqimi i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar urdhëron që t’i bindemi me dorëzim të plotë Zotit të Madhëruar dhe Pejgamberit të Tij. Në ajetin kuranor thuhet kështu:




“O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbliidheni të gjithë!” (Enfal, 24)


Sa bukur e shprehin lartësinë e horizontit të Pejgamberit ﷺ këto fjalë të Aliut عليه السلام:




“Ju nuk mund të ndiqni ndonjë gjë më të virtytshme dhe më të bukur sesa Suneti i Muhamed Mustafasë ﷺ, nuk mund të gjurmoni asgjë më të mirë sesa ajo çfarë ai ka bërë!” (Ahmed, I, 121)

“Ne pamë që Resulullahu, ﷺ, u ngrit në këmbë, edhe ne u ngritëm; pamë që u ul, edhe ne u ulëm.” (Ahmed, I, 83)

Kështu pra, sahebët fisnikë ishin me plot kuptimin e fjalës ashikë të Pejgamberit, që i bindeshin atij në mënyrë të plotë, edhe sikur mos të dinin arsyen e veprimeve të tij. Njëri prej tyre, Abdullah ibni Omer , kishte parë që Pejgamberi , kishte pirë ujë nga një çezmë, edhe ai herë pas here kishte shkuar tek ajo çezmë dhe kishte pirë ujë; sërish ai kishte parë që Pejgamberi , kishte mbështetur shpinën e tij të begatë në një shkëmb dhe kishte fjetur, edhe ai nganjëherë shkonte atje dhe mbështeste shpinën dhe pushonte; kurse për të sqaruar këto sjellje, ësh-të shprehur:

“Nëse kemi parë Muhamedin  duke kryer këto veprime, edhe ne i kryejmë sikurse ai”. (Ibn-i Mace, Ikame, 73; Ahmed, II, 65, 94; IV, 78)

Kështuqë ne, duke marrë shembull sahabet fisnikë, duhet të bëjmë shumë kujdes që të mos na kaplojë sëmundja e nënvlerësimit të sunetit profetik.

Edhe Zoti i Madhëruar, lidhur me Pejgamberin tonë , ka thënë:

“Në të vërtetë, ti (Muhamed) je një nga të dërguarit në rrugë të drejtë.” (Jasin, 4) Istikameti më i



saktë për ne është përpjekja për t'i ngjarë të Dërguarit të Allahut, aq sa të kemi mundësi, dhe ecja në gjurmët e tij plot dritë, sikurse një hije që nuk i ndahet kurrë të zotit të vet. Sa madhështore që është kjo gjendje e Osmanit رضي الله عنه, i cili bindet me plot besnikëri dhe dorëzohet tek i Dërguari i Allahut:

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, para se të bëhej Pakti i Hudejbijes, dërgoi Osmanin si delegat të tij në Mekë. Sado që Osmani رضي الله عنه ua bëri të ditur mushrikëve që qëllimi i tyre ishte vetëm që të bënin umre dhe të ktheheshin, ata nuk i lejuan. Madje nuk u mjaftuan me kaq, por e arrestuan dhe i thanë:

“- Nëse do, mund t'i bësh vetëm ti tavaf Qabes!..”

Të gjithë myslimanët po digjeshin nga malli që kishin për të bërë tavaf, Qabja nuk i hiqej nga sytë e tyre. Madje disa prej tyre, e xhelozonin Osmanin kur mendonin se ai mund t'i bënte tavaf Qabes. Mirëpo, ai sahab i begatë, i cili ishte përkushtuar tërësisht ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, u jep një mësim shembullor mbi besnikërinë, duke u thënë:

- Pa i bërë tavaf Qabes Muhamedi, as unë nuk bëj tavaf! Unë Qabes i bëj vizitë vetëm pas të Dërguarit të Zotit. Në një vend ku nuk pranohet i Dërguari i Zotit, nuk hyj as unë...” (Ahmed, IV, 324)

Megjithëse zemra e Osmanit رضي الله عنه përvëlohej nga malli që kishte për Qaben, për arsye të lidhjes shpirtërore që kishte me Resulullahin, صلى الله عليه وسلم, privoi veten nga vizitimi i saj. Qoftë edhe lidhur me një adhurim, kishte turp të kalonte mbi Resulullahun, صلى الله عليه وسلم. Natyrisht, kësh-



tu mund të vepronte një njeri që kishte aq shumë besnikëri, dorëzim dhe dashuri. Hadithin “Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96) e jetonte me kaq përpikmëri ai njeri i rrallë. Ja pra, dashuria e vërtetë është një linjë energjie mes dy zemrash, është të jetuarit në trupa të ndryshëm por me të njëjtën zemër, dhe ndarja e së njëjtës ndjeshmëri.

Ndërkohë që, kur erdhi lajmi tek besimtarët në Hudejbije që Osmani kishte rënë shehid, këtë besnikëri të tij, i Dërguari i Allahut, ﷺ, ia ktheu me një besnikëri edhe më madhështore, duke marrë fjalën nga sahabet që nëse është e nevojshme edhe mund t'i sulmonin mushrikët. Pastaj, duke vënë njëren dorë mbi tjetrën, tha:

*“Allahu im! Ky pakt është për Osmanin. Padyshim që ai ishte në shërbim Tëndin dhe të të Dërguarit Tënd.”*⁸⁰ Kështu, ai tregoi besimin dhe dashurinë ndaj tij. Ndërkaq, mushrikët dërguan një delegat për të bërë marrëveshje. Pas kësaj, Osmani ﷺ u kthye shëndosh e mirë.

Kjo do të thotë që cilësitë të tërheqin pëlqimin e Allahut dhe dashurinë e Resulullahut, janë besnikëria, dashuria, dorëzimi dhe bindja me zemër. Zbrazëtinë që krijon mungesa e një gjëje të tillë, asgjë s'mund ta mbushë. Ndaj dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm mbi respektimin e urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Në bazë të mundësive dhe gjendjeve, duhet të kujdesemi që një punë që është me më rën-

80. Buhari, Ashabu'n-Nebi, 7.



dësi ta preferojmë ndaj asaj që ka më pak rëndësi, pra të lëvizim me mençuri dhe largpamësi. Në këtë aspekt, sa domethënës që është qortimi që i bën Pejgamberi ynë i dashur një sahabit të rrallë siç ishte Abdullah bin Revaha:

Resulullahu, ﷺ, e kishte dërguar Abdullah bin Ravahan ﷺ në myfzere. Atë ditë ishte e premtë. Shokët dolën rrugës që në mëngjes heret (ashtu sikurse i kishte porositur i Dërguari), kurse ai mbeti mbrapa. Me vete thoshte:

“Le të fal një herë namazin me të Dërguarin e Allahut dhe pastaj do t’i mbërrij shokët e mi.” Pasi fali namazin, i Dërguari i Allahut, ﷺ, e pyeti:

“- Përse nuk u nise që heret me shokët e tu?”

Abdullah bin Revaha ﷺ iu përgjigj kështu:

“- Desha të falja namaz me ty dhe pastaj t’i mbërrij ata.” Kurse Pejgamberi ynë i dashur e qortoi në këtë mënyrë:

“- Edhe sikur të dhurosh gjithçka ç’ka mbi këtë rruzull tokësor, nuk mund të mbërrish virtytin e daljes së tyre heret!” (Tirmidhi, Cuma, 28/527; Ahmed, I, 256; Bejhaki, III, 187)

Le të bëjmë kujdes! Abdullah bin Revaha ﷺ ka qenë pjesëtar i Paktit të Akabesë, është gjendur në Betejën e Mutesë, duke marrë sihariqin nga Resulullahu, ﷺ, që do të binte shehid, ka marrë pjesë në luftë me një dëshirë të madhe, ka dorëzuar të gjithë pasurinë në Bejtul-Mal dhe shpirtin ia ka dorëzuar Zotit të Madhëruar, kështu ai ka fluturuar direkt e në



Xhennetul-Ala. Ja pra ky sahab kaq i rrallë, ndonëse me një qëllim shumë të mirë siç ishte qëndrimi për pak kohë me Pejgamberin ﷺ, kishte mërzitur Pejgamberin tonë të dashur ngaqë kishte vonuar lidhur me bindjen ndaj urdhrit të Pejgamberit dhe ishte përballur me një reagim të tillë.

Kësisoj, urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij – sikur të dihen apo jo urtësitë e tyre – duhen kryer pa u vonuar dhe sikurse janë urdhëruar. Ndërkohë që ekziston një urdhër i hapur i Resulullahut, ﷺ, marrja e vendimeve ndryshe, duke u bazuar në gjykimin personal – edhe sikur të jenë me qëllim të mirë – mundet që të bëhen shkak për një humbje të tillë.

Nuk duhet harruar që entuziazmi i tepruar që bën që të harrohet bindja ndaj urdhrit hyjnor, apo edukata e tepruar që na pengon bindjen ndaj urdhrit hyjnor, në një farë mënyrë kanë natyrën e kryengritjes. Kur njeriu vepron sipas mendjes së vet, mund të gabojë. Ndaj dhe kurrë nuk duhet kaluar para Allahut dhe Resulullahut, pra duke pasur gjykimet e qarta të Kuranit, nuk duhet thënë kurrë “sipas meje”.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

***“Kushtoji vëmendje namazit të tehexhudit!
Ata që duan të përfitojnë nga Makami Mahmud,
që ëshët stadi i shefaatit, të mos e lënë kurrë pa
falur namazin e tehexhudit!”***⁸¹

[Në Kuran urdhërohet kështu:

81. Kishmi, *Berekat-i Ahmediye*, f. 291.



“Kaloje një pjesë të natës, si falje shtesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një (Makami Mahmud) vend të lavdëruar.” (Isra, 79)

Namazi i tehexhhudit është një farz enkas për të Dërguarin e Allahut, ﷺ. Kurse për ne është një sunet me rëndësi. Zoti i Madhëruar, duke ia urdhëruar të dashurit të Tij tehexhhudin, ka dhënë lajmin e gëzuar që në rast se koha e paraagimit (seher) kalohet me namaz, Kuran dhe dhikër, atëherë Ai i dhuron njeriut një stad të lartë si meritore i Makamit Mahmud.

Makami Mahmud është stadi i shefaatit për njerëzit e mahsherit, që të gjithë njerëzit që kanë qenë ndonjëherë në rruzullin tokësor do ta kenë zili.⁸²

Pejgamberi ﷺ i ka kushtuar një rëndësi të veçantë tehexhhudit. Edhe kur ishte në vendin ku banonte (mukim), edhe në rast udhëtimi (seferi), nuk e ka lënë asnjëherë pa e falur, po ashtu ai ka nxitur sahabët e tij të besnikë që ta kryejnë këtë ibadet.

Ndaj dhe në një hadith thuhet:

“Më të nderuarit e umetit tim janë ata që shërbejnë për Kuran (pra, hafizët që shërbejnë për Kuran) dhe ata që ngrihen për adhurimin e natës.”


(Munavi, I, 522)

Në një rast, Resulullahu, ﷺ, kishte këshilluar në këtë mënyrë Abdullah ibn Amr ibn As-in:

“O Abdullah! Mos u bëj si filani! Sepse ai bënte




adhurimin e natës, tashmë nuk ngrihet më. ” (Buhari, Tehexhud, 19)

Amr ibn Abese  kishte pyetur në një rast Resulullahun:


“- O i Dërguar i Allahut! A ka ndonjë kohë që nga aspekti i afrimitetit me Allahun, të jetë koha më e virtytshme?”

I Dërguari i Allahut i qe përgjigjur:

“- *Po! Koha që njeriu mund të jetë më afër Allahut është mesi i pjesës së fundit të natës. Nëse mund të jesh prej atyre që i bëjnë dhikër Allahut në atë kohë, ji! Pasi (në atë kohë) namazi është meshhud (engjëjt janë prezent në atë kohë).*” (Nesai, Mevakitu’s-Salat, 35)

Njëri nga miqtë e Zotit, Bajazid Bistamiu  kishte nisur të lexonte Kuranin Famëlartë që në moshë të vogël. Kur kishte shkuar tek ajeti: **“O ti i mbuluar! Çohu (të falesh) gjithë natën...”**⁸³ i qe drejtuar të atit duke i thënë:

“-Baba i dashur, kujt i drejtohet Allahu këtu:

“-Biri im! Zoti i Madhëruar këtu e ka fjalën për Pejgamberin . Por, pastaj, në suren Taha këtë gjykim e ka lehtësuar., -iu përgjigj i ati.”

Ndërkohë që Bajazidi vazhdoi leximin, mbërriti tek ajeti: **“Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhamed) falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj, si edhe disa prej**

83. Muzzemmil, 1-2.



atyre që janë me ty. Allahu e përcakton gjatësinë e ditës dhe të natës dhe e di se ju nuk mund ta llogarisni atë saktësisht, prandaj kthehet tek ju me mëshirë...⁸⁴ Atëherë ai tha:

“–Babai im! Unë po dëgjoj për një grup njerëzish që ngrihen nga gjumi natën dhe bëjnë ibadet! Babai iu përgjigj:

“–Po, bir, ata janë sahabët besnikë të Profetit, ﷺ.

Pas kësaj, Bajazidi ﷺ tha :

“–Babai im! A çfarë të mire mund të ketë nga braktisja e një pune që ka bërë Resulullahu, ﷺ, dhe sahabet!.

Kështu, Bajazidi që atë ditë nuk la më asnjë natë pa falur namazin e natës.

Një natë, Bajazidi ﷺ u zgjua dhe tha:

“–Baba, ma mëso këtë namaz, që ta fal bashkë me ty!”

Babai i tha:

“–Fli, je akoma i vogël!.

Bayezid ﷺ şu karşılığı verdi:

“–Baba! Në Ditën e Kiametit, atëherë kur të gjithë do të ngrihen nga varret e tyre grupe-grupe që të shohin veprat e tyre,⁸⁵ Zoti do të më pyes:

«- Ç’punë të mirë ke bërë në jetën e asaj bote?»
Unë do t’i përgjigjem:



«- O Zot! Unë i thashë babait: “Ma mëso këtë namaz, që ta fal bashkë me ty!” , kurse ai më tha: “Fli se je akoma i vogël!”

Pas kësaj, i ati i tha:

“-Jo, pasha Allahun, nuk dua që ti të thuash kështu!” Dhe pastaj ia mësoi namazin. Që atëherë i nderuari Bajazid zgjohej natën dhe falte namazin e tehexhjudit.⁸⁶

Sërish Bajazid Bistamiu, ka thënë kështu:

“Pa i bërë netët ditë, nuk m’u shfaq asnjë e fshehtë.”

Atëherë kur besimtari ta vlerësojë këtë pjesë të natës sipas porosisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nata i bëhet edhe më e ndritur sesa dita. Për të përfituar më shumë nga klima plot përsheptshmëri dhe entuziazëm e netëve, duhet të marrim entuziazmin e natës dhe ta depërtojmë gjatë ditës, që të shërbejë për të na larguar sa më shumë nga dynjallëku i jetës. I nderuari Ibrah Ed’hemi, ngaqë nuk ishte zgjuar dot një natë për faljen e namazit, kishte thënë:

“Mos i kalo ditët me kryengritje ndaj Zotit, që natën të të zgjojë vetë Ai.”

Kurse Hasan el-Basriu ka thënë:

“Ngritja për adhurimin e natës është e rëndë për njeriun që është mposhtur nga gjynahet.”

Kësisoj, rëndësia që i kushtohet këtij namazi është aq sa fuqia e dashurisë që gjendet në zemër ndaj

86. Sefiri, *el-Mexhalisu’l-Va’zije*, II, 293.



Zotit. Gjallërimi i netëve me ibadet është shprehja më e bukur e dashurisë dhe respektit të sinqertë që tregon njeriu për Zotin e vet. Ndaj dhe për zgjimin natën për adhurim, thuhet: “Nuk është punë e çdonjërit, por punë burrash.”

Edhe Zoti i Madhëruar, lidhur me njerëzit fatlumë që zgjohen natën nga gjumi i ëmbël dhe bëjnë ibadet, thotë kështu:

“Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime, duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre, meqë më parë kanë qenë punëmbarë. Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu). Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.” (Dharijat, 15-19)

Edhe paraagimet e netëve të Muajit të Madhërueshëm të Ramazanit janë shkak për të fituar për veten tonë “virtytin e gjallërimit të netëve”, në një farë mënyre. Ato janë si ushtrime vjetore që na ka dhuruar Zoti i Madhëruar.

Sërish Muaji i Madhërueshëm i Ramazanit, porsi një gosti enkas për umetin islam, duke pasur parasysh se brenda këtij muaji është edhe Nata e Kadrit, ai është një stinë e pashoqe e përfitimeve shpirtërore...

Edhe ne, duke u nisur nga thënia: “çdonjëri që takon, duhet ta vlerësosh porsi një Hizër dhe çdo natë që kalon, duhet ta vlerësosh si natën e Kadrit.”, virtytin e gjallërimit të netëve të Muajit të Madhërueshëm të Ramazanit duhet ta shpërndajmë ne të gjithë vitin.




Inshallah e gjithë jeta na kalon me klimën e Ramazanit, plot me përshpirshmëri dhe entuziazëm.

Zoti ynë! Bëje të mundur që të dalim nga ky muaj i Ramazanit të pastër, të pastruar nga gjynahet tona. Bëje të mundur që të bëjmë një jetë plot përshpirtshmëri dhe entuziazëm islam si kjo e këtij muaji të begatë, deri në frymën e fundit, dhe bëje të mundur që këtë frymë të fundit të mund ta japim në një mëngjes bajrami që hap dyert drejt lumturisë së amshuar!

Amin!..






URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani

RAHMETULLAHI ALEJH 3

Agjërimi, është përkthyesi më i mirë i përgjërimeve të heshtura të nevojtarëve që ngrihen duke thënë: “Kini dhembshuri për ne!” Nëse nuk e ngremë mëshirën dhe butësinë tonë mbi dashuritë dhe dëshirat e përkohshme, të mjerët ne!.. Vendet që nuk kanë hedhur farën e mëshirës në tokën e tyre, nuk mund të shpëtojnë nga humbja dhe dështimi.



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani رحمته عليه -3-

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Ne duhet që uljet e ngritjet tona t’i bëjmë me qëllim pëlqimin e Zotit të Madhëruar, shkurtimisht që të gjitha sjelljet tona... Edhe brendshmja edhe e jashtmjja duhet të jetë një me Zotin e Madhëruar.

Për shembull, kur duam të thellohemi në gjumë, i cili nuk është gjë tjetër veçse një gjendje gafleti, duhet ta bëjmë me qëllim që të pushojmë në mënyrë që t’i bëjmë më mirë dhe më me vetëdije ibadetet e nesërme. Kur flihet me këtë qëllim, edhe gjumi bëhet ibadet që nga fillimi deri në fund. Ndaj dhe është transmetuar thënia se “gjumi i dijetarëve është ibadet.”⁸⁷”⁸⁸

[Njeriu, i cili është krijuar për t’i bërë ibadet Zotit të vet, duhet të përpiqet të jetojë me vetëdijen dhe perceptimin e kësaj të vërtete deri në frymën e fundit. Një besimtar i vërtetë, në çdo kohë të jetës,

87. shih. Dejlemiu, *el-Firdeus*, nr. 6731.

88. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 224, nr: 17, Yasin Yayinevi, Istanbul 2007-2010.



duhet të jetë gjithnjë në kërkim të pëlqimit të Zotit të Madhëruar. Sërish, një besimtar i vërtetë, nuk duhet t'i shikojë si të mjaftueshme të mirat që bën, përkundrazi, ai duhet të ketë një oreks gjithnjë në rritje për kryerjen e veprave të mira.

Robëria ndaj Zotit nuk përbëhet vetëm nga ibadetet që kryhen brenda një kohe të caktuar, si namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi. Robëria ndaj Zotit, krahas këtyre ibadeteve, është një sistem jete që përfshin çdo çast të besimtarit. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar ka ndaluar të gjitha veprimet që çojnë në mospëlqimin e Zotit dhe ka premtuar shpërblim për të gjitha veprat, jashtë ibadeteve, të cilat përputhen me pëlqimin e Tij.

Kësisoj, besimtari duhet të përpiqet të fitojë pëlqimin e Zotit të Madhëruar nëpërmjet lidhjes me qëllimin sublim të bindjes ndaj Zotit. Ndaj dhe, si pasojë e kësaj të vërtete, Imam Rabbani shprehet kështu:

“Nuk duhet mbajtur në plan të parë kënaqësia e nefsit kur bëhet fjalë për ushqime të shijshme dhe rroba të bukura. Në vend të kësaj, ne nuk duhet të kemi për qëllim të fitojmë fuqi në ibadete përmes ushqimeve tona. Edhe kur vishemi bukur, duhet të bratim me vete qëllimin e bindjes ndaj urdhërit hyjnor që Kurani e shpreh kështu: «...vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni!» (A'raf, 31) Kurrë synimi jonë nuk duhet të jetë shfaqja tek njerëzit...”⁸⁹



[Kështuqë, ndërkohë që besimtari bën qoftë edhe detyrat dhe nevojat ditore të tij me një qëllim të pastër, vetëm për pëlqimin e Zotit të Madhëruar, i shndërron edhe ato veprime në ibadete.

Feja jonë e lartë, Islami, me qëllim që besimtarët të largohen nga natyra e pashore dhe e përgjithshme e jetës dhe që të marrin drejtim nga istikameti, duke u bërë një lidhje me synimin shpirtëror edhe gjërave krejtësisht materiale dhe të dukshme, i ka dhënë njeriut një aftësi kuptueshmërie sublime. Jo vetëm veprimet sublime të mbështetura në ibadete dhe etikë, por edhe veprat që rrjedhin si rezultat i nevojave fizike madje i ka idealizuar.

Për shembull, të hash dhe të pish është një nevojë fizike. Mirëpo Islami, duke idealizuar edhe këtë nevojë fizike, me qëllim që të bëhet fuqi për ibadete, e shndërron në një mjet që të shpërblehet. Parë nga ky këndvështrim, duke bërë Bismil-lah, pra duke filluar ushqyerjen me emrin e Allahut, bën që të mbahet gjithnjë në mendje Ai, të falënderohet dhe të reflektohet mbi dhuntitë dhe begatitë e tij. Pra, më shumë sesa dobia që i sjell trupit ushqimi që merret, duke e zbukuruar këtë proces me përsëritshmëri dhe entuziazëm, bën që të hyjë në një farë mënyre në dispozitën e ibadetit.

Ja pra, feja jonë e bukur, Islami, ashtu sikurse në këtë shembull që dhamë, i ngre të gjitha nevojat jetësore të njeriut në statusin e një qëllimi madhor dhe sublim, duke i dhënë mundësinë njeriut që të fitojë kënaqësinë e Zotit të Madhëruar.



Besimtarëve arifë që kanë zemër aq të zgjuar sa t'i vlerësojnë këto mundësi, u shndërrohen në ibadet edhe ngrënia dhe pirja e tyre, ulja dhe ngritja e tyre, madje edhe gjumi i tyre –përmes begatisë së qëllimit të tyre. Ndërsa personat që kanë mbetur gafilë kundrejt gjithë këtyre mirësive të Zotit, edhe ibadetet e tyre i kanë të përziera me hipokrizinë, ndaj dënohen me hidhërimin e Zotit të Madhëruar.

Kjo do të thotë që, që të mund të jetojmë me entuziazmin e ibadetit çdo çast të jetës, duhet që zemrat tona të kalojnë këtë proces edukimi shpirtëror. Kësisoj, fitojmë një “vetëdije të bukur të qëllimit”.

Ndaj dhe në hadith thuhet:

“Qëllimi i besimtarit është më i dobishëm sesa vepra e tij.” (Sujuti, *Xhamiu's-Sagir*, II, 194)

Zoti i Madhëruar u jep begati shumë të veçanta besimtarëve të vet të cilët bëjnë përpjekje me sinqeritet që jeta e tyre të bëhet një jetë me ibadet të vazhdueshëm. Për shembull, një njeri që në kushte normale është duke ndjekur një ibadet nafile, mund të mos e kryejë ndonjëherë për arsye të ndonjë sëmundjeje, udhëtimi, sflitjeje apo të moshës së avancuar. Në këtë rast, Zoti i Madhëruar e shpërblen atë njeri sikur ta ketë kryer atë ibadet për shkak të çiltërsisë së qëllimit që ka.

Ndaj dhe mufessirët, lidhur me ajetin “**përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera.**” (Tin, 6) ka-



në thënë: “Edhe atëherë kur trupi i njeriut nuk arrin të kryejë funksionet, shpërblimi i tij vazhdon deri në pafundësi, në varësi të përpjekjes që ka treguar atëherë kur ishte mirë me shëndet dhe sipas qëllimit që mbante në zemër.” Kështuqë, duhet të vazhdojmë me vendosmëri veprat e adhurimit dhe të sinqeritetit për sa kohë kemi mundësi.

Adhurimet e Pejgamberit ﷺ, që na është dërguar si shembulli më sublim, ka mbuluar në mënyrë harmonike çdo fushë të jetës. Kur t’i hidhet një sy jetës së tij të begatë, mund të mendohet sikur të gjithë kohën gjatë tërë jetës e ka kaluar duke bërë ibadet.

Muhamedi ﷺ ka vazhduar jetën e tij të adhurimit, pa lënë pas shërbimin në këtë botë, madje e ka kryer në mënyrën më të përsosur. Vërtet ka vijuar me përkushtim adhurimet ditë e natë; ka kumtuar me shumë përkushtim nën presionin e shumë vështirësive, pjesën e nevojshme të shpalljes hyjnore e ka sqaruar përmes shprehjeve dhe sjelljeve, ai është interesuar për familjen e vet, as nuk la lënë të varfër pa iu bërë ndihmë e as të afërm pa vizituar, ka hedhur themelet e një shteti tejet solid, ka dërguar delegatë tek mbretërit dhe i ka ftuar ata në Islam, ka pranuar delegatë të huaj dhe i ka gostitur ata, ka drejtuar ushtritë, ai ka sakrifikuar me tërë qenien e vet për të larguar gjithçka çfarë bëhej pengesë për të kumtuar fenë e Allahut.

Pra asnjëlloj angazhimi i kësaj bote nuk e largoi atë nga adhurimet. Veçanërisht Muhamedi ﷺ, ngaqë edhe angazhimet e kësaj bote i kryente në përputhje



me pëlqimin hyjnor, çdo çast e përjetonte me entuziazmin e adhurimit. Ai, ashtu sikurse kryente pa asnjëfarë mangësie detyrimet e tij ditore aq të rënda sa askush nuk mund t'i merrte përsipër, poashtu përkushtohej në adhurim ndaj Allahut më shumë edhe se ata njerëz që përkustoheshin gjithë ditën me ibadete në faltore.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë kështu:

“Të falësh pesë kohët e namazit me xhemat është më e virtytshme sesa të ndihmosh të tjerët në raste shqetësimesh (të cilat bëjnë që t'i largohesh xhematit dhe që nuk janë obligative). Krahas kësaj, dhikri dhe meditimi islam është mjaft i rëndësishëm dhe i vyer.”⁹⁰


[Islami refuzon individualizmin dhe egoizmin, këshillon socializimin dhe altruizmin. Manifestimi i parë i edukimit social nis me faljen e namazit. Aty lëshojnë filizet, zhvillohen dhe forcohen ndjenjat e bashkësisë dhe unitetit të besimtarëve.

Resulullahu, ﷺ, ka thënë kështu:


“...Dua që ju t'i shmangeni me këmbëngulje shpërbërjes, dua që ju të jeni gjithnjë bashkë. Pasi shejtani është bashkë me ata që janë të vetëm. Edhe sikur të jenë dy vetë, përsëri janë shumë larg nga ata që jetojnë bashkë. Ai që dëshiron të jetë në mes të xhenetit, le të vazhdojë të jetë bashkë me xhematin...” (Tirmidhi, Fiten, 7/2165)




“...Namazi që fal një njeri me një tjetër bashkë, është më i begatë dhe është më i vlerësuar. Një namaz që falet me dy njerëz është më lart sesa një namaz që falet vetëm. Sa më shumë njerëz që të jenë duke falur namazin, aq më shumë e pëlqen Allahu i Madhëruar.” (Ebu Davud, Salat, 47/554; Nesai, Imamet, 45)

Sahabi i verbër Abdullah ibni Ummi Mektum  e pyeti:


“—O Resulullah! Në Medine ka plot zvarranikë helmues dhe kafshë grabitqare. (Kam frikë se mund të na dëmtojnë këto krijesa! A kam leje unë që të mos dal nga shtëpia për ta falur me xhemat namazin dhe ta fal në shtëpi?”

Resulullahu, , u përgjigj kështu::

“—Nëse e dëgjon fjalën “Hajje ales-selah” dhe “Hajje alel-felah!”, atëherë mos rri në shtëpi, hajde në xhami!” (Ebu Davud, Salat, 46/553)

Kësisoj, Pejgamberi , i cili ishte njaft i dashur dhe mëshirues ndaj umetit të tij, këtë udhëzim ia dha një sahabi të verbër. Ndaj dhe duhet menduar se sa gabim i madh dhe sa gaflet është të mos marrësh pjesë në namazet me xhemat, duke pasur parasysh se sa e vështirë është që të kesh një justifikim të pranueshëm...

Shifa binti Abdil-lah  ka thënë kështu:

Omer ibn Hattabi , erdhi në një rën prej ditëve të Ramazanit. Kur pa që po flinin dy pjesëtarë të familjes, tha:



“Ç’kanë këta njerëz që nuk marrin pjesë në namazin me xhemat me mua?”

Unë u përgjigja:

“O Lideri i besimtarëve! Në darkë falën namazin të gjithë bashkë deri në mëngjes. Pastaj, falën namazin e sabahut dhe ranë të flinin.”

Hazreti Omeri رضي الله عنه m’u drejtua kështu:

“Të fal namazin e sabahut me xhemat, për mua është më e dashur sesa të fal namaz deri në mëngjes.”⁹¹

Për besimtarin gjenden plot detyra që mund të kryhen në çdo kohë. Ajo çfarë i ka hije një besimtari të vërtetë është që t’i japë përparësi veprimit që është më i rëndësishmi, kurse të tjerat t’i realizojë sipas mundësisë.

Padyshim që, farzet janë në krye të detyrave që duhen përmbushur ndaj Zotit të Madhëruar. Ndërkohë që është një farz që duhet kryer, angazhimi me një punë tjetër – edhe sikur të jenë vepra të mira e të vyera si shërbimi islam apo sadakaja- janë veprime të gabuara.

Në jetën e adhurimit të besimtarit kryerja e farzeve ka përparësi mbi gjithçka tjetër. Vlera dhe rëndësia e adhurimeve nafile është e lidhur vetëm me kryerjen si shtesë pas farzeve. Sipas një hadithit kuds, Pejgamberi صلى الله عليه وسلم, ka cituar thënien e Allahut të Madhëruar:



“...Robi im nuk mund të afrohet më shumë pranë Meje me ndonjë gjë tjetër më të dashur sesa veprat që i kam bërë farz. Robi im më afrohet gjithnjë e më shumë përmes adhurimeve nafile (të cilat i bën pasi të ketë bërë ato që janë farz). Nëse robi im lumturohet, atëherë Unë i bëhem veshi me të cilin dëgjon, syri me të cilin shikon, dora me të cilën kapë, këmba me të cilën ecën, zemra me të cilën ndien dhe gjuha me të cilën flet. Çfarëdo që të dëshirojë nga Unë, ia jap me doemos. Nëse strehohet tek Unë, e mbroj...” (shih. Buhari, Rikak, 38; Ahmed, VI, 256; Hejthemi, II, 248)

Ja pra, Zoti i Madhëruar kërkon prej nesh që ne të jemi njerëz që fitojnë dashurinë e Tij si rezultat i afrimit më pranë Tij duke kryer adhurimet nafile, pasi të kemi kryer rigorozisht ato farz. Për të arritur zenitin e përkushtimit ndaj Zotit të Madhëruar, Ai bën të ditur se asnjë vepër tjetër nuk është më e dashur për Të. Pra, tregon se farzet janë kushti i domosdoshëm që garanton pranimin e veprave të tjera.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë::

“Dijeni mirë që zemra është fqinje e Zotit të Madhëruar. Asgjë tjetër përveç zembrës nuk është më pranë Qenies së Tij. Ndaj bëni kujdes që të mos lëndoni zemra, qoftë ato të besimtarëve, qoftë të mohuesve! Pasi fqinji mbrohet edhe nëse është mohues. Aman, qëndroni larg kësaj! Pasi, pas blasfemisë, nuk ka gjynah tjetër që bëhet shkak për mërzitjen e Allahut të Madhëruar



sa lëndimi që mund t'i bëhet një zemre. Zemra është më e afërta nga qeniet që mund të flasë me Zotin e Madhëruar.”⁹²

[Zoti i Madhëruar ka treguar në ajetet kuranore se Ai është edhe më afër se damari i qafës,⁹³ po ashtu Ai ka thënë se ndërhyt mes zemrës dhe individit.⁹⁴ Ndaj dhe duhet të bëjmë shumë kujdes ndaj zemrës, e cila është vendshikimi hyjnor.

Prandaj dhe Shah Nakshibendiu ka thënë:

“...Nuk ka asnjë zemër që të mos jetë vendshikim hyjnor. Edhe sikur ta dijë, edhe sikur mos ta dijë i zoti i zemrës!..”⁹⁵ buyurmuştur.

Kësisoj, ka vënë në dukje se rigjallërimi i zemrave është shkak që të merret entuziazëm nga vendshikimi hyjnor, sikurse ka vënë në dukje se është një përgjegjësi e madhe lëndimi i zemrës së tjetrit.

Përpjekja dhe shërbimi më i madh i njerëzve të veçantë të Zotit, është që zemrat e sëmura dhe gafile të mbetura larg nga e vërteta hyjnore, të marrin një shërim të amshueshëm përmes nurit islam dhe besimor, kurse zemrat e mërzitura dhe të thyera të besimtarëve t'i rigjallërojnë përmes dhembshurisë dhe mëshirës.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

92. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 326, nr: 45.

93. Kaf, 16.

94. Enfal, 24.

95. Salahaddin ibn Mubarek el-Buhari, *Enisu't-Talibin*, f. 100.



“Pushteti i muajit të Ramazanit është aq i madh sa që nuk ka fund. Bashkimi dhe uniteti që gjendet në këtë muaj dhe që do të vazhdojë për një muaj, është mjet për bashkim dhe unitet për gjithë vitin. Ashtu siç ndarja në këtë muaj mjafton për ndarjen për tërë vitin.

Lum ai, prej të cilit muaji i Ramazanit ndahet i kënaqur! Mjerë ai, prej të cilit muaji i Ramazanit ndahet i zemëruar. Kësisoj, ai bëhet pengesë për begatinë dhe mbetet i privuar nga mbarësitë.”⁹⁶

[Ramazani i begatë është një periudhë behari në mesin e gjithë kohës, pra është një pranverë shpirtërore e gjithë qënies. Kjo periudhë është bërë e veçantë si rezultat i shpalljes së Kuranit Famëlartë gjatë kësaj kohe, ngaqë në të gjendet Nata e Kadrit e cila është më e vlefshme edhe sesa njëmijë muaj, ngaqë është një kohë e mbushur me begati shpirtërore.

“Bashkimi dhe uniteti” në këtë muaj që i jep prehje shpirtave, pra bashkimi shpirtëror me Zotin e Madhëruar është një pasuri shpirtërore e rrallë që përmblihet në një vit të tërë. Ndaj dhe prova e pranimit të adhurimeve në Ramazan është gjendja dhe istikameti pas Ramazanit.

Ata që e përjetojnë kohën e këtij muaji të begatë me plot shërbim e sakrifica, duke ia kushtuar zem-

96. Imam Rabbani, *Mektubat*, v. I, f. 24, 4. Mektup, Çile Yayınevi, İstanbul, 1977.



rën Allahut dhe trupin duke e dhënë për adhurime: agjërim, teravîh, leximin e Kuranit Famëlartë, dhikër, istigfar, fitre, zekat, dhembshuri dhe mëshirë, arrijnë të përfitojnë begatinë e tij gjatë tërë vitit.

Mirëpo, ata që largohen nga mëshira hyjnore duke mos e vlerësuar siç duhet këtë kohë të begatë, meritojnë gjatë tërë vitit dëshpërimin e ndarjes dhe papërgjegjshmërisë.

Ndaj dhe Pjegamberi ﷺ ka thënë:

“Xhebraili **العليلة** Ai që mbërrin Ramazanin dhe nuk mbërrin t’i falen gjynahet, le të qendrojë larg mëshirës!» Dhe unë i thashë: «Amin!»...” (Hakim, IV, 170/7256; Tirmidhi, Deavat, 100/3545)

Në një tjetër hadith thuhet kështu:

“...Sa keq për atë që kanë mbërritur Ramazanin dhe që nuk i janë falur gjynahet! Nëse njeriu nuk do të falet në Ramazan, kur do të falet vallë?!” (Ibn-i Ebi Shejbe, *el-Musannef*, II, 270; Hejthemî, *Mexhma*, III, 143)

Ndaj dhe gjallërimi i Muajit të Madhërueshëm të Ramazanit, në aspektin e besimtarëve arifë, është një çështje e cila mbart mjaft rëndësi. Mual-la bin Fadl ka thënë:

“Selefi salihin (personalitetet e së kaluarës), i luteshin Zotit të Madhëruar për gjashtë muaj rresht që Ai t’ua mundësonte arritjen e muajit të Ramazanit. Kurse gjashtë muajt pas Ramazanit, luteshin që Zoti t’ua pranonte Ramazanin që kishin kaluar.” (Kivamu’s-



Ndërkohë që Ramazani i Begatë është një edukim shpirtëror që bën që të kuptohen më mirë gjendjet e nevojtarëve, duke ndjerë urinë dhe pamundësnë që na mëson agjërimi i këtij muaji. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar, lidhur me nxitimin që duhet të kemi ndaj ndihmës së nevojtarëve, dinjiteti i të cilëve i pengon për të lypur, thotë kështu: “...**Do t’i njohësh nga pamja e tyre...**” (Bekare, 273) Pra, Ai kërkon që ndjenjat si dhembshuria, mëshira, bujaria dhe sakrificat të zgjerohen ndjeshëm.

Kështu, Ramazani i Begatë është një shkollë mëshire që ushqen ndjenjën e përgjegjësisë që kemi ne ndaj njerëzve të varfër, të pambrojtur dhe të shqetësuar.

Sa domethënës që është ky shembull që po sjellim më poshtë për të bërë një autokritikë mbi përgjegjësinë ndaj të skamurve dhe të varfërve:

Sulltan Mustafai III shkoi për iftar në shtëpinë e Shejhulislamit Mehmed Emin Efendiut. Biseda e tyre rrodhi kështu:

“–Efendi, do të doja të vija hera-herës tek ju, por e keni larg shtëpinë.”

“–Falë jush, mund të marr ndonjë shtëpi afër jush, por andej nuk ka shtëpi me kuzhinë.” përgjigjet Mehmed Emin Efendiu.

Këto fjalë e çuditën sulltanin.

“–Sa çudi! A nuk gatuajnë në ato shtëpi?” Pas kësaj pyetjeje të sulltanit, shejhulislami përgjigjet kështu:



“–Të gjithëve, ushqimi i mëngjesit dhe mbrëmjes, u shkon nga unë fakiri. Ndaj dhe nuk dua të largohem prej këtu.”⁹⁷

Kështu pra, kur Ramazani i Begatë përjetohej me një zemër të tillë të butë dhe me një shpirt të tillë altruist, njeriu do të jetë dëshmitari më i mirë tek Allahu.

Kësisoj, ai që përjeton më së miri Ramazanin, duhet të kryej vepra të mira që Ai pëlqen, dhe pa humbur vlerat shpirtërore që fitojmë nga ky muaj i begatë, duhet të përpiqemi të arrijmë Ramazanin e vitit që vjen, që kështu të mund të përjetojmë një përshtirshmëri të vazhdueshme të Ramazanit, e cila përbën një lumturi shumë të madhe. Edhe një bajram i vërtetë realisht është një manifestim i kësaj lumturie. Që do të thotë;

Bajram i vërtetë është ai i personit që ka mundur të marrë një amnisti hyjnore nga Ramazani.

Bajram është përgëzimi që të bën Zoti i Madhëruar si rezultat i përkushtimit të sinqertë ndaj Tij.

Bajram është mësimi i fundit i Ramazanit të Begatë, i cili është shkolla e mëshirës.

Bajram është vizita që u bëhet miqve e të afërmeve, të sëmureve, të pastrehëve e të shtypurve; të interesuarit për ta, ndihma ndaj tyre, gëzimi që u jepet atyre, kujdesi për nevojat e besimtarëve, si për-



fundim, bajrami është stina e të jetuarit në bashkësi të vëllazërisë fetare.

Bajram është një gosti hyjnore që dhuron freskinë e Xhenetit në zemrat e lënduara.

Bajram janë ditët e adhurimit social, të përjetimit të dhurimit, sakrificës dhe shërbimit që do të bëhen ekstra nga adhurimet individuale. Nuk janë ditët e qejfit epshor dhe argëtimit që një kategori e caktuar njerëzisht përjetojnë në mënyrë të llastuar duke e tepruar.

Bajram janë ditët që heqin nga mesi i besimtarëve mërinë dhe zemërimet me njëri-tjetrin, janë ditët e bashkëjetesës së besimtarëve.]

Zoti i Madhëruar bëftë që të mund t'i ndjejmë më thellë vuajtjet e vëllezërve tanë në fe të cilët janë të shtypur, kudo qofshin në mbarë rruzullin tokësor, të bëjë që zemrat tona të bëhen vatrat e mëshirës që përqafojnë këdo dhe që të mund të mbështjellim plagët e tyre nga aspekti material dhe nga ai shpirtëror! Bëftë që bota e shtypur islame të mund të ketë gëzimin e një bajrami të vërtetë...!

Bëftë që Ramazanin e Begatë të këtij viti të mund ta përcjellim të pastruar tërësisht nga gjynahet dhe na bëftë që të mbërrijmë me të njëjtin entuziazëm Ramazanin e vitit që do të vijë. Bëftë që ta përjetojmë gjithë jetën me këtë përshepirtshmëri të Ramazanit dhe të na ma-



Urtësi nga të dashurit e Allahut

rrë frymën e fundit në një prehje të mëngjesit të bajramit që hap dyert drejt një lumturie të përhershme.

Amin!..



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani 4

RAHMETULLAHI ALEJH

Jeta e kësaj bote në krahasim me pafundësinë e botës tjetër është veçse një pikë ujë nga oqeani. Atëherë, nëse pyetjes: “Çfarë është jeta?”, do t’i përgjigjeshim: “vetëm lagështira e tokës dhe ngurtësia e gurëve të varrit”, atëherë çfarë do të ishte më e hidhur se humbja e një jete të shkurtër në një shkujdesje të tillë?..

1 ndjeri Nexhip Fazëll, e përmbledh me dy rreshta këtë indiferencë të madhe:

Ora ime plot tridhjetë vite ka punuar, e unë paskam ndaluar,
Pa dijeninë e qiellit, balona kam fluturuar...



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani رحمته عليه -4-

I nderuari Imam Rabbani, thotë:

“Qëllimi i krijimit të njeriut është të kryejë adhurimet me të cilat është urdhëruar. Me adhurim nënkuptojmë arritjen e «njohjes së vërtetë», e cila është edhe thelbi i besimit.”⁹⁸

[Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik, njofton:

“Xhindet dhe njerëzit nuk i kam krijuar për tjetër gjë, përveçse të më adhurojnë Mua.” (Dharijat, 56)

Ibn-i Abbasi رضي الله عنه, shprehjen **“لِيَعْبُدُونِ: të më adhurojnë Mua”** e ka komentuar si: **“لِيَعْرِفُونِ: të më njohin Mua”**.

Për shembull, sexhdja, e cila në kushtet e kësaj bote është caku ku robi është më afër Zotit, për një person që e sheh nga jashtë, mund të duket vetëm si një lëvizje formale. Mirëpo, kuptimi që bart ajo, është vendosja e ballit të besimtarit në tokë përpara Allahut, duke e pranuar me bindje dobësinë e vet para Tij. Duke iu nënshtruar Atij dhe duke thënë me gjuhën e

98. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 369, nr: 97.



trupit: “Ti je Zoti im, unë jam robi Yt; Ti je Krijuesi im, unë jam krijesa Jote!”, ai deklaroi se e njeh Zotin me gjithë shpirt.

Sahabët e Pejgamberit ﷺ, zakonisht i ngrinin sytë nga qielli gjatë namazit, derisa u zbrit ajeti:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.” (Mu'minun, 1-2)

Pas zbritjes së këtij ajeti, sahabët fisnikë filluan t'i ulnin kokat e tyre (me përkushtim)⁹⁹, sepse duke u thelluar në të vërtetën e adhurimit të namazit, ata ndjenë dobësinë e tyre përballë fuqisë dhe madhësisë hyjnore dhe arritën të mësojnë të jenë robër të përlulur të Allahut.

Ky është qëllimi i adhurimit dhe devotshmërisë: arritja e njohjes së Allahut në saje të këtyre ndjenjave, njohja e Allahut me zemër. Në këtë mënyrë arrihet edhe besimi i vërtetë, pra besimi i kulluar dhe i pastruar prej dilemave dhe mëdyshjeve. Për rrjedhojë kështu zemrat tona do të vetëdijesohen ndaj faktit se në çdo moment gjendemi nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Në jetën e një besimtari të vetëdijshëm dhe të urtë, nuk ka asnjë qëllim më të madh dhe asnjë gradë më të lartë se sa devotshmëria ndaj Allahut. Pejgamberit ﷺ iu dha e drejta e zgjedhjes së të qenit një “pejgamber



sundimtar” ose thjesht një “pejgamber rob i Allahut”, dhe ai zgjodhi të ishte thjesht një “pejgamber rob i Allahut”. Me anë të kësaj zgjedhjeje ai ka treguar se lumturia dhe sundimi që të jep robëria ndaj Allahut, është aq e lartë, aq e vlefshme dhe aq afatgjatë, saqë nuk mund të krahasohet me rehatinë dhe kënaqësinë që të jep sundimi në këtë botë.

Në fakt, edhe sikur e gjithë bota t’i jepej një njeriu të vetëm dhe ai të jetonte aty njëmijë vjet, nuk do të kishte asnjë dobi për të. Në fund të fundit vendi ku do të shkojë ai, a nuk është një gropë e ngushtë në tokë? Mbi të gjitha, jeta e kësaj bote në krahasim me pafundësinë e botës tjetër është veçse një pikë ujë nga oqeani.

Nëse pyetjes: “Çfarë është jeta?”, do t’i përgjigjeshim: “vetëm lagështira e tokës dhe ngurtësia e gurëve të varrit”, atëherë çfarë do të ishte më e hidhur se humbja e një jete të shkurtër në një shkujdesje të tillë?..

Në një ajet fisnik lajmërohet:

“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.” (Naziat, 46)

Për rrjedhojë, nuk mund të ketë një jetë më të mirë sesa ajo që jetohej në përpjekjen për ta bërë jetën e shkurtër të kësaj bote, kapitalin e lumturisë së botës tjetër. Dhe rruga e vetme për arritjen e kësaj, është devotshmëria ndaj Allahut, me të cilën jemi urdhëruar.



Në lidhje me këtë të vërtetë, njerëzit e urtë kanë këshilluar:

“الدُّنْيَا سَاعَةٌ، فَاجْعَلْهَا طَاعَةً: Kjo botë, është sa një çast. Prandaj përpiqu që edhe këtë çast të shkurtër ta kalosh me adhurime!..”¹⁰⁰

Ndërsa Abdullah Dehlevi ka thënë:

“Jeta e kësaj bote është veç një ditë dhe këtë ditë duhet ta agjërojmë.”¹⁰¹ Me këtë shprehje ai ka dashur të theksojë se në këtë jetë të përkohshme duhet të jetojmë me devotshmëri, duke e ruajtur veten nga haramet dhe gjërat e dyshimta dhe të gjitha përpjekjet tona duhet t’ia kushtojmë devotshmërisë ndaj Allahut.

Nga ana tjetër, çdo adhurim është një ushqim shpirtëror që -nëse bëhet ashtu siç duhet- e afron robin tek Allahu, forcon besimin e tij dhe duke ia pastruar zemrën nga mëdyshjet dhe dilemat, e çon atë drejt paqes së vërtetë.

Besimi i ngjan një burimi drite. Erërat e egos dhe shejtanit fryjnë gjatë gjithë jetës sa herë që të munden, me qëllim që shuajnë këtë dritë. Ndërsa adhurimet janë si një fener që e ruan dritën e besimit nga erërat negative. Për rrjedhojë, nëse adhurimet kryhen me qëllim të pastër dhe në mënyrë të pranueshme, edhe drita e besimit në zemër do të jetë e fortë dhe e shndritshme.

I nderuari Sami Efendi, pjekurinë e zembrës së besimtarëve të cilët arrijnë një besim të palëkundshëm në saje të begatisë së adhurimeve dhe bindjes, e ka shpjeguar me këtë krahasim:

“Besimtari që ndodhet në rrugën e drejtë, duhet të jetë i qëndrueshëm si një mal, sepse mali ka katër cilësi:

- 1) Nuk shkrihet nga nxehtësia,
- 2) Nuk ngrin nga të ftohtët,
- 3) Nuk rrëzohet nga erërat,
- 4) Nuk përmytet nga vërshimet e ujrave.”¹⁰²

Pra, ai e ruan forcën e besimit pavarësisht nga kushtet.]

I nderuari Imam Rabbani thotë:

“Në dashuri nuk ka vend për hile, sepse kush dashuron ia ka dhënë zembrën të dashurit dhe nuk e kundërshton atë. Ai nuk anon kurrë nga kundërshtarët e të dashurit dhe nuk u jep asnjë mundësi atyre.”¹⁰³

[Besimi në Allahun është një dashuri e thellë shpirtërore. Ndërsa dashuria është vepra e zembrës. Çdo organ ka vullnet, por zemra nuk ka. Asgjë nuk mund ta detyrojë atë të dashurojë dikë dhe po ashtu, askush nuk mund ta detyrojë të urrejë diçka.

Për rrjedhojë, besimtari i vërtetë, zembrën që ësh-

102. M. Sami Efendi, *Yunus ve Hud Sureleri Tefsiri*, s. 145.

103. Imam Rabbani, *Mektubat*, I, 514, no: 165.



të edhe vendi i besimit, e ruan nga gjërat që nuk i pëlqejnë Allahut të Madhëruar dhe nuk anon nga ato, sepse të thuash se e do Allahun dhe të anosh nga gjërat që Ai nuk i pëlqen, nuk përputhet me besimin e vërtetë.




Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96)

Nisur nga kjo frazë ne duhet të mendojmë e të pyesim veten: sa është zemra jonë me Allahun? Sa është me Resulullahun, ﷺ? Sa është me ata që i do Allahu dhe i Dërguari i Tij, ﷺ? Përkundër kësaj, sa është zemra jonë së bashku me dëshirat e egos? Sa anon ajo nga armiqtë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ﷺ, nga tundimet e gjynaheve dhe kurthet e shejtanit?

Në një dashuri të vërtetë, i dashuruari dashuron edhe të dashurit e të dashurit të tij dhe i urren ata që nuk i do ai. Kush e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ﷺ, i do edhe virtytet e bukura, si bujarinë, mirësjelljen, turpin, butësinë, mëshirën dhe faljen. Po ashtu, ai i urren edhe cilësitë e këqija, si paturpësinë, të keqen, koprracinë, padrejtësinë dhe tiraninë. Kjo ndodh sepse një dashuri e vërtetë buron nga bashkimi i atij që dashuron me atë që dashurohet. Në një dashuri të vërtetë, veçoritë e atij që dashurohet kalojnë edhe tek ai që dashuron. Madje dashuria shtohet edhe më tepër kur ai që dashurohet, i sheh veçoritë e veta tek ai që dashuron.



tonë ﷺ është shfaqur në nivelin më të lartë tek Ebu Bekri . Kjo ka ardhur si pasojë e dashurisë së pamatë të këtij sahabi ndaj Pejgamberit ﷺ. Kur shohim jetën e Ebu Bekrit , shohim moralin e të Dërguarit të Allahut, .

Pra, nuk mjafton të thuash: “-Unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij.” Nëse vërtetë i duam, atëherë duhet të verifikojmë se deri ku arrin është mëshira dhe butësia jonë; në ç’nivel është morali ynë? Sa prej cilësive të Pejgamberit ﷺ gjenden tek ne? A mund të shpëtojmë prej egoizmit? A kemi shpirt altruist i cili shqetësohet me hallet e umetit? A pasqyrohet dashuria jonë në gjendjen dhe veprat tona? Apo mos dashuria jonë është thjesht një pretendim i thatë që mbetet veç në fjalë?!

Po ashtu, nuk mjafton të thuash: “-Unë e dua Kuranin”. Duhet parë se sa pasqyrohet morali i Kuranit tek ne? Sa veprojmë me ligjet e Kuranit? Sa ua mësojmë fëmijëve tanë Kuranin, kulturën dhe moralin e tij? Sa e mendojmë faktin se në ditën e kijametit Kurani do të jetë ndërmjetësues për ne ose në të kundërtën -për shkak të neglizhimit- do të ankohet ndaj nesh? Ja pra, këto lloj pyetjesh duhet t’ia bëjmë vazhdimisht vetes sonë...

Peshorja e një dashurie të vërtetë, është sakrifica. Fjalët e thata që nuk vërtetohen me sakrificë, nuk shprehin asnjë kuptim. Rumi, njerëzit e shkujdesur që pretendojnë dashuri dhe qëndrojnë shumë larg realitetit të saj, i këshillon me këtë shprehje:



Mos u bëni palaço të fjalëve!”

Njeriu, edhe nëse largohet pak prej vendlindjes së tij, fillon ta ndjejë menjëherë mallin për ajrin, ujin dhe tokën e saj. Madje, edhe nëse vendlindja e tij është shkretëtirë, ai ndjen mall për të, sepse zemra e tij është e lidhur me çdo veçori të vendlindjes së tij. Kjo pra është dashuria e vërtetë.

Përsëri, Rumi, në veprën e tij të famshme “Mesnevi”, na tregon një ndodhi:

Mexhnuni, i cili bridhte nëpër shkretëtira për shkak të dashurisë ndaj Lejlas, po ledhatonte me mëshirë dhe puthte sytë e një qeni të jargavitur dhe me qime të rëna. Ata që e shihnin, e qortonin Mexhnunin për shkak të kësaj dashurie të madhe që tregonte ndaj qenit. Mirëpo, ai thoshte:

“-Nëse do ta shihnit me syrin tim, do ta kuptonit pse unë sillem kështu me të. Ai është qeni i fshatit të Lejlas. Mes gjithë këtyre fshatrave, ai zgjodhi fshatin e Lejlas për të jetuar dhe për të bërë roje. E si të mos e dua atë!..”

Shkurtimisht, çdo cilësi që e pëlqen Allahu dhe i Dërguari i Tij, duhet të pasqyrohet edhe në moralin dhe sjelljet tona. Për këtë arsye edhe të dashurit e Allahut kanë ndjerë një ëmbëlsi shpirtërore të papërshtueshme në zbatimin e Kuranit dhe Sunetit në çdo çështje të jetës, deri edhe tek ngrënia, pirja, qëndrimi etj.



kërkon që të duhen ata që do i dashuri dhe të mos duhen ata që nuk i do i dashuri, atëherë nëse e duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ﷺ, dashurinë dhe urrejtjen për hir të Allahut duhet ta kthejmë në cilësinë kryesore të karakterit dhe personalitetit tonë. Pra, duhet t'i duam ata që e meritojnë dhe t'i urrejmë armiqtë e Allahut, të Pejgamberit, të Islamit dhe myslimanëve.

Një nga shembujt më të gjallë të këtij fakti është edhe mallkimi nga ana e Allahut të Madhëruar në suren Tebbet, i Ebu Xhehlit, për shkak të ashpërsisë dhe këmbënguljes së tij në mohim, megjithëse ai ishte xhaxhai i Pejgamberi ﷺ.

Për rrjedhojë, ne duhet ta ruajmë veten nga lavdërimi i armiqtë të Allahut dhe të Pejgamberit ﷺ, madje edhe nga shikimi më i vogël në formë admirimi, sepse këto shikime mund të bëhen shkak i dënimit të Allahut.

Në lidhje me qëndrimin që duhet treguar në shfaqjen e urrejtjes për hir të Allahut, po japim si shembull këtë hadith fisnik:

“Dyfytyrëshit mos i thoni «zotëri». Nëse e pranoni atë për zotëri, do të bëheni shkak i dënimit të Zotit tuaj, i Cili është Aziz dhe Xhelil.” (Ebu Davud, Edeb, 83; Ahmed ibn Hanbel, V, 346)]

I nderuari Imam Rabbani thotë:

“Vëllai im! Nëse nuk tregohet dobësi në dy çështje, atëherë s'ka asnjë problem që të mund të na mësyjë. Çështja e parë konsiston



në ndjekjen e hapave të Pejgamberit ﷺ, i cili erdhi me shariat (ligjin e Allahut) dhe e dyta, në singëritetin dhe dashurinë ndaj atij që të mëson rrugën e drejtë (udhëzimin).

Sa të jenë këto të dyja në zbatim, nuk ka asnjë problem që mund të na afrohet, edhe sikur të bien mijëra errësira. Mirëpo, -Allahu na ruajttë- nëse shfaqet ndonjë mangësi në këto të dyja, njeriu do humbasë e do shkatërrohet edhe nëse bën vazhdimisht dhikr, sepse dhikri i tij është thjesht një “istidraxh”¹⁰⁴ dhe fundi i tij është shumë i hidhur.

Prandaj, duhet t’i lutemi e përgjërohemi me gjithë shpirt Allahut të Madhëruar dhe të kërkojmë prej Tij të na bëjë të qëndrueshëm në këto dy çështje, sepse këto janë çështjet më të rëndësishme dhe kapitali kryesor për arritjen e shpëtimit.¹⁰⁵

[Besimtari, duhet të përpiqet të ecë në gjurmët e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe trashëgimtarëve të tij, që janë dijetarët dhe njerëzit e urtë. Nëse vepron

104 Istidraxh: Është gjendja e njerëzve të devijuar, të cilëve Allahu i Madhëruar, u fal mirësi të shumta, me qëllim që ata të kujtojnë se janë në rrugë të mirë dhe t’i shtojnë edhe më tepër gjynahet e veta. Përveç kësaj, istidraxhi mund të shfaqet edhe në formë të ngjashme me mrekullitë, që i bëjnë mohuesit, gjynahçarët e mëdhenj dhe disa persona që pretendojnë se gjoja janë evlija. Kjo gjë, e rrit së tepërmi egon dhe jo vetëm që nuk të afron tek Allahu, por të largon edhe më tepër nga Ai.

105. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 551, no: 30.



kështu, ai do të kalojë i sigurt edhe në rrugët më të errëta, duke arritur derën e lumturisë së përjetshme. Në të kundërt, një njeri pa udhëzues është si një anije me timon të thyer, e cila shkon në çdo anë që e çon era, por kurrë nuk e gjen dot rrugën që të çon në vendin e dëshiruar. Mbi të gjitha, ai nuk mund t'i shpëtojë as shkatërrimit në ndonjë vorbull të panjohur.

Nisur nga kjo, besimtari asnjëherë nuk duhet ta konsiderojë veten në rregull me gjithçka. Ai gjithmonë duhet ta shohë gjendjen e tij në pasqyrën e rrugës së drejtë dhe të përpiqet të korrigojë gabimet e tij. Ndërsa pasqyra e rrugës së drejtë, ku duhet të shihet e të korrigojë vetveten, është Pejgamberi ynë (a.s.), i cili ishte një Kuran i gjallë, dhe dijetarët që i udhëzojnë njerëzit në rrugën e drejtë dhe të cilët nuk ndahen asnjë çast nga rruga e ndritur e Pejgamberit (a.s.).

Ashtu siç i sëmuri nuk mund ta kurojë dot veten duke lexuar librat e mjekësisë, ashtu edhe njeriu nuk mund ta nënshtrojë egon e tij dhe nuk mund të shpëtojë prej sëmundjeve të egos, si mendjemadhësia, krekosja dhe pëlqimi i vetes, vetëm duke lexuar rreshtat e librave. Madje, kur sëmuren edhe vetë doktorët shkojnë tek një doktor tjetër për t'u kuruar. Po ashtu, asnjë gjykatës nuk mund të gjykojë një çështje që ka lidhje me vetë atë, por duhet të dalë përpara një gjykatësi tjetër.

Nisur nga kjo, për të arritur pjekurinë shpirtërore është e domosdoshme të marrësh dituri dhe udhëzime nga njerëz të ditur e të devotshëm. Rëndësinë e kësaj çështjeje, Rumi u shpreh me këto fjalë:



“Si mund ta gdhendë një thikë bishtin e saj, pa ndihmën e një thike tjetër? Shko dhe tregoja plagët e tua një kirurgu të shpirtit, sepse ti nuk mund ta kurosh vetveten...”

“Kujdesin për shëndetin e trupit, mësoje nga doktori. Ndërsa kujdesin për shëndetin e ndjenjave të larta që e ngrenë njeriun në pafundësi, mësoje nga një dijetar i devotshëm.”

Duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit ﷺ: *“Besimtari, është pasqyra e besimtarit.”*¹⁰⁶, mund të themi se dijetarët e devotshëm janë një pasqyrë shumë e pastër për ne dhe shpirti ynë e sheh thelbin e vetes dhe ekzistencës në këtë pasqyrë të shndritshme. Ata që janë të privuar nga një pasqyrë e tillë, jo vetëm që nuk i kuptojnë gabimet e veta, por nuk arrijnë as të zgjohen nga injoranca që i bën ta pandehin mjerimin lumturi.

Nga ana tjetër, në ditët tona, disa të paditur që kanë rënë në greminën e injorancës, duke i përçmuar fjalët dhe sunetin e Pejgamberit tonë (a.s.), po tregojnë dobësi të theksuara në lidhje me sproven e besnikërisë, respektit dhe dorëzimit ndaj tij. Gjithashtu, këta njerëz të ulët, flasin keq edhe për të dashurit e Allahut, të cilët ecin në gjurmët e Pejgamberit (a.s.). Nuk ka dyshim se kjo gjendje është një verbëri e thellë shpirtërore. Sjellja e keqe ndaj të dashurve të Allahut është një nga arsyet që shkaktojnë më së shumti zemërimin hyjnor.



Allahu i Madhëruar u shpall luftë personave që kryejnë këto dy gjynahe:

E para është kamata, në lidhje me të cilën në Kuran thuhet:

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë, atëherë ju është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij...” (Bekare, 278-279)

Ndërsa e dyta është lëndimi i robërve të dashur të Allahut, në çfarëdo lloj forme. Në lidhje me këtë, në një hadith fisnik, thuhet:

“Kush armiqësohet me një prej robërve të Mi të dashur, unë do t’i shpall luftë atij...” (Buhari, Rikak, 38)

Nuk duhet harruar, se gjatë gjithë historisë, nuk ekziston asnjë qenie që të ketë luftuar me Allahun dhe të ketë fituar. Prandaj nuk duhet harruar asnjëherë që shfaqja e sjelljeve të këqija ndaj robërve të dashur të Allahut, do të shkaktojë zemërimin hyjnor.]

Imam Rabbani, thotë:

“Pëlqimi i vetvetes dhe i punëve që bën, i djeg punët e mira, siç djeg zjarri drutë. Pëlqimi i vetvetes, lind kur njeriu e mbiulerëson punën e tij. Për të shpëtuar prej kësaj, është e nevojshme që gjithmonë të kemi parasysh gabimet e të metat tona, ndërsa punët e mira t’i shohim të mangëta e të pamjaftueshme. Madje, nje-



riu duhet të turpërohet nëse punët e mira dhe bamirësitë që ai realizon, bëhen publike...¹⁰⁷

[Qëllimi i punëve të mira, duhet të jetë vetëm kënaqësia e Allahut. Njeriu duhet të falënderojë Zotin, i Cili i ka dhënë mundësi të bëjë vepra të mira. Nëse ai fillon e lavdërohet për punët e mira që bën, egoja e tij ndjen krenari dhe e ndërron qëllimin e punës, gjë e cila e shkatërron edhe shpërblimin e saj. Kjo, sepse besimi në një Zot të vetëm, nuk pranon ortakëri.

Në këtë aspekt, një besimtar duhet të ruhet nga vendosja e emrit të vet në ndonjë bamirësi që bën, si xhami, kurs Kurani etj. Mirëpo, nëse të afërmit e tij e vendosin pasi ai të këtë ndërruar jetë, kjo nuk përbën ndonjë problem. Përkundrazi, bëhet shkak që ai të kujtohet me mëshirë në lutjet e njerëzve. Pra, vendosja e emrit kur ai është ende gjallë nuk është e drejtë, sepse kjo do ta cenonte shumë sinqeritetin e tij.

Në fakt, kur njeriu bën një punë të mirë, -sado që të përpiqet- ai e ka shumë të vështirë ta kryejë atë të pastruar plotësisht nga të metat e dukshme dhe të padukshme. Prandaj, sado punë të mëdha të bëjë robi, ai nuk duhet ta mbivlerësojë punën e tij, por duke pranuar dobësinë e vet, duhet t'i lutet Allahut të Madhëruar që t'ia pranojë veprën. Nuk duhet harruar asnjëherë se ashtu si lutjet/duatë, edhe punët e mira kanë nevojë për pranimin e Allahut.

Në sytë e besimtarëve të urtë, pjekuria shpirtërore e cila tregohet në ofrimin e punëve të mira tek Allahu,



është po aq e rëndësishme sa edhe vetë puna e mirë. Që një punë të jetë vetëm për hir të Allahut, në qëllimin e saj nuk duhet të përzihet dëshira për të marrë komplimente nga të tjerët. Për këtë arsye, punët e mira duhet të bëhen larg syve të njerëzve, me sa të jetë e mundur.

Siç njoftohemi edhe në një hadith fisnik, në ditën e kijametit, ku nuk do të ketë hije tjetër (përveç hijes së arshit të Allahut), Allahu i Madhëruar do të strehojë nën hijen e arshit madhështor shtatë kategori njerëzish, njëra prej të cilave është kategoria e njerëzve që japin sadaka në mënyrë aq të fshehtë sa që dora e majtë nuk e di se çfarë jep e djathta.

Mirëpo, nëse jemi të detyruar ose kemi si qëllim nxitjen/frymëzimin e të tjerëve për të dhënë sadaka, lejohet që të jepet edhe haptas. Megjithatë, edhe në këtë rast, zemra duhet ruajtur nga mburrja dhe mendjemadhësia, me qëllim që të mos na dëmtohet sinqeriteti i veprës sonë.

Pra ne duhet të ruhem jo vetëm nga lavdërimet e të tjerëve, por edhe nga lavdërimet e vetvetes. Dhe ilaçi që mund ta bëjë egon tonë të heshtë në këto raste, është të mos harrohen kurrë të metat dhe gabimet e saj të fshehta. Përndryshe egoja fillon të pëlqejë vetveten dhe në këtë mënyrë nuk mund t'i shpëtojme dot shpërblimet nga shkatërrimi.]

Allahu i Madhëruar i bëftë qëllimet dhe veprat tona të përshtatshme me kënaqësinë e Tij! Allahu na ndihmoftë që të bëjmë sa më shumë punë të



mira me të cilat Ai është i kënaqur, na faltë mirësi dhe moral të bukur! Allahu na udhëzofte në rrugën e drejtë dhe na ruajttë të gjithëve prej fitneve në çështjet e fesë sonë, gjë e cila shkatërron edhe jetën tonë të përtejme.

Amin!..



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani 5

RAHMETULLAHI ALEJH

Qëllimi i tasavufit nuk është arritja e keshfit apo kerameteve dhe vështrimi i botëve të panjohura për njeriun, sepse këto janë hije në udhëtimin shpirtëror, të cilat mund të zhduken befasisht. Qëllimi i një jete mistike islame është të pasurit e një zemre të prehur në paqe, e një edukatë shembullore, plot ibadete që kryhen në harmoni të zemrës dhe trupit, e një imani që jetohet me dashuri. Kështu, personi në këtë rrugë është gjithnjë në përpjekje për të qenë një njeri siç do Zoti i Madhëruar. Të gjithë synimet e tjera që mbeten jashtë këtyre që përmendëm, janë dëshira të kota që bëjnë që të largohet njeriu nga qëllimi sublim.



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani رحمته عليه -5-

Imam Rabbani ka thënë:

“Synimi për të ecur në rrugën e mistikëve, nuk është dëshmimi i pamjeve dhe formave që i përkasin botës së gajbit (duke u kapluar nga dashuria e keshfit dhe kerametit) dhe të parit e ngjyrave e dritave të ndryshme... Çfarë mangësie kanë dritat dhe pamjet e botës së dukshme që njeriu t’i lërë këto dhe të dëshirojë të shohë pamjet dhe dritat që i përkasin botës së gajbit, duke bërë rijazet (pehriz) dhe përpjekje fetare të mëdha! Pamjet dhe dritat në të dy botët janë krijim i Allahut të Lartësuar dhe argumente të ekzistencës së Allahut Teala.”¹⁰⁸

[Tasavvufi (mistikën islame), i cili është udhëtim drejt edukimit shpirtëror, ka si qëllim themelor arritjen e një pjekurie të pranueshme në adhurim ndaj Zotit (xh.xh.), arritjen e përsosmërisë së besimit dhe fitimin e pëlqimit të Allahut Teala si rezultat i këtyre arritjeve. Nisur nga kjo, kuptohet qartazi se qëllimi i tasavvufit nuk është arritja e efshit apo kerameteve dhe vështrimi

108. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 174, no: 266.



i botëve të panjohura për njeriun, sepse këto janë hije në udhëtimin shpirtëror, të cilat mund të zhduken befasisht.

Në lidhje me këtë çështje, si një shembull për të marrë mësim, në Kuranin Fisnik flitet për Bel'am bin Bauran. Ky person nuk shpëtoi dot nga ndëshkimi hyjnor ngaqë u dha shumë pas kësaj bote dhe u mposht nga dëshirat vetjake, edhe pse i ishin dhënë keshfe dhe keramete.¹⁰⁹

Gjendjet e veçanta si keshfi dhe kerameti, janë disa faza që disa robërve u jepen si mirësi hyjnore dhe disa robërve të tjerë si prova hyjnore. Por sidoqoftë janë faza që duhet të kalohen. Apasionimi dhe dhënia ndaj këtyre fazave, e largon udhëtarin e Zotit nga qëllimi i vërtetë i tij.

Për këtë arsye, miqtë e Allahut nuk u kanë dhënë rëndësi kerameteve (mrekullive) fizike, por të gjitha përpjekjet e tyre i kanë dhënë për të ruajtur “istikametin / drejtimin”, i cili është kulmimi i të gjitha përpjekjeve.

Transmetohet se Bajezidi Bistami ka thënë:




“Një ditë doja të kaloja në anën tjetër të lumit Tigër. Të dy anët e lumit u bashkuan si mrekulli për të më dhënë rrugë mua. Menjëherë e mblodha veten dhe i thashë lumit Tigër:

«—Betohem se unë nuk mashtrohem me këtë ndodhi, sepse varkëtarët i kalojnë njerëzit matanë me një gjysmë akçeje. (Ndërsa ti po më kërkon veprat



e mira që i kam përgatitur për mahsherin që prej tridhjetë vjetësh.) Atëherë, nuk mund ta humbas jetën time tridhjetë vjeçare (për hir të një mrekullie e cila do bëhet shkak për të ndjerë vlerë dhe egoizëm te vetja ime) për një gjysmë akçeje. Mua më duhet Allahu, jo mrekullia!»¹¹⁰

Domethënë, e rëndësishme për robin është që të ecë me sinqeritet dhe modesti në rrugën përmes së cilës arrihet pëlqimi i Allahut të Lartësuar. Prandaj robi nuk duhet ta humbasë kohën nëpër hijet mashtruese të udhëtimit.

Veçanërisht, posedimi i keshfit dhe kerameteve në udhëtimin e devotshmërisë që synon arritjen nga besimi te ihsani (mirësia), nuk është rregulli i vetëm i përparimit shpirtëror. Nisur nga kjo, as për Ebu Bekrin , nuk ka shumë histori që flasin rreth kerameteve të tij fizike dhe të dukshme. Kerameti i tij më i madh ishte besnikëria e pashoqe dhe nënshtrimi e bindja e veçantë që kishte ndaj të Dërguarit të Allahut, . Si rezultat i kësaj, të gjitha cilësitë që i përkisnin personalitetit shembullor të të Dërguarit të Allahut, , kaluan te Ebu Bekri në shkallën më të lartë.

Nisur nga ky këndvështrim, në udhëtimin e edukimit shpirtëror thuhet se është më e dobishme përsosja para se të arrihet keshfi dhe kerametet, sepse personat të cilët mund të përjetojnë këto gjendje, mund të kaplohen nga mburrja ngaqë janë njerëz. Si

110. shih. Attar, *Tezkiretu'l-Evlja*, f. 217, Ilim ve Kultur Yayınları, Bursa 1984.



rezultat, mund të zvarriten në gabim duke i pakësuar përpjekjet shpirtërore.

Ndërsa në ajetin fisnik urdhërohet që të përpiqemi deri në frymën e fundit për ta adhuruar Allahun Teala duke thënë: **“Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (Hixhr, 99)

Ata që me durim vazhdojnë të ecin në rrugën e drejtë, pa përjetuar manifestime si keshfi dhe kerameti, ruhen më shumë nga mendjemadhësia, arroganca dhe dëfrimet e kësaj bote. Ata gjithnjë e shohin veten të mangët, përpiqen të ruajnë mospërfilljen ndaj dynjallëkut dhe synojnë të mbajnë një trend kostant në ritjen e përpjekjeve dhe vullnetit shpirtëror.

Ndaj dhe Tahal-Hariri رحمته në këtë kontekst, ka thënë:

“Gjendja e salikut me keshf dhe atij pa keshf, i ngjan udhëtimit drejt Hixhazit të dy udhëtarëve, njërit që i shohin sytë dhe tjetrit që nuk i shohin. Që të dy i qasen qëllimeve të tyre gjatë rrugës. Mirëpo për atë që nuk i shohin sytë, ka më shumë shpërblime. Një salik që nuk ka keshf gjatë sejrri sulukut, sado që nuk vihet re, ngaqë është në një zhvillim të vazhdueshëm, ka më shumë përfitim sesa ai që ka keshf.”¹¹¹

Edhe Ebul-Hasan Harakani ka këshilluar “shërbimin” për zhvillimin shpirtëror dhe ka sqaruar:

“Kerameti më i madh është t’i shërbesh krijesa-



ve të Allahut, pa u mërzitur dhe pa u lodhur fare.”^{112]}

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Pasi të marrësh dy flatra, një nga itikadi dhe një nga vepra e mirë, atëherë duhet të hysh në rrugën e njerëzve të devotshmërisë, fatlumë të Zotit të Madhëruar. Qëllimi i hyrjes në këtë rrugë, nuk është arritja e ndonjë gjëje të re në çështjet e itikadit dhe veprave të mira. Pasi të tilla pritshmëri të shpiejnë larg qëllimit kryesor, duke sjellë rrezikun e rrëshqitjes.

Qëllimi i hyrjes në tasavvuf është të fituarit e dijës së pakontestueshme dhe itmi’nanin, që të mos ketë tronditje e as dyshim mbi itikadin...”¹¹³

[Qëllimi i një jete mistike islame është të pasurit e një zemre të prehur në paqe, e një edukatë shembullore, plot ibadete që kryhen në harmoni të zemrës dhe trupit, e një imani që jetohet me dashuri. Kështu, personi në këtë rrugë është gjithnjë në përpjekje për të qenë një njeri siç Zoti i Madhëruar do. Të gjithë synimet e tjera që mbeten jashtë këtyre që përmendëm, janë dëshira të kota që bëjnë që të largohet njeriu nga qëllimi sublim.

Kësisoj, është fakt historik që besimtarët që edukohen siç duhet me edukatën mistike islame, janë më të lidhur me besimin dhe me veprat e mira dhe e mbrojnë besimin e tyre nga dhuna dhe trysnia.

112. *Name-i Danishveran-ı Nasiri*, I, 297.

113. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 174, nr: 266.



Është parë që kanë qenë pikërisht basimtarët e frymëzuar nga klima e mistikës islame, ata që kanë arritur të ndikojnë në mbrojtjen e identitetit të umetit muhamedan, kryesisht tek popujt e Ballkanit, Kaukazit, Azisë së Mesme dhe Afrikës, të cilët janë përballur me asimilimin e regjimit ateist dhe komunist, me erizionin e kulturës globale, si dhe me veprimtaritë intensive misionare. Pasi qëllimi i tasavvufit është të forcojë imanin në zemrat e besimtarëve, të cilët ndonëse mund të përplasen edhe me furtunat më të fuqishme të mundshme të pabesimit dhe femohimit.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Këshilla që miqve të mi u kam dhënë dhe që do t’u jap derisa të vdes është: pasi të drejtojnë imanin e tyre në varësi të dijeve të librave të Ehli Sunne vel-Xhema’a dhe të bëjnë me kujdes e përkushtim me të gjithë farzet, vaxhipet, sunetet, mendubet, hallallet dhe të jenë ruajtur nga haramet, mekruhet dhe gjërat e dyshimta, atëherë të shpëtojnë zemrën e tyre që të mos angazhohen me gjëra të tjera përveç Zotit të Madhëruar...”¹¹⁴

[Çështja të cilës i kanë kushtuar më shumë vëmendje njerëzit e veçantë të Zotit, është qëndrimi solid në drejtimin e duhur. Aq sa istikameti është konsideruar si kerameti më i madh. Themeli i istikameti është para së gjithash besimi sipas etalonit të Kuranit dhe të Sunetit, pra rregullimi i besimit, kurse pastaj vjen



në rradhë ruajtja nga gjërat haram dhe të dyshimta dhe të jetuarit me edukatë të bukur dhe vazhdimësia e veprave të mira.

Të pasurit e “kalbi selim”, siç do Zoti i Madhëruar prej nesh, pra të krijuarit të mundësisë së daljes para Zotit me një zemër të pastruar dhe të dëlirë, është e lidhur vetëm me kryerjen siç duhet të detyrave tona nga aspekti dhahiri dhe batini. Ndaj dhe ne duhet të përpiqemi me aq sa mundemi që zemra jonë të mos anojë ndaj askujt dhe asgjëje tjetër përveç Zotit të Madhëruar, që zemra jonë të prehet e qetë dhe në lumturi përmes dhikrit të Zotit...

Duhet të mbajmë parasysh se Zoti i Madhëruar ka thënë:

“Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.” (Kaf, 16)

Vërtet, ato çfarë kalojnë brenda njeriut, janë sekret për të gjithë qeniet jashtë tij dhe të njohura vetëm për Zotin e Madhëruar. Kësisoj, jeta duhet jetuar nën dritën e kësaj të vërtete. Aq sa gjendja dhe sjelljet tona, sikurse ndjeshmëritë dhe mendimet tona, duhet t’i bëjmë telif me pëlqimin e Zotit të Madhëruar dhe të shpëtojmë zemrën që të mos angazhohet me gjëra të tjera përveç Zotit të Madhëruar.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Kur bëj ndonjë vepër të mirë, medoemos gjej diçka të mangët tek vetja ime dhe e turpëroj veten. Madje, nuk mund të rri i qetë pa e detyruar



veten që të ndjehet si një njeri që nuk ka bërë vepër të mire të cilën mund t'ia ketë shënuar engjëlli në krahun e djathtë, duke akuzuar keshtu veten. Besoj sikur fletorja e krahut të djathtë është krejtësisht e zbrazët dhe që engjëlli në krahun e djathtë rri kot, pa shënuar asgjë. E si mund të fitoj pëlqimin e Zotit të Madhëruar në këtë mënyrë?!

Di edhe diçka tjetër, që çdokush në këtë botë është më lart se unë në shumë fusha. Njeriu më i dëmshëm jam unë!¹¹⁵

[Me ngritjen e nivelit shpirtëror të njeriut, shtohen edhe ndjenjat e madhështimit dhe respektimit ndaj Zotit të Madhëruar. Ndaj dhe në mesin e njerëzve, pejgamberët dhe evlijatë, të cilët gjenden në majat e njohjes së Allahut, janë përkushtuar ndaj Allahut me ndjenjën e shpërfilljes së gjithçkaje dhe të turpërimit nga më gjynahqarët e njerëzve, kanë vlerësuar gjithnjë veten si të mangët dhe të paaftë, dhe janë penduar duke u përlotur.

Ibrahimi عليه السلام ka kaluar sprovat e sakrificës së pasurisë, jetës dhe fëmijës së tij. Shkatërroi postet në zemrën vdekatare. Ai zhvilloi një betejë të madhe të teuhidit ndaj popullit politeist. Duke treguar dashuri, besnikëri dhe dorëzim, u bë Halilull-llah, arriti të miqësohet me Zotin e Madhëruar. Mirëpo Ibrahimi عليه السلام, megjithë pozitën e lartë që kishte tek Zoti, duke treguar të qenit asgjë dhe duke u ndjerë i paaftë dhe



i turpëruar përballë madhësisë hyjnore, u përgjërua në këtë mënyrë:

“Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit.” (Shuara, 87)


Padyshim që kjo gjendje turpi dhe frike që i mbështillte peygamberët, evlijatë dhe besimtarët e sinqertë, është një dëshmi e nivelit të lartë që kishin në rrugën e njohjes së Allahut dhe në marifetullah.

Ndaj dhe në ajetin kuranor thuhet:

“Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.” (Fatir, 28) Me termin “dije” që kalon këtu, kuptohet njohja e Allahut, perceptimi i pamundësisë vetjake përballë lartësisë së fuqisë dhe madhësisë së Tij, pra marifetullahu.

Zoti i Madhëruar, për gjendjen e njerëzve të sinqertë që bëjnë ibadet brenda një ndjenje madhështore të tillë, shprehet kështu në Kuranin Famëlartë:

“...kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët.” (Mu'minun, 60-61)

Nëna e besimtarëve, Aishja  ka thënë:

“Kur u shpall ajeti në fjalë, iu drejtova të Dërguarit të Allahut duke i thënë:

«—Ata që përmenden në ajet a janë njerëz që bëjnë zina, vjedhin dhe që pinë alkool?»



I Dërguari i Zotit ﷺ iu përgjigj:

“O vajza e Siddikut! Ajeti e ka fjalën për ata njerëz që ndërkohë që falin namaz, agjërojnë dhe japin zekat, kanë frikë nëse këto ibadete do t’u pranohen apo jo nga Zoti.” (Tirmidhi, Tefsir, 23/3175; Ibn Maxhe, Zuhd, 20)

Ndaj dhe njerëzit e veçantë të Allahut, arifët dhe njerëzit e devotshëm, për shkak të këtij preokupimi që kaplonte zemrën e tyre, i janë përgjëruar Zotit të Madhëruar në këtë mënyrë:

“Allahu im! Ti je larg çdo të mete. Nuk arritëm të të njohim siç duhet, Zoti ynë! Nuk arritëm të të adhuronim siç e meriton, Zoti ynë!...”

Pra, ndërkohë që njerëzit gafil nuk ndiejnë fare frikë as për gjynahet më të mëdha, njerëzit arifë, për shkak të madhështisë që transmetohet tek ata nga manifestimi i fuqisë dhe madhështisë hyjnore, jetojnë me një frikë të madhe nëse do të pranohen apo jo edhe veprat e tyre më të sinqerta.

Ndaj dhe Aliu ﷺ ka thënë:

“Më shumë sesa rëndësia që i kushtoni veprave që bëni, tregoni përkujdesje po aq edhe për pranimin dhe ruajtjen e tyre.”

Kësisoj, nuk mbaron puna duke kryer vepra të sinqerta. Duhet bërë po aq kujdes edhe për nivelin e çiltërsisë me të cilën i kryejmë ato, çfarë bëjmë që të mos humbasë sevapi i tyre, dhe duhet t’i ruajmë veprat nga veset e shëmtuara si dyfytërsia, dukja, arroganca dhe mendjemadhësia.



Ja pra, një nga synimet më të rëndësishme të edukimit mistik islam është të fituarit e kësaj përkujdesje në zemra, brenda një ekuilibri “khauf ue rexha” (frikë dhe shpresë).

Ndaj dhe miqtë e Zotit, ndonëse janë porsitë e yjeve në qiell nga aspekti shpirtëror, e shikojnë veten më prapa dhe më poshtë të gjithëve. Kështu, ruhen që të mos bien në shkujdesjen e sigurisë së veprave dhe gjendjeve të tyre të bukura. Mbështillen me edukatën e shpresës, tek mëshira dhe dhembshuria e Zotit të Madhëruar.

Kështu, Imam Rabbani përmes një letre ka kërkuar që të lutet një nxënës i tij që Imami të mbyllë sytë në këtë jetë duke kryer vepra të mira, pra me iman në zemër. Në një letër që i ka dërguar të birit, shkruan kështu:

“Mëshirojini fëmijët dhe stimulojini ata që të lexojnë Kuran! Gëzojini ata, për të cilët kemi përgjegjësi! Na vini në ndihmë duke u lutur për shëndetin e besimit tonë!”¹¹⁶

Virtyti i kujdesit për të dhënë frymën e fundit me iman, është një cilësi e përbashkët e të gjithë njerëzve të veçantë të Zotit të Madhëruar. Këtë kujdes të imanit duhet ta kemi që të gjithë ne. Ndaj as ne nuk duhet ta lëmë mangut duanë që përmendet në ajetin kuranor:

تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَالْحَقْنِي بِالصَّالِحِينَ

“...(O Zoti im!) Bëj që të vdes si mysliman dhe

116. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 169, nr: 2.



më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!” (Jusuf, 101)

Askush përveç pejgamberëve dhe atyreve që pejgamberët u kanë dhënë këtë sihariq, nuk mund të kenë garanci se mund të japin frymën e fundit me iman. Kjo ngjarja, tregon se sa e vërtetë është kjo që po themi:

Njeriut të veçantë të Zotit, të nderuarit Sufjan eth-Theurit, që në moshë të re i qe përkulur shpina. Kur e pyesin për arsyen, ai thoshte:

“Kisha një mësues që më mësonte dije. Ndërkohë që po ndërronte jetë, sado që ia këshillova Fjalën e Dëshmisë, ai nuk arriti dot ta thoshte. Kjo bëri që shpina ime të përkulej.”^{117]}

Zoti i Madhëruar na baftë prej atyreve që japin frymën e fundit me iman! Le të na bëjë pjesë e grupit të njerëzve fatlumë që do të përjetojnë lumturinë e suksesit të amshueshëm, të cilët kanë bërë një jetë në përputshmëri me pëlqimin hyjnor!

Amin!..



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT


Imam Rabbani 6

RAHMETULLAHI ALEJH

Qefini, që është edhe veshja e fundit e tregut të kësaj jete të përkohshme, një ditë do t'i mbështjellë të gjithë dhe vdekja do t'i vërë vulën e anulimi të gjitha marrëdhënieve të kësaj bote, kënaqësive, argëttimeve dhe bukurive mashtruese!

Pas kësaj pike, tashmë është e pamundur të bësh diçka të dobishme për të nesërmen, ndërsa pendesa s'do të ketë vlerë.

Për rrjedhojë, dita e përgatitjes për llogarinë që do të na shpëtojë në ditën e gjykimit, është pikërisht dita e sotme...



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani -6-

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Nuk ka asnjë frazë që të mbron më shumë nga zemërimi i Allahut se: «La ilahe ilallah». Duke qenë se kjo dëshmi të shpëton nga xhehnemi, ajo të ndihmon edhe në shumë vështirësi të tjera. Sigurisht që çdo vështirësi është më e lehtë se vuajtja e xhehemit. Si mos të jetë shpëtim kjo frazë kur robi e përsërit dëshminë duke ia kthyer shpinën botës, duke e larguar çdo gjë të kësaj bote dhe duke e bërë Allahun e Madhëruar kible të zemrës. Sigurisht që edhe shkaku i vuajtjes është varësia ndaj disa gjërave të kësaj bote. Dëshmia i zhdruk këto varësi dhe vuajtja kthehet në qetësi...”¹¹⁸

[Mëkatet më të rënda dhe më të pafalshme të një robi janë: “blasfemia, politeizmi dhe hipokrizia.” Pra mohimi i Allahut, bërja ortak e Tij dhe besimi sa

118. Imam Rabbani, *Mektubat*, II, 591-594, no: 37.



për sy e faqe në një kohë kur nuk beson me zemër.

Njeriu është krijuar si qenie besimtare që e adhuron Allahun, por ai devijon nga rruga e drejtë për disa arsye, më kryesoret e të cilave janë: bindja ndaj nefsit, shejtanit ose njerëzve që kanë cilësi prej shejtani. Në këtë mënyrë njeriu e tërheq veten në errësirën e mosbesimit. Në këtë temë mund të shtojmë se, perdet që i vendosen mendjes dhe shpirtit të një njeriu janë disa interesa të cilat i vendosen përpara për ta sprovuar atë.

Në lidhje me këtë temë mund të tregojmë një histori shumë domethënëse të Feriduddin Attarit:

Padishahu kishte një qen të cilin e donte tepër. Ky qen ishte shumë i zoti në gjueti. Padishahu i jepte shumë rëndësi qenit dhe e merrte me vete sa herë që shkonte për të gjuajtur. Qaforja e tij ishte e zbukuruar me gurë të çmuar ndërsa në këmbë kishte hallka prej ari dhe argjendi. Në shpinë mbante një mbulesë të bukur prej sateni.

Një ditë prej ditësh padishahu kishte dalë për gjah dhe kishte marrë me vete edhe qenin e dashur. Ai po ecte i gëzuar mbi kalin e vet dhe në dorë mbante rripin prej mëndafshi që i kishte lidhur qafores së qenit. Por papritur ndodhi diçka që e mërziti shumë. Qeni e kishte harruar krejtësisht padishahun dhe po merrej me një punë tjetër. Padishahu filloi të tërhiqte rripin por



ishte krejt e kotë sepse qeni e kishte mendjen tek kocka që kishte përpara. Padishahu i habitur u zemërua shumë dhe thirri:

“- Si mundesh ti të më harrosh mua dhe të merresh me diçka tjetër?!”

Padishahu u hidhërua shumë. Ai ishte prekur nga mosmirënjohja dhe pabesia e qenit. Ai nuk mund ta falte dot. Si mund ta falte qenin që i harroi të gjitha të mirat e padishahut dhe i ndërroi me një kockë. Thirri me zemërim:

“-Ma largoni këtë të pafytyrë!”

I shkreti qen, kur e kuptoi se çfarë kishte ndodhur, ishte shumë vonë. Nuk mund të bënte më asgjë. Shërbëtorët e padishahut i thanë:

“-Sulltani ynë, le t’i marrim edhe gurët e çmuar, arin dhe argjendin që ka në trup! Mos t’i marrë me vete!”

“-Jo, le t’i marrë me vete!” Më pas shtoi këto fjalë:

“-Le t’i marrë me vete! Në mënyrë që kur të mbesë pa ngrënë dhe ta marrë etja le t’i shikojë ato dhe të kuptojë se çfarë ka humbur!..”

Ja pra, ky ishte dënimi për kafshën të cilën Allahu e ka krijuar për t’i shërbyer njerëzve. Pa mendoni pak, a ka mosmirënjohje më të madhe



se sa të harrosh se kush është Krijuesi i njeriut dhe Ai që na furnizon neve me çdo gjë!..

Nuk duhet të harrojmë që edhe sikur e gjithë bota ta mohonte ekzistencën e Allahut të Madhëruar, Qenies së Tij të Lartë nuk do t'i humbiste asnjë gram nga madhështia që ka. Edhe sikur të gjithë njerëzit të bekoheshin me besimin në Allah, ata nuk do të mund ta zmadhonin madhësh-tinë e Tij. Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për ne. Prandaj besimi ose mosbesimi ndikojnë vetëm tek ne; na sjellin të mira ose të këqija vetë neve.

Pavarësisht kësaj Allahu është më i mëshirshmi, prandaj do që ne të gjejmë rrugën e drejtë. Ai dëshiron që njerëzit të fisnikërohen me dritën e besimit në mënyrë që të jenë të denjë për shpërblimin hyjnor. Pikërisht për këtë arsye Fjala e Njësisë është fjala më e dashur e Tij. Sigurisht që dëshmia duhet të jetë e sinqertë, duhet thënë me gjithë zemër;

✓ Robi ia kthen shpinën të gjitha dyerve të kësaj bote dhe prehet nën Qetësinë e Allahut të Madhëruar.

✓ Dëshmia është mohimi i të gjithë idhujve dhe nënshtrimi përpara Allahut si Perëndi e Vetme.

✓ Është këputja e të gjitha lidhjeve me shejtanin dhe kurthet e tij, për të shijuar afrimin e sinqertë me Allahun.



Për këtë arsye Allahu i Madhëruar, njeriun të cilin e ka merituar dënimin, e fal vetëm sepse ka thënë Fjalën e Njesisë e cila bëhet shkak për t'u kthyer në rrugë të drejtë. Edhe Pejgamberi ynë i nderuar i ka falur mosbesimtarët të cilët i kishin shkaktuar aq tortura vetëm për hatër të Fjalës së Njesisë; ai i ka pranuar në grupin e sahabëve të nderuar.

Për shembull habeshliu Vahshi ishte ai që bëri shehid xhaxhanë e Pejgamberit tonë të nderuar, Hazreti Hamzanë. Më vonë ai pranoi Islamin duke thënë Fjalën e Njesisë dhe me emocionin hyjnor që të dhuron Islami ai eliminoi ngatërrestarin Musejleme, në këtë mënyrë Vahshiu pati mundësinë që në njëfarë mënyrë të kryente dënimin e vet. Si rezultat Hazreti Vahshi u bë një nga sahabët më të nderuar, emri i të cilit do të përmendët nga të gjithë myslimanët deri në ditën e gjykimit.

Prandaj mund të themi që Fjala e Njesisë: “La ilahe il-lall-llah / Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”, është ndërmjetësja më e mirë për faljen nga Krijuesi i Gjithësisë. Kjo fjali gjendet edhe tek shumë lutje pendimi.

“(Kujtoje) **Dhun-Nunin** (Junusin) **kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: «S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë,**



unë kam gabuar!». Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuam nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët.” (Enbija, 87-88)]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Mirësia e Fjalës së Njesisë është më e madhe se e gjithë kjo botë e mbledhur së bashku! Ah sikur të ishin në raportin që ka i gjithë oqeani me një pikë uji që ndodhet në të! Megjithatë vlera dhe madhështia e kësaj Dëshmie është e lidhur ngushtë me shkallën shpirtërore të personit që e thotë. Sa më e lartë të jetë grada e tij, aq më shumë do të rritet vlera e Fjalës së Njesisë...”¹¹⁹

[Ky hadith sherif e shfaq shumë qartë forcën e ndërmjetësimit të Fjalës së Njesisë:

Sahabi Sheddad ibn Evs رضي الله عنه ka thënë:

Një ditë teksa ishim pranë Pejgamberit صلى الله عليه وسلم, ai tha:

“-A ka të huaj në mesin tuaj?” Me “të huaj” ai nënkuptonte Ehli Kitabin.

“-Jo o i Dërguar, nuk ka!”-u përgjigjëm ne.

Më pas Resulullahu صلى الله عليه وسلم urdhëroi që të mbylleshin dyert dhe tha:

“-Ngrini duart lart dhe thoni: La ilahe il-lallah!”



Ja se si e tregon Shedad ibn Evs vazhdimin e kësaj bisede:


“-Ne bëmë ashtu si na tha. Më pas Resulullahu na kërkoi që t'i ulnim duart dhe bëri këtë dua:

«-Allahu im, të gjitha falënderimet të takojnë Ty! Ti më ke dërguar mua me “këtë fjali”. Më urdhërove që ta thosha dhe të veproja sipas saj. Në këmbim më premtove Xhenetin. Ti nuk e prish asnjëherë premtimin!»

Më pas Resulullahu i tha sahabëve:

«-Kam një lajm të mirë për ju! Nuk ka dyshim se Allahu ju ka falur.» (Ahmed ibn Hanbel, *Musned*, IV, 124)

Po përcjellim një ngjarje tjetër e cila e tregon më së miri rëndësinë e Fjalës së Teuhidit:

Sulejmani  i cili ishte bekuar nga Allahu Teala me shumë të mira, po kalonte në një vend së bashku me ushtrinë e tij të përbërë nga xhind, njerëz dhe zogj. Aty gjendej një fole milingonash. Kryetari i milingonave, kur vërejti Sulejmanin që po shkonte në drejtim të tyre së bashku me ushtrinë e tij të madhe, tha:

“-O milingona! Futuni në strehimet tuaja; mos t’ju shtypi pa dashje Sulejmani me ushtrinë e tij! Mbretëria dhe pushteti i Sulejmanit janë shumë të mëdha, ju do të mbesni poshtë tyre! Futuni në strehimet tuaja!”¹²⁰

120. shih. en-Neml, 17-18.



Sulejmani, të cilit Allahu ﷻ i kishte dhuruar aftësinë për të kuptuar gjuhën e kafshëve, i dëgjoji këto fjalë dhe tha:

“-Jo, mbretëria ime është kalimtare! Ndërsa lumturia dhe mbretëria e Fjalës së Njesisë është e përjetshme!..”

Në një hadith thuhet:

“Ai që me frymën e fundit thotë Fjalën e Njesisë (me zemër të singertë), futet në Xhenet...”

(Hakim, *Mustedrek*, I, 503)

Një njeri që dëshiron të përfitojë nga ky hadith i bekuar, duhet ta kalojë jetën duke vepruar në përputhje me Fjalën e Njesisë. Pra nëse robi largohet prej besimeve të kota duke i mohuar ato dhe duke e mbushur zemrën me dashurinë për Allahun, atëherë ai duhet të shpresojë për fitimin e xhenetit. Përveç disa përjashtimeve, njerëzit të cilët e kalojnë jetën në kundërshtim me këtë mënyrë jetese do ta kenë të vështirë që në frymën e fundit të thonë: “La ilahe ilallah”. Në një hadith tjetër thuhet:

“Ashtu si të jetoni, ashtu do të vdisni; ashtu si të vdisni, ashtu do të ringjallen.” (Munavi, *Feyzu'l-Kadir*, V, 663)

Ubejdullah Ahrar transmeton:

“Një njeri i bekuar kishte parë në ëndërr të nderuarin Nakshibendi, pas vdekjes së tij, dhe e kishte pyetur:



«Çfarë mund të bëjmë për shpëtimin tonë?

I nderuari Nakshibendi i ishte përgjigjur me fjalët:

“-Kalojeni jetën tuaj duke u marrë me atë që duhet të merreni në momentin e fundit të jetës!” Pra ashtu si duam që të na vijë çasti i fundit, pra duke menduar për Allahun ﷻ, ashtu duhet ta kalojmë jetën, duke menduar për Allahun ﷻ. ”¹²¹

Nëse doni që frymën e fundit ta jepni me besim në Allah, duhet ta jetoni jetën në atë mënyrë. Në të kundërt, shpresa për të thënë Fjalën e Njesisë në çastin e fundit të jetës, nëse pjesa tjetër e jetës ju ka kaluar duke u marrë me gjëra të tjera, është vetëm një ëndërr boshe.

Njërin nga dijetarët më të mëdhenj të brezit tabiin, Imam Dhuhri, e kanë pyetur për hadithin sherif: “*Kush thotë «La ilahe il-lall-llah», futet në xhenet*”. Imam Dhuhri i është përgjigjur:

“-Kjo dispozitë ka qenë e vlefshme që në ditët e para të Islamit, përpara farzeve dhe urdhrave të tjera.” (Tirmidhi, Iman, 17/2638)

Pra mund të themi që është e domosdoshme që të jetohej një jetë brenda rregullave të Librit dhe Sunetit. Sepse Allahu i Madhëruar ka thënë:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen

121. *Reşahat*, s. 130.



të thonë «Ne besojmë», pa u vënë në provë?!»

(Ankebut, 2) Ky ajet kuranor tregon më së miri faktin që shqiptimi i Fjalës së Njësisë vetëm me gojë, pa e besuar sinqerisht atë dhe pa vepruar në përputhje me të, nuk mund të sjellë shpëtimin e përjetshëm.

Nga ana tjetër ka një mendim sipas të cilit ajeti kuranor i është drejtuar disa sahabëve që janë sprovuar me dhimbje dhe tortura të ndryshme. Sipas këtij mendimi, besimi i vërtetë vjen së bashku me një çmim. Për këtë arsye, Allahu (xh.sh) në Kuranin Kerim na ka treguar për magjistarët e Faraonit të cilët sakrifikuan jetën për të mbrojtur besimin, për As’hab Uhdud që u hodhën në hendek vetëm se nuk hoqën dorë nga besimi dhe për Habibi Nexhxharin, që për hir të Fjalës së Njësisë, ra shehid nga goditjet me gurë.

Nga ana tjetër, ashtu si ka thënë i nderuari Imam Rabbani, vlera dhe madhështia e Fjalës së Njësisë është e lidhur ngushtë me gradën e personit që e shqipton. Prandaj ne duhet të thellohemi sa më shumë në kuptimin dhe magjinë e saj. Sa bukur ka folur sahabi Abdullah ibni Mesud, i cili ishte brumosur me edukatën e peygamberit tonë të dashur: “Ne kishim ardhur në një gjendje të tillë që mund të dëgjonim edhe tesbihët e kafshatave kur kalonin nga fyti!”^{122]}



I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

Qëllimi i Dëshmisë: “La ilahe il-lall-llah”, është shkatërrimi i besimeve të kota që ndodhen brenda dhe jashtë nesh. Lati dhe Uzza janë disa prej besimeve të mosbesimtarëve. Ekzistojnë edhe idhuj të nefsit. Allahu i Madhëruar ka thënë në Kuran:

“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri që dëshirat e veta i ka bërë zot...” (Xhathije, 23)

Sheriati kërkon që njeriu i cili është i aftë për të besuar, t’i eliminojë të gjithë idhujt që mund të ketë në zemër. Për të eliminuar idhujt duhet të zotërojmë nefsin tonë. Pikërisht në këtë mënyrë gjendet rruga e drejtë. Besimi i vërtetë është i lidhur ngushtë me largimin nga idhujt e ndryshëm...”¹²³

[Edhe vetë Fjala e Njësisë “La ilahe” fillon me refuzimin në besimin tek idhujt. Mohimi i ekzistencës së zotave të tjerë pos Allahut, është kusht i mjaftueshëm i besimit. Por sigurisht që kjo është pjesa më e lehtë e kësaj rruge. Pjesa e saj e vështirë është mohimi i idhujve të brendshëm dhe nënshtrimi ndaj Allahut.

Resulullahu kur po kthehej nga Tebuku, iu

123. *Maarif-i Ledunniyye*, s. 69, 24. Bölüm.



kthye sahabëve dhe i tha: “Po ktheheni nga lufta e vogël për në luftën e madhe, pra keni ardhur në luftën me nefsin.”¹²⁴ Pra eliminimi i idhujve të brendshëm dhe lufta me nefsit, është një detyrë shumë e vështirë.

Dolayisiyla nefsi tezkiye ederek iç alemi batini putlardan da arindirmek; zor, fakat elzem bir vazifedir.

Në ajetin kuranor thuhet:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ۖ وَ ذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ۖ

“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!”

(A’la, 14-15)

Ibni Abbasi fjalën “tezekka/pastrim” që kalon në këtë ajet, e komenton si pastrim përmes dëshimit se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut.¹²⁵ Sigurisht që hapi i parë i pastrimit është eliminimi i besimeve të gabuara.

Cilët janë idhujt e brendshëm që njeriu duhet të eliminojë?

✓ Dëshirat e egos që nganjëherë na bëhen pengesë në realizimin e urdhrave të Allahut.

✓ Interesat e kësaj bote të cilat nuk i largojmë dot as për hir të Allahut. Ato interesa që na bëjnë të zgjedhim këtë botë përpara ahiretit.

124. shih. Bejhaki, *ez-Zuhdu’l-Kebir*, d. 198/374; Sujuti, *Xhami*, II, 73/6107.


125. Kurtubi, *el-Xhami*, XX, 22.




✓ Pozicione dhe poste të cilat na largojnë nga Krijuesi ynë.


✓ Fama dhe pasuria që nganjëherë na bëjnë ta harrojmë Allahun e Madhëruar.

✓ Pëlqimi i fortë që mund të kemi për një njeri të gjinisë së kundërt.

Allahu  na i ka bërë shumë tërheqëse disa gjynahe (mekate) në mënyrë që shpërblimi i atij që reziston të jetë i merituar. Ruajtja e nefsit është një detyrë e vështirë që kërkon besim të fortë.

Edhe mosbesimtarët e Mekes kanë shkuar tek Pejgamberi  dhe i kanë bërë këtë ofertë:

“–Nëse dëshiron të bëhesh i pasur, ne do të të japim para sa të duash! Nëse të pëlqen të jesh kryetar, ne do të të bëjmë prijësin tonë! Nëse të pëlqen të martohesh me një grua të mirë, ne do të të japim vajzën më të bukur të Kurejshve! Ne jemi gati të bëjmë çfarë të duash në mënyrë që ti të heqësh dorë nga çështja jote!”

Përgjigjja e të Dërguarit të Allahut, , ishte kjo:

“–Nuk më interesojnë asnjë prej atyre që përmendët! Unë nuk dua pasuritë tuaja, nuk dua të fitoj famë e pasuri dhe nuk kam ardhur që të jem prijësi juaj. Allahu më ka dërguar si pejgamber. Ai më ka zbritur dhe një Libër. Më ka urdhëruar që t’i jap lajmin e mirë (lajmin e xhenetit) atyre që e meritojnë dhe t’i paralajmëroj



(për xhehenemin) ata që nuk janë në rrugë të drejtë. Unë ju njoftova për detyrën time dhe ju këshillova! Nëse do ta pranoni atë që ju kam sjellë, do të keni të mira në këtë botë dhe në ahiret! Nëse nuk e pranoni por e refuzoni, derisa Allahu të më sjellë lajmin se si duhet të sillem me ju, unë do të zbatoj urdhrin e Tij dhe do të bëj durim përballë çdo vështirësie.”¹²⁶

Sigurisht që këto ftesa që mund të jenë joshëse për njerëzit, nuk ndikuan aspak tek Pejgamberi ynë i nderuar i cili ishte dërguar me detyrën për të luftuar idhujt e nefsit. Por historia e njerëzimit është e mbushur me shembuj njerëzish që kanë rënë pre e dëshirave të nefsit dhe që e kanë harruar ahiretin duke u mashtruar prej bukurive kalimtare të kësaj bote. Në një hadith sherif thuhet:

“...(Tani e tutje) nuk kam frikë se mos i bëni shirk Allahut. Por kam frikë se do të jepeni aq shumë mbas kësaj bote sa do të grindeni me njëri-tjetrin.” (Buhari, Megazi, 17; Muslim, Fedail, 31)

Me pak fjalë mund të themi që njeriu më së shumti i përulet nefsit të vet. Pengesa më e madhe mes njeriut dhe Krijuesit janë disa vendime të udhëhequra nga dëshira të nefsit. Nuk duhet të harrojmë që ideologjia: “sipas meje”, bie ndesh me mësimet hyjnore. Ajo nuk përshtatet me rregullat e Islamit.



Ajeti kuranor thotë:



“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?” (Furkan, 43)

Ndërsa në një hadith të Pejgamberit tonë të nderuar, thuhet:

“Për Allahun nuk ka gjë më të keqe dhe më të rëndë se adhurimi i perëndive të rreme dhe ndjekja dhe veprimi sipas dëshirave të lakmisë.”

(Hejthemi, I, 188)

Prandaj mund të themi që nuk ka asgjë më të rëndësishme se edukimi shpirtëror dhe largimi prej dëshirave të nefsit. Vetëm në këtë mënyrë mund të gjendet rruga e vërtetë dhe të përkthehet në vepra Fjala e Njesisë.]

Allahu  na bëftë prej atyre që janë të sinqertë në thënien e Fjalës së Njesisë! Inshallah jemi prej atyre që do të përfitojnë nga Fjala e Njesisë dhe do të jetojnë në përshtatje me të! Allahu  na bëftë prej atyre që do ta japin frymën e fundit në qetësi dhe me Fjalën e Njesisë në gojë!

Amin!..






URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani

7

RAHMETULLAHI ALEJH

Prandaj mund të themi që sohbetet që bëhen sipas shembullit të Pejgamberit tonë të nderuar, janë një vazhdim i traditës profetike. Gjendja shpirtërore që krijohet në sohbetet është një fllad ere që vjen nga sohbetet e Resulullahut. Kjo ngjan me qiriun i cili i jep dritë edhe qirinjtë të tjerë... Zjarri që ndez qirinjtë dhe që ndriçon ambientin, është i njëjti zjarr. Besimtari, edhe nëse ndriçohet nga qiriun i fundit, ai gjithsesi është ndriçuar nga i njëjti zjarr.



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

Imam Rabbani رحمته عليه -7-

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Kjo është koha për të bërë adhurim. Hidhni të gjitha dëshirat e nefsit brenda fjalës «لا» në mënyrë që ajo t’i eliminojë ato dhe juve të mos ju mbesë asnjë dëshirë e gabuar që mund t’ju tërheqë në gabime dhe në devijim...

Kur jeni duke dëshmuar dhe thoni «إلا الله»: Ka vetëm Allah», mos mendoni për askënd dhe asgjë tjetër në këtë botë përveç Allahut! Njeriu është i dobët dhe e ka mendjen tek shtëpitë e bukura, vilat, kopshtet, librat dhe gjëra të tjera të ngjashme. Por këto nuk duhet t’ju marrin kohën tuaj!”¹²⁷

[Fjala “لا / la” që ndodhet në Dëshmi, i fshin të gjithë idhujt që kemi në zemër. Ndërsa shprehja “إلا / il-la” ekuilibron dashurinë për Allahun e Madhëruar. Zemra nuk duhet të përmbajë asnjë dashuri që e ndalon afrimin me Krijuesin e Gjithësisë.

127. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 169, no: 2.



Të gjitha dashuritë kalimtare duhet të shkatërrohen. Në një hadith, Pejgamberi ynë i dashur shprehet kështu:

“Për sa kohë që ata nuk i vendosin punët mashtruese të kësaj bote përpara fesë, adhurimi «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» do t’i mbrojë nga dënimi i Allahut. Nëse e shkëmbejnë fenë për mashtrimet e kësaj bote, edhe nëse dëshmojnë «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» Allahu i Madhëruar do t’ju thotë: «Ju gënjeni!»” (Bejhaki, *Shuabu’l-Iman*, XIII, 100/10015; Hejthsemi, VII, 277)

Një mysliman i vërtetë nuk duhet të lejojë askënd dhe asgjë që të futet në mes tij dhe Krijuesit. Veçanërisht gjatë momenteve të adhurimit, ai duhet të mundohet që t’i kryejë ato sa më mirë të jetë e mundur. Besimtari nuk duhet të mendojë për gjëra të kësaj bote në momentin kur adhuron Krijuesin. Gjithashtu duhet të ruhet prej sjelljeve që i dëmtojnë besimin.

Në një hadith, Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“Frika më e madhe që kam për umetin tim është se ata mund t’i bëjnë shirk Allahut. Nuk e kam fjalën për adhurimin e Hënës dhe të Diellit. Unë frikësohem për punët që bëjnë për të tjerët (jo për Allahun) dhe për dëshirat e tyre të fshehta.” (Ibn-i Maxhe, *Zuhd*, 21)

Sinqeriteti në kryerjen e adhurimeve vetëm për hir të Allahut, është një nga gjërat që të çon në besimin e vërtetë.



Pra, esenca e Fjalës së Dëshmisë është pastrimi i zemrës nga të gjitha gjërat që nuk kanë lidhje me Allahun. Mos të harrojmë që kur zemra i dorëzohet Allahut, ajo fillon që të marrë diçka nga klima hyjnore dhe pasurohet me bekime të shenjta.

Ashtu siç ndodh kur mbajmë një lente drejt diellit dhe me rrezet e saj arrijmë që të shkatërrojmë atë që ndodhet në drejtim të lentes; ashtu duhet të pastrojmë edhe zemrat me anë të Fjalës së Dëshmisë.

Ja sa qartë e ka shprehur i nderuari Esad Erbili, përpjekjen që duhet bërë për ta jetuar Fjalën e Dëshmisë dhe për ta shfaqur në çdo vepër, çdo adhurim, shkurtimisht në çdo çast të jetës sonë:

“Akoma jam duke u munduar që të kuptoj më mirë domethënien e besimit. Mundohem që të dëshmoj me gjuhë dhe me veprime, sepse kur në zemër ke një idhull tjetër përveç Allahut, është shumë e vështirë që të dëshmosh: «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» Edhe nëse kjo fjalë përsëritet vazhdimisht, nuk është e sigurt që do të pranohet.”¹²⁸

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Mundësia (pra jeta e kësaj bote) është shumë e paktë. Prandaj le ta shfrytëzojmë sa më mirë çdo rast. Kjo arrihet duke qëndruar me njerëz të mirë që e përmendin Allahun

128. M. Es'ad Efendi, *Mektubat*, s. 63, no: 35.



gjatë gjithë kohës. Asgjëje mos i jep rëndësi sa kuvendeve fetare (sohbet)! Sahabët e nderuar bënë kuvende të vazhdueshme me Resulullahun dhe në atë mënyrë arritën shkallën më të lartë të njerëzve.¹²⁹

[Mënyra më e mirë për të përfituar nga këto kuvende, është që ta kuptosh rëndësinë e tyre. Fillimisht duhet të kuptojmë se kuvendet fetare janë një metodë e praktikuar nga vetë Pejgamberi; Resulullahu i ka edukuar sahabët e tij me sohbe.

Edhe fakti që fjala sahab dhe sohbet kanë të njëjtën rrënjë, e thekson edhe më shumë rëndësinë e sohbetit. Pra ajo që i bëri sahabët të jenë sahabë, është afrimiteti me Pejgamberin dhe përfitimi nga gjendja e tij shpirtërore.

Për këtë arsye kuvendet fetare janë “sunnet muekkede”. Pra nuk quhen farz apo vaxhib, por një veprim që Resulullahu e ka bërë vazhdimisht dhe që e ka lënë shumë rrallë, vetëm sa për të treguar që nuk është farz.

I Dërguari i Allahut, ﷺ, nuk i jepte nga një fletore në dorë shokëve të tij. Por ai i jepte një pjesë nga zemra. Sohbeti është një lloj edukimi që zhvillohet kur dy njerëz janë përballë me njëri-tjetrin. Në këto sohbe Resulullahu nuk shpërndante



vetëm dijen e tij me anë të fjalëve dhe gjesteve, por nga ai buronte edhe një gjendje e lartë shpirtërore që nuk mund të shpjegohet dot me fjalë por që ndjehej me zemër. Sahabët e nderuar përfitonin jo vetëm nga fjalët e Pejgamberit por edhe nga drita që buronte prej tij. Në këtë mënyrë ato ishin bërë njësh me Pejgamberin tonë të nderuar dhe kishin përfituar secili në varësi të shkallës shpirtërore që zotëronin. Zemrat e tyre ishin të mbushura me gjendjen shpirtërore të Resulullahut, ﷺ.

Mirësia që iu dhurua duke marrë pjesë në sohbetet e Resulullahut është shkaku pse njerëzit që kanë jetuar më vonë nuk kanë arritur kurrë që të fitojnë gradë më të larta shpirtërore se sahabët e nderuar.]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Mënyra më e mirë për të përfituar dhe për t’i ndihmuar të tjerët që të përfitojnë, është metoda e bisedave fetare. Duhet të kemi parasysh që sohbetet nuk mund të realizohen dot me shkrim.”¹³⁰

[Në bisedat fetare nuk kemi vetëm shkëmbim fjalësh dhe njohurish, por edhe shkëmbim shpirtëror. Pikërisht kjo është cilësia më e rëndësishme e sohbeve, pra transmetimi i gjendjes shpirtërore.

130. Imam Rabbani, *Mektubat*, III, 396, no: 69.



Ashtu siç ndodh në kimi që përbërjet e dy enëve të bashkuara përzjehen me njëra-tjetrën, ashtu ndodh edhe me zemrat. Zemrat lidhen me njëra-tjetrën përmes një kanali të padukshëm dhe arrijnë të shkëmbejnë ndjenja. Me kalimin e kohës ato fillojnë të ngjasojnë me njëra-tjetrën. Dëshirat, ndijimet dhe pikëpamjet fillojnë të bëhen të njëjta. Për këtë arsye Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëlartë ka thënë:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra!)”

(Tevbe, 119)

Në fakt në çdo pjesë të natyrës ekziston teoria e përngjasimit. Për shembull mendoni sikur në një qoshe të dhomës të derdhet një shishe parfumi. Molekulat e shishes do të përhapen (qarkullojnë) në ajër derisa përqendrimi i tyre të jetë i njëjtë në të gjitha pjesët e dhomës. Të kundërtat si ftohtënxehhtë, dritë- errësirë janë të pranishme edhe në botën e ndjenjave, jo vetëm në botën fizike.

Një nga dijetarët më të mëdhenj osman, i nderuari Muhammed Hadimi, thotë:

“...Gjendja shpirtërore është si një mbulesë e cila kalon nga një pjesëmarrës në sohbet tek tjetri... Natyra e njeriut ka si tipar që të imitojë tjetrin dhe t'i ngjasojë atij. Njeriu fillon t'i ngjasojë personave me të cilët bisedon, kalon kohë dhe nuk e kupton fare këtë gjë...”¹³¹



Edhe populli ka thënë: “Ka rrugë nga zemra në zemër.” Sigurisht që ajo që e forcon marrëdhënien e shkëmbimit mes dy zemrave, është dashuria. Për këtë arsye është e pëlqyeshme që sohbetet të mbahen gjallë me ndjenja të sinqerta. Pra kushti kryesor i sohbetit nuk është vetëm bashkimi fizik, por edhe bashkimi i zemrave.

Një klimë e tillë shpirtërore shikohej tek sohbetet e të Dërguarit të Allahut, ﷺ. Kur fliste Resulullahu ﷺ, sahabët e dëgjonin me zemër të ngrirë dhe plot emocion. Ata nuk linin t’u shpëtonte asnjë fjalë e tyre. Ja se si e shpjegonin gjendjen shpirtërore që krijohet në sohbetet e Resulullahut:

“Na dukej sikur kishim një zog mbi kokë dhe sikur të lëviznim pak ai do të largohej.”¹³²

Ngjarja e mëposhtme e tregon më së miri dëshirën e zjarrtë të sahabëve për të marrë pjesë në këto lloj kumtesash fetare të Pejgamberit tonë të nderuar ﷺ:

Theubani ishte një rob të cilin Pejgamberi ynë i nderuar e kishte liruar. Mbase nuk kishte asgjë në këtë botë, as një çadër ku të fuste kokën, por ai merrte pjesë në bisedat fetare të Resulullahut, ﷺ, dhe ato e gëzonin shumë, e bënë me krahë.

Vasaja'l-Mubareke, *Mexhmuatu'r-Resail*, f. 130-131, Istanbul ts., Matbaa-i Amire.

132. shih. Ebu Davud, *Sunnet*, 23-24/4753; Ibn-i Maxhe, *Cenaiz*, 37; Ibn-i Sa'd, I, 424.



Një ditë, gjatë një sohbeti, Theubani i përhumbur në mendime po e shikonte Pejgamberin ﷺ. Aq me ngulm po e shikonte sa tërhoqi vëmendjen e Resulullahut. Profetit i dërguar si mëshirë për këtë botë e pyeti me dhembshuri:

“Çfarë ke, o Theuban?”

Theubani i cili e donte shumë Pejgamberin ﷺ filloi që t’i zbraste shpirtin atij:

“-O i Dërguar i Allahut! Unë ju dua juve më shumë se veten time, familjen time dhe fëmijët. Kur më kujtoheni, nuk duroj dot dhe vrapoj pranë jush që të shikoj fytyrën tuaj të ndritur. (Kur nuk ju shikoj, ndjej një mall të çuditshëm. Kur jam kështu në këtë botë nuk e di si do t’ia bëj në botën tjetër.) Kur mendoj se ju dhe unë do të vdesim një ditë, më kap një mërzi të cilën nuk e shpjegoj dot me fjalë. Unë e di që kur të shkoni në xhenet, do të jeni në një vend të lartë së bashku me pejgamberët e tjerë. (Kurse unë nuk e di nëse do të futem në xhenet apo jo! Nëse nuk shkoj në xhenet do të jem një i gjorë që është dënuar për të mos ju parë ju.) Edhe nëse shkoj në xhenet, kam frikë se do të jem larg jush. (Ky shqetësim po ma djeg zemrën o Resulullah!)”

Pejgamberi ﷺ, pasi heshti pak, i dha një lajm të mirë Theubanit:

“-Njeriu është me atë që do...” (Buhari, Edeb, 96)



Pas kësaj ngjarjeje u zbrit ky ajet kuranor:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69)¹³³

Pra përpjekjet e sahabëve ishin për të qenë pranë Resulullahut, ﷺ, edhe në ahiret ashtu si kanë qenë në këtë botë. Ato përpiqeshin që të ishin sa më të afërt me Resulullahun. Sahabët kishin ndienja dhe mendime të njëjta me Resulullahun. Ata i bindeshin Allahut dhe të Dërguarit të Tij me kënaqësi. Mundësinë për të sakrifikuar çdo gjë në rrugë të Allahut, e shikonin si një fat të madh. E gjithë kjo vinte si pasojë e bisedave fetare të Resulullahut, ﷺ.

Prandaj kur shkojmë në sohbe, duhet të jeni të përgatitur shpirtërisht. Edhe nëse aty jepen njohuri që tashmë i dini, duhet t'i dëgjoni me emocion sikur të ishte hera e parë. Mos të harrojmë që bisedat fetare janë për t'i informuar ato që nuk i dinë dhe për t'ia kujtuar disa gjëra atyre që i dinë. Sohbetet kanë për qëllim përfitimin nga qëndrimi me njerëzit e mirë.

Ja sa mirë e përforcojnë këtë mendim ngjarjet që do të tregojmë më poshtë:

133. shih. Vahidi, s. 170.



Muxhtehidi i famshëm Ahmed bin Hanbel shkonte shpesh që ta vizitonte të nderuarin Bishri Hafi-në dhe i thoshte:

“-O Bishri! Më fol mua për Allahun.”

Nxënësit i tij e pyesnin:

“O mësuesi jonë i nderuar! Ti je një dijetar i shquar, pse shkon tek një dervish i thjeshtë?”

Imam Ahmed bin Hanbeli i përgjigjej:

“Unë kam njohuri më të gjëra, por ai është më pranë Allahut.”¹³⁴

Në sohbetet e të nderuarit Sami Efendi merrnin pjesë dijetarët më të rëndësishëm të kohës. Ata mbase kishin më shumë njohuri mbi fusha të ndryshme, por gjatë sohbeteve uleshin në qetësi dhe shijonin atë ndjenjë të lartë që nuk mund t’ia dhuronin dot librat.

Mund të themi që çdo njeri, pa marrë parasysh gradën e njohurive që zotëron, gjatë gjithë jetës së vet ka nevojë për biseda fetare. Kjo nevojë nuk zhduket kurrë. Le t’ju tregojmë një histori e cila e ilustron më së miri këtë:

Një nga nxënësit e të nderuarit Ebul Hasan Shadhili nuk po merrte më pjesë në sohbetet. Një ditë mësuesi i nderuar u takua me të dhe i tha:



“-Pse je ndarë nga ne, pse i ke braktisur sohbetet tona?” Nxënësi iu përgjigj:

“-Mua më mjaftojnë ato që kam mësuar deri më sot prej jush, nuk kam më nevojë për ju.”

I nderuari Shadhali u hidhërua shumë nga kjo përgjigje dhe e paralajmëroi nxënësin e vet me fjalët:

“-Shiko, biri im! Sikur dija e marrë në një periudhë të caktuar kohe të ishte e mjaftueshme, Ebu Bekri Besniku do të ishte mjaftuar me dijen e marrë nga Pejgamberi ynë i nderuar. (Në fund të fundit Pejgamberi e kishte derdhur zemrën e vet tek zemra e Ebu Bekrit.) Por Siddiku nuk i braktisi asnjëherë sohbetet e Resulullahut, ﷺ, nuk u nda prej tij deri në ditën që vdiq. (Edhe pas vdekjes së Resulullahut ai mezi priste të varrosej pranë tij.)”

Sahabët e nderuar kur nuk e takonin dot Resulullahun për arsye të ndryshme, i kërkonin fëmijëve të tyre që të shkonin për vizitë sepse ata nuk i rezistonin dot këtij malli të fuqishëm. Vallë sa i afrohemi ne sahabëve dhe këtyre ndjenjave të tyre? Sa bëjmë përpjekje për të përfituar prej sohbeve?..

Ismail Hakki Bursevi ka thënë:

“Edhe pse nuk e kemi mundësinë për të marrë pjesë në sohbetet e Resulullahut, kemi mundësinë për të ndjekur sunetin e tij dhe për të qëndru-



ar pranë njerëzve që e duan sunetin e tij. Kjo do të vazhdojë deri në Ditën e Kijametit. Pjesëmarrja në sobhete dhe shoqërimi me njerëzit e mirë është virtyt i madh.”¹³⁵

Prandaj mund të themi që sobhetet që bëhen sipas shembullit të Pejgamberit tonë të nderuar, janë një vazhdim i traditës profetike. Gjendja shpirtërore që krijohet në sobhete është një fllad ere që vjen nga sobhetet e Resulullahut. Kjo ngjan me qiriun i cili i jep dritë edhe qirinjve të tjerë... Zjarri që ndez qirinjtë dhe që ndriçon ambientin, është i njëjti zjarr. Besimtari, edhe nëse ndriçohet nga qiri i fundit, ai gjithsesi është ndriçuar nga i njëjti zjarr.

Për këtë arsye mund të themi se personi që merr pjesë në sobhete, merr pjesë në një nga hallkat e Pejgamberit tonë të nderuar. Zemra e tij mbushet me një ndjenjë që buron nga sobhetet e Resulullahut...]

I nderuari Imam Rabbani ka thënë:

“Është krejt e qartë që kjo botë është vendi ku duhet të punojmë dhe jo të çlodhemi. Të gjitha përpjekjet tuaja duhet të jenë për të punuar sa më mirë. Mos e harxhoni kohën me dëfrime të kota!.. Lini armiqtë tuaj të jenë dembelë dhe prej atyre që merren me punë



të kota! Duhet të bëni vepra të mira dhe të punoni, vetëm të punoni...¹³⁶

[Besimtari duhet ta kuptojë se kjo botë është kalimtare ndërsa bota tjetër është e pafundme. Ai nuk duhet të harrojë për asnjë çast që atë që mbjell në këtë botë, do ta korrë në ahiret. Një njeri që e di këtë të vërtetë nuk e kalon asnjë minutë të jetës me dembelizëm. Por njeriu edhe pse i di të gjitha këto të vërteta, është qenie e dobët, prandaj nganjëherë devijon prej rrugës së drejtë. Prandaj nuk mjafton ta dish një gjë të tillë, por duhet edhe ta veprosh.

Një ditë e pyetën të nderuarin Ibrahim bin Edhem:

“-Pse nuk pranohen lutjet që bëjmë ne?”

Ai iu përgjigj:

“Lutjet nuk ju pranohen për këto arsye:

-E njihni Allahun, por nuk i bindeni Atij.

-E njihni Resulullahun, por nuk e ndiqni sunetin e tij.

-Lexoni Kuran, por nuk veproni sipas ligjeve të shkruara në të.

-Hani nga ushqimet me të cilat ju ka furnizuar Allahu, por nuk jeni falënderues.

136. Imam Rabbani, *Mukashifat-i Gajbijje*, 29.



-Dini shumë gjëra për xhenetin, por nuk dini si ta kërkonit atë.

-E dini se do të vdisni, por nuk përgatiteni për të.

-I futni të vdekurit nën dhe por nuk merrni shembull prej gjendjes së tyre.


Në këtë gjendje që jeni ju, si jua merr mendja që mund t'ju pranohen lutjet?!"¹³⁷

Pra mund të themi që dija nuk është e mjaftueshme, duhet të jenë të pranishme edhe veprat... Nuk ia vlen që të presësh një përfundim të mirë nëse nuk bën përpjekje, të presësh mëshirë pa bërë mund, të shpresosh në fitore pa u lodhur aspak dhe të kërkohesh të ushqehesh pa punuar. Nëse nuk vepron ashtu si të urdhëron Islami, nuk ke pse pret shpëtim.

Le të mundohemi që të punojmë sa më shumë për botën tjetër para se të na soset jeta. Allahu i Madhëruar ka thënë në Kuran:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8) Prandaj ne duhet ta shfrytëzojmë çdo moment për të kryer adhurim.]



Allahu  na dhëntë një jetë të harxhuar me vepra të mira dhe na kurorëzofhtë me vdekjen si besimtarë të vërtetë! Qofshim prej atyre që në ahiret do të bekohen me të mira...

Amin!..





PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Imam Rabbani Ahmed Faruki ﷺ.....	11
Marrëdhëniet e tij me Sulltanët.....	16
Ndjekja e sheriatit para çdo gjëje.....	24
Ehli Sunnet ve'l-Xhemat.....	29
Ndjeshmëria në ndejkjen e Sunetit profetik.....	30
Adhurimet e tij.....	31
Morali i bukur.....	36
Dobësia e mendjes dhe nevoja e profetësisë.....	38
Fjala e Teuhidit dhe dhikri i vazhdueshëm.....	41
Kafshata hallall.....	42
Rëndësia e bisedave fetare.....	43
Shfrytëzimi i mundësive.....	44
Braktisja e egos.....	47
Vdekja.....	48
Disa prej këshillave të urta.....	52



Urtësi nga të dashurit e Allahut

Imam Rabbani ؒ -1.....	55
Imam Rabbani ؒ -2.....	73
Imam Rabbani ؒ -3.....	93
Imam Rabbani ؒ -4.....	111
Imam Rabbani ؒ -5.....	129
Imam Rabbani ؒ -6.....	143
Imam Rabbani ؒ -7.....	161

